



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES SË VEÇANTË TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 27 PRILL DHE 3 MAJ 2018**

**SA POSEBNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 27. APRILA I 3. MAJA 2018. GODINE**

**PRILL/MAJ - APRIL/MAJ
2018**

Rendi i ditës

1. Debat parlamentar për personat e pagjetur

Dnevni red

1. Parlamentarna rasprava o nestalim licima

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

I hap punimet e seancës së veçantë të Kuvendit të Republikës së Kosovës me kërkesë të 70 deputetëve të Kuvendit.

Në sallë aktualisht janë të pranishëm 54 deputetë.

1. Debat parlamentar për personat e pagjetur

Të nderuar kolegë deputetë,

Ju njoftoj se 70 deputetë kanë kërkuar debat parlamentar për personat e pagjetur. Kjo është java e cila u kushtohet personave të pagjetur që nga koha e luftës dhe për këtë arsye është thirrur një seancë e veçantë.

Kuvendi i Republikës së Kosovës ka përkrahur organizatat joqeveritare dhe pjesën institucionale që merren me personat e pagjetur, të cilat kërkojnë drejtësinë.

Kuvendi i Republikës së Kosovës do të mblidhet çdo herë, çdo vit, derisa të përfundojë kjo dramë e fatkeqësisë sonë kombëtare.

Duke pasur parasysh se kemi ende shumë qytetarë të Kosovës, të cilët janë të pagjetur, po bëhen dy dekada të dhimbjes dhe pritjes.

Serbia po vazhdon të heshtë dhe po tenton të nxisë harrimin tonë, po ne nuk harrojmë, as nuk do të ndalemi kur së kërkuari drejtësi për qytetarët tanë.

Serbia duhet ta ketë të qartë se fshehja e krimeve dhe aspirata për integrim evropian nuk shkojnë bashkë, vetëm drejtësia i shëron plagët e së kaluarës, e jo harrimi i tyre.

Ne do të bëjmë çdo gjë që është në mundësi tona që të ndriçohet fati i njerëzve tanë, të cilët janë aktualisht të pagjetur. Ky është obligim yni kushtetues dhe obligim nacional të jemi bashkërisht, t'u qëndrojmë pranë atyre të cilëve ende deri më sot nuk i kanë gjetur të dashurit e tyre.

Unë ftoj deputeten Saranda Bogujevci ta marrë fjalën.

SARANDA BOGUJEVCI: Faleminderit, kryetar!

Të dashur familjarë të personave të pagjetur,

Të dashur qytetarë,

Të nderuar deputetë,

Dhe të gjithë ju pjesëmarrës,

Në fakt, e kisha goxha të vështirë të mendoja se çka mund të flas sot për personat e pagjetur.

Kanë kaluar 19 vjet dhe familjarët ende jetojnë me dhimbjen për fatin që nuk kanë asnjë informatë se ku gjenden familjarët e tyre.

Unë e kam përjetuar këtë vetë dhe është goxha e vështirë të jetosh me atë ndjenjë.

Për fat të keq, unë sot mund të flas gjatë gjithë ditës që nuk është bërë asgjë në këtë drejtim, që është keqpërdorur kjo temë, drejtoj gishtin te ata që janë përgjegjës, por e mendova që sot dua të përqendrohem të flas me një formë në emër të familjarëve.

Kisha dashur që sot si deputetë, më vjen keq që nuk e kemi asnjë përfaqësues të Qeverisë sot këtu, të ktheheni pak mbrapa, të ktheheni te koha kur ka përfunduar lufta, kur të gjithë e kemi pasur atë ndjesinë ku kemi kërkuar të dimë se ku janë familjarët tanë, çfarë ka ndodhur dhe kemi pasur ndjesinë që kemi humbur familjarë dhe miq dhe ta shprehni atë ndjenjë sot këtu, sepse besoj që vetëm përmes kësaj ndjenje me të vërtetë mund ta kuptojmë se nëpër çfarë janë duke kaluar familjarët dhe nëpër çfarë kanë kaluar që 19 vjet.

Përgjegjësia është shumë e madhe, duke filluar nga personat përgjegjës, në të gjitha aspektet që kanë kaluar qeveritë tona karshi bisedimeve me Serbinë, ku çështja e të pagjeturve dhe e të gjitha krimeve që i ka bërë Serbia është dashur t'u përplasen në fytyrë në çdo moment, për shkak se ata nuk janë të interesuar të pranojnë krimet që i kanë bërë në Kosovë.

Dua ta ndaj një lajm që më përket mua dhe familjes sime, ku para dy ditëve një person që është dënuar për vrasjen e familjes, është liruar nga burgu në Serbi, pa e përfunduar dënimin që e ka marrë. Kjo e dëshmon që Serbia nuk do të pranojë fajin, nuk do të pranojë që ka kryer krime në Kosovë, nuk do ta pranojë që i ka informacionet se ku mund t'i gjejmë trupat e personave të zhdukur gjatë luftës në Kosovë dhe kjo duhet të jetë edhe një mësim tjetër se çka duhet të marrim ne dhe çka duhet të punojmë që ta shtyjmë Serbinë ta marrë këtë përgjegjësi.

Unë dua t'ia bëj një thirrje komunitetit ndërkombëtar për përgjegjësinë që e kanë edhe ata karshi Serbisë për t'i bërë presion që çështja e personave të pagjetur të merret si prioritet dhe të ndërmerren hapa konkretë rreth kësaj çështjeje.

Kemi disa rekomandime që janë prezantuar që e obligojnë Qeverinë, po edhe ne si deputetë që të punojmë në atë drejtim, të cilat do të prezantohen pas debatit parlamentar.

Unë nuk do ta zgjas më shumë se kaq, po sinqerisht kjo temë është shumë me rëndësi dhe duhet të bëjmë çmos që të mos i lëmë familjarët më në këtë gjendje që janë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zonja Bogujevci! Tani e ftoj deputetin Andin Hoti ta marrë fjalën.

ANDIN HOTI: Faleminderit!

I nderuar kryetar,

Kisha dashur të them edhe i nderuar kryeministër dhe Kabinet qeveritar, mua po më vjen keq që ata sot nuk janë këtu, po nuk do ta vër fokusin në këtë pikë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Shumë të respektuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Shumë të respektuar familjarë të të pagjeturve që ende sot pas 19 vjetësh ju mungojnë më të dashurit.

Së pari ju kërkoi ndjesë, sepse kam emocione dhe besoj që është normale.

Sot është një ditë me shenjë, është dita e plagës së madhe që e mban të trazuar shpirtin e Kosovës, është dita e atyre që na mungojnë dhe mungesën e të cilëve do ta ndjejmë edhe nesër.

Bashkë me Sarandën e kemi iniciuar këtë debat parlamentar jo për t'u thënë qytetarëve se nuk i kemi harruar njerëzit tanë më të dashur, jo vetëm për të ndarë ankthin e dhimbjen me familjarët e 1652 të pagjeturve tash e 19 vjet pas luftës, por për të kërkuar zgjidhje.

Për të insistuar që të gjithë bashkë t'i japim fund këtij ankthi 19-vjeçar.

Besoj që secili prej jush, secili qytetar e sidomos familjarët e personave të pagjetur e kuptojnë ndjenjën se si është të rritesh pa babanë. E kuptojnë ndjenjën e pritjes nëse do ta shoh e do ta gjej një ditë, por sot më duhet t'i mposht emocionet dhe të jem zëri i të gjithë atyre që presin që kërkojnë të dinë për 1652 njerëzit tanë, për ata që dikush edhe i ka harruar, për ata që nuk e ndjejnë vendosmërinë e institucioneve tona, të paktën duke ushtruar presionin te autoritetet ndërkombëtare dhe të Beogradit para dhe gjatë dialogut.

Qytetarët tanë ka vjet që dëgjojnë me dhjetëra herë në ditë deklarata politike për marrëveshjen e paqes me Serbinë, për normalizimin e raporteve, por si është e mundur të normalizohen ato dhe si mund të arrihet një paqe për breza të ardhshëm ku njëra palë s'tregon as vullnetin minimal as për çështje tërësisht humanitare.

Pra, nëse në dialogun me Serbinë nuk adresohet fati i këtyre personave, adresohet dhe ajo nuk përgjigjet, unë kam frikë se po mashtrohemi me idenë e normalizimit.

Kosova ka fakte dhe dëshmi për krime dhe gjenocidin që ka bërë policia dhe ushtria serbe, dhe pse të mos i përdorim ato?

Serbia ka regjistra dhe statistika për çdo banor të Kosovës, të cilat duhet t'i kërkojmë, duhet të kërkohen nga drejtori i atëhershëm i Burgut të Dubravës dhe nga gardianët se ku e kanë çuar babanë tim, Ukshin Hotin, të dielën, më 16 maj 1999, kur e kanë improvizuar gjoja lirinë e tij.

Shteti ynë duhet ta bëjë këtë dhe jam i bindur se është e mundshme, vetëm na duhet unifikim, angazhim serioz e përkushtim më i madh.

Si djali i Ukshin Hotit, e ndjej obligim moral e njerëzor që të ngre zërin për drejtësi që të vazhdoj pa u ndalur në kërkim të zbardhjes së fatit të prindërve, motrave e vëllezërve të të gjithë familjarëve për hir të paqes dhe që të mos mbajmë peng të ardhmen.

Nga këtu dua t'ju siguroj juve dhe qytetarët se nuk do të ndalemi asnjëherë dhe para asnjë presioni vendor apo ndërkombëtar derisa kjo çështje të marrë epilogun e saj. Natyrisht se për këtë na duhet edhe mbështetja juaj, jo vetëm morale, por edhe institucionale, që pikat e rezolutës, të cilat do të shpalosen në fund, të cilat i kemi hartuar bashkë me Sarandën, të zbatohen plotësisht.

Kërkoj me seriozitetin më të madh që çështja e të pagjeturve të hyjë në rend dite si pikë kryesore në bisedimet me Serbinë.

Me këtë plagë të hapur jo vetëm që s'mund të ketë sukses procesi në vazhdim, por s'do të ketë as rezultate e as marrëveshje të arritura deri më tani.

Kjo është detyra jonë sot, është detyra që na japin qytetarët, është zëri i mijëra qytetarëve të Rahovecit dhe gjithandej Kosovës, edhe i shprehur me peticionin e tyre që kanë dorëzuar në Kuvend para tre vjetësh.

Para se të përfundoj, më lejoni t'i falënderoj sinqerisht të gjitha grupet parlamentare që e kanë nënshkruar pa hezitim nismën tonë.

Mendoj që kjo qasje përbën mesazh të qartë për Qeverinë tonë, për përfaqësuesit tanë në dialog që të jenë të vendosur dhe të përkushtuar në adresimin e kërkesës sonë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! U kërkoj falje deputetëve, pati një reagim nga teknika. Sipas të gjitha gjasave, janë duke e përgatitur një dokumentar që propozuesi e ka kërkuar ta vendosim.

Tani e ftoj kryetaren e Komisionit për Persona të Pagjetur, zonjën Duda Balje.

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

Poštovanje za sve prisutne,

Poštovanje za sve porodice nestalih koji su ovde na Kosovu,

U ime Komisije za ljudska prava ono što mogu da vam kažem jeste da svi članovi Komisije zajedno sa mnom osećamo veliku bol što ni nakon 17 godina ništa nije rešeno po pitanju nestalih lica i jako se malo radilo.

Ovu rečenicu ponavljam iz mandata u mandat, iz godine u godinu, mi smo imali dosta sastanaka sa predstavnicima nestalih lica, odnosno njihovih porodica, znamo tačno koji su njihovi zahtevi i ono što mogu da kažem da u ime ove Komisije zajedno u saradnji sa Vladinom komisijom za nestale lica ili ćemo izvršiti dopunu Zakona koji postoji ili ćemo raditi na novom Zakonu.

Zahteve koje smo dobili od njih nisu preveliki, zahtevi su relativno realni i potrudimo se da u ovom mandatu u ovoj godini barem uredimo neke konkretne poteze za njih, a ne da iz godine u godinu samo na ovaj dan ili tačno u ovoj nedelji ponavljamo da ništa nismo uradili za nestala lica sa Kosova.

Činjenica je da pitanje nestalih lica i jedno od najvećih ran posle ratni rana na Kosovu, moram da priznam da u opšte nije lako susreti sa porodicama nestalih po naročito sa roditeljima i najbližim znači bol i posle svega nikako ne prolazi. Mislim da ne postoji način da im kompenzujemo to što njima fali, ali barem da se potrudimo da kao država ublažimo svu bol koji oni osećaju.

Broj nestalih lica jeste broj kao okviru nestalih lica, ne postoji različite zajednice na Kosovo. Ono što mogu ta kažem jeste da se nadam da svako onaj koji vršio takvu vršu zločina treba da plati i da se izvede ispred lica pravde, bes obzira koji je to, i smatram da smo svi dužni da pokažemo i da jedan poseban respekt prema ovakvim licima kako bi svi oni dobili svoj ljudski oblik i poštovanje koje zaslužio. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Tani është radha e përfaqësuesve ose kryetarëve të grupeve parlamentare.

Nga Lidhja Demokratike e Kosovës, zonja Lirije Kajtazi e ka fjalën.

LIRIJE KAJTAZI: Përshëndetje!

I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Të dashur familjarë të familjeve të pagjeturve,

Të dashur qytetarë,

Kosova vazhdon të mbetet dosje e madhe e krimit të pandëshkuar në Ballkanin Perëndimor, vazhdon të lëngojë nga plaga e hapur e rrëmbimit të njerëzve të saj dhe e fshehjes së vendndodhjes së tyre nga aparati shtetëror i Republikës së Serbisë.

Të gjitha faktet flasin qartë për shkaktarin e krimit që është Republika e Serbisë, dhe kjo është vërtetuar edhe nga gjykata ndërkombëtare.

Gjithashtu dhe mbamendja jonë është e freskët sa për të kujtuar se pjesa më e madhe e atyre që qeverisin në këtë kohë vazhdojnë të qeverisin ende me këtë vend, e cila na frikëson tutje për të vazhduar kjo lojë.

Dhe ne po kërkojmë tash e sa vjet që në Serbi më në fund të mbizotërojë minimumi i humanes: shteti serb të tregojë se ku ndodhën njerëzit tanë, që i mori nga shtëpitë e tyre dhe t'i kthejë ata!

Me konventa ndërkombëtare, të nderuar deputetë, krimet vazhdojnë deri në ditën e zbardhjes së tyre, dhe nëse shteti serb, si shkaktar i këtyre krimeve, vazhdon ta mbajë të fshehur vendndodhjen e njerëzve tanë, ai rrjedhimisht vazhdon të bëjë krim edhe sot dhe të ndodhë kjo potencialisht në zemër të Evropës së shekullit XXI, natyrisht se na flet për një sjellje të pahijshme.

Fshehja e vendndodhjes së njerëzve tanë nga shteti serb viktimizon jo vetëm të pagjeturit dhe familjarët, por natyrisht se është ngarkesë dhe mocion edhe për institucionet e Republikës së Kosovës.

Gjithashtu viktimë dhe e poshtëruar është edhe bashkësia ndërkombëtare, pasi në tryezë të bisedimeve ulet me një shtetin, i cili në këtë rast shkel me të dy këmbët konventat e ratifikuara nga vetë shteti i tyre mbi luftën dhe të drejtat e civilëve në konfliktet e armatosura.

Edhe pas gjitha këtyre viteve familjeve kosovare vazhdojnë t'u mungojnë 1652 njerëz, të cilët nëse marrim në një mesatare 5-anëtarëshe të familjes, kjo nxjerr se 8260 persona në Kosovën tonë të vogël vazhdojnë të vuajnë dhe të presin për të afërmit dhe familjarët e tyre. Natyrisht që kjo shqetëson thellësisht secilin.

Për rrethana tona, ky shqetësim kap përmasa edhe më të mëdha personash të shtresave të ndryshme shoqërore dhe këto shqetësime natyrisht se traumatizojnë këtë kategori, e cila si numër do të ishte vështirë të menaxhohet edhe nga shtetet më të konsoliduar, natyrisht se është ngarkesë edhe për vetë Kosovën dhe zhvillimin e saj.

Kjo çështje për shtetet dhe popujt normalë nuk duhet t'i takojë politikës, edhe pse ka derivuar nga një politikë e keqe dhe e egër. Kjo çështje duhet të prekë para së gjithash ndërgjegjen njerëzore, të dalë mbi politikën, pa dallimin politik dhe pa dallimin etnik.

Dhe ne jemi dëshmitarë se qeveritë në Serbi shkojnë e vijnë dhe çështjen e tillë e kanë shndërruar në kusuritje politike dhe nuk kanë bërë minimumin e angazhimit për t'u larguar nga

politika e keqe, e cila ka planifikuar dhe realizuar zhdukjen e dhjetëra-mijëra civilëve të pafajshëm.

Dhe, në vend se ky shtet dhe ky popull të pranojë fajin për vrasjen e civilëve të pafajshëm, dhe jo vetëm në Kosovë, ne i kemi edhe fqinjët tanë, kemi qenë si Komisioni i të Drejtave të Njeriut edhe në Bruksel, ku me shtetet fqinje që kanë pësuar nga kjo politikë të organizuar nga euro-deputetët kroatë kemi ngritur zërin bashkë edhe me komunitetin boshnjak për fatin e të pagjeturve që është brengë e secilit. Dhe, natyrisht se të gjithë kemi kërkuar që vendndodhja e tyre të tregohet, në mënyrë që kjo çështje të zbutet.

Aq më keq vazhdohet kjo lojë përmes zyrtarëve të ndryshëm shtetërorë, edhe më rëndë përmes klerikëve, në tempujt fetarë, në Kishën ortodokse serbe në Kosovë nga vizitat e shumta që bëhen nga autoritetet e atjeshme.

Dëshmia më e mirë se shteti i Serbisë tradicionalisht është i ngritur mbi krime dhe se nuk ka hequr dorë nga politika kriminale ndaj popujve fqinjë, është fakti i madhështimit të kriminelëve të dënuar nga Gjykata Ndërkombëtare e Hagës.

Ne patëm më parë familjaren, kolegen tonë, Sarandën, e cila foli për mosgatishmërinë e shtetit serb që t'i dënojë krimbërësit, edhe pse ka fakte të plota, edhe pse ka shkuar përmes vijës institucionale, po përkundrazi, në vend të ndëshkimit, ata vazhdojnë të dekorohen përditë e më shumë.

Është koha e fundit që vendet e botës së lirë dhe demokratike e të vlerave, SHBA dhe BE, t'i bëjnë me dije politikës së Beogradit se ky profil i shtetit dhe politikës së tillë nuk ka vend në familjen evropiane dhe në mesin e kësaj familje natyrisht se duhet të pastrohemi nga çështje të tilla, të cilat na vishen me etiketa të tilla, të cilat kanë derivuar nga politika e egër. Si dëshmi e kësaj është edhe procesi i Gjykatës së Hagës, i cili ka vërtetuar në përpikëri këto krime.

Dhe rastin më të mirë e ka nëse fillon t'i tregojë se ku ndodhën njerëzit tanë, të cilët padrejtësisht i ka marrë nga shtëpitë e tyre dhe ua ka humbur gjurmët.

Ftoj Qeverinë e Republikës së Kosovës që t'u përmbahet të gjitha rezolutave. Ne si komision kemi shikuar me kujdes të gjitha rezolutat, rekomandimet që edhe Kuvendi i Republikës së Kosovës në legjislaturat e kaluara i ka nxjerrë si obligim edhe për institucionet e vendit, por njëkohësisht edhe këmbëngulësinë që kjo çështje të insistohet edhe nga mekanizmat ndërkombëtarë.

Unë ftoj edhe kësaj here që kërjt këto rezoluta dhe rekomandime të respektohen dhe para së gjithash të jemi ne ata që i kryejmë detyrat tona, ngase siç kemi parë edhe nga rezoluta që është

ngritur, me dhjetë pikat që i ka, e shohim se disa janë vetëm detyra tona, siç është edhe ajo e drejtorit të Institutit të krimeve të luftës dhe çështje të tjera, të cilat duhet t'i bëjmë ne, në mënyrë që të kemi më shumë përgjegje për këtë kategori. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Flora Brovina në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës.

FLORA BROVINA: Të nderuara familje të personave të pagjetur,
Të nderuara familje që ende vuajnë për viktimat që i kërkojnë tanimë gati 20 vjet.
Të nderuar kolegë dhe kolege,
Kryetar i Kuvendit,
Dhe zoti ministër, i vetmi që ndodhet këtu për të na respektuar,
Unë mendoj se është keq që nuk ndodhet tërë Kabineti qeveritar,
Prej vitit në vit diskutojmë për ata që na mungojnë, prej vitit në vit e shprehim dhimbjen tonë edhe në këtë Kuvend, prej mandatit në mandat diskutojmë vetë me vete edhe nxjerrim rezoluta, të cilat prej mandatit të parë deri më sot i ngjasin të gjitha njëra-tjetrës, sepse kanë një përmbajtje.

Në rend të parë kemi kërkesën ose lutjen që bashkësia ndërkombëtare të ndikojë që Serbia sa më parë të zbardhë fatin e të pagjeturve, pastaj kërkesë tjetër shtrohet që të kushtëzohen bisedimet. Në të gjitha rezolutat ka qenë kërkesë që të kushtëzohen bisedimet me Serbinë me fatin e të pagjeturve. Në të gjitha rezolutat gjithashtu kërkohet raportimi çdo tre muaj ose gjashtë muaj që të raportohet se ku kemi arritur, por për fat të keq, numri i të pagjeturve shumë pak ka ndryshuar nga ajo që e dimë, kur ishin 2 mijë e sa dha tani janë të pagjetur 1 652 vetë dhe, për fat të keq, them, sepse e shohim se sa pak njerëz janë gjetur deri më sot.

Prej tyre më të zëshmit janë ata që e kanë kryer edhe fajin, domethënë kriminelët e Serbisë, sepse ata e ngrenë zërin edhe në qarqet ndërkombëtare, ndërsa dihet se në mesin e të pagjeturve më shumë se 75% janë shqiptarë, ndërsa të tjerët të komuniteteve të tjera. Kërkesa për gjetjen e atyre që mungojnë, që janë zhdukur gjatë luftës është një e drejtë elementare ndërkombëtare dhe është një plagë e madhe e tërë popullatës sonë, në veçanti e familjeve të tyre. Ne kemi edhe përvojën tonë historike të masakrës dhe zhdukjes së trupave në masakrën e Tivarit, për fat të keq që kurrë nuk u gjetën dhe kjo mbamendje historike sigurisht nuk duhet të na linte të qetë që të vazhdojnë 20 vjet dhe të komunikojmë me një zë, sado të shterur, për t'i kërkuar personat e pagjetur gjatë luftës në Kosovë. Ku janë? Ku janë këta njerëz që i kërkojmë që 20 vjet? Ku është Ukshin Hoti? Ku është Blerimi, Hasani, Iliri, Agroni? Ku janë të 1 652 bijtë tanë? Çka është kjo shurdhi dhe një zë i mekur nga Kosova që nuk e trondit Evropën për 20 vjet? Ata, pra Serbia, e di ku janë, sepse ka pasur institucione të rregullta ushtarake, qofshin ato paramilitare, por nën komandën e ushtrisë së Serbisë, ka pasur policinë këtu dhe ka mbajtur shënime, e dinë saktë si është bërë krimi, ku i ka fshehur viktimat dhe ku ndodhen ato?

Çfarë kërkuan shqiptarët e vrarë, të masakruar, çka kërkuan në poligonin e ushtrisë serbe në Batajnicë? Çka ndodhi me trupat e tyre të saponifikuar? Pse u hodhën në Danub? Për t'u fshehur krimi? Edhe saponifikimi ndodhi për t'u fshehur krimi! Po në Petrovosellë, çka kërkuan atje? Mbi varret e tyre, madje u shtrua edhe asfalti sikur ndodhi në Rashkë. Ku janë varret e tjera masive në Serbi? Cila rezolutë u realizua deri tani? Kolegia ime foli për rezolutat, të drejtën të them, jam shumë e pakënaqur, edhe në emër të partisë flas, për realizimin e rezolutave deri tani. Ne kemi arritur mbas 20 vjetëve dhe në rregull është që flasim për pajtimin, por pajtimi pa u zbardhur fati i tyre që janë zhdukur nga shteti i Serbisë.

Bashkësia ndërkombëtare, po të dojë, mund të na ndihmonte më ndryshe dhe më mirë në zbardhjen e fatit të tyre. Ka metoda të sofistikuara që mund të gjejnë varret masive, madje-madje ka edhe metoda të detyrimit të Serbisë, në bazë të konventave ndërkombëtare që ajo ta zbardhë fatin e këtyre. Po ne, çka bëjmë vetë? Nuk jam e kënaqur as me atë që bëjmë ne vetë. As dokumentet origjinale të ekshumimit të kufomave në Batajnicë nuk i kemi, këto i mban Ministria e Drejtësisë e Serbisë. Prandaj, në qoftë se duam të ngremë padi ndaj Serbisë, padi për gjenocid, ne duhet t'i kishim edhe dokumentet, edhe Kryqi i Kuq Ndërkombëtar duhet të luante një rol tjetër, pra të bënte dy origjinale që ne ta kemi dokumentin.

Asnjë akuzë nda Prokuroria e Shtetit nuk është ngritur që të bëjë presion direkt në Qeverinë e Serbisë që të zbardhet fati, edhe atëherë kur kemi mjaft argumente për këtë. Madje do të përmend, në mandatin e parë të këtij Kuvendi ishte thirrur prokurori i shtetit, atëherë zoti Zhitia, që t'u ndihmojë familjarëve që të japin dëshmi se si u zhdukën familjarët e tyre. Por, për fat të keq, mbas një mbledhje s'e di çka ndodhi. Sot, nuk kemi akuza të tilla dhe nuk punohet mjaft që të argumentohet zhdukja, krimi dhe zbardhja, të bëjmë më shumë presion në këtë pikëpamje, domethënë të argumentuar dhe nga ana e Prokurorisë të ngrihet padi për gjenocid, sepse si mund të quhet ndryshe përveçse gjenocid hedhja e viktimave në Danub ose saponifikimi i kufomave në Batajnicë për t'u zhdukur, ose pas 20 vjetëve një numër prej 1 652 personave që nuk dihet ku janë.

A duhet të rritej Andini, i biri i Ukshin Hotit, që ta thërrasim edhe këtë takim dhe të flasim shtruar për këtë çështje. A duhet që Sarandës sadopak t'i pushojnë plagët e dhembjes, të cilat asnjëherë nuk do t'i pushojnë, që të mblidhemi dhe ta ndjejmë pak më mirë bashkë me ta, këtu ka edhe persona të tjerë që të njëjtën dhimbje e kanë, që ta ndjejmë më mirë dhimbjen së bashku me familjarët. Ne e zgjatëm dorën e pajtimit prej mbarimit të luftës, duke pritur që dikush të na bashkohet, pra të na ofrojë edhe Serbia mundësinë e pajtimit, por asnjëherë nga ne nuk u kërkua falja, asnjëherë nuk u tha e vërteta për krimet. Më herët foli Saranda, madje kriminelët i kanë zënë edhe pas disa vjetësh, shumë pak vitesh të dënimit nëpër burgje e krejt formalisht, edhe të lirohen dhe kjo dhimbje sa vjen e shtohet.

Një ditë dita e pajtimit do të vijë, por asnjëherë nuk do të ndodhë, ne nuk do të pushojmë së kërkuari ata që nuk i gjejmë, asnjëherë nuk do të pushojmë së kërkuari që kryerësit e krimit të dënohen, sepse vetëm ky është satisfaksioni i dhimbjes sonë. Besoj që grupi iniciues për këtë debat do ta nxjerrë një dokument dhe unë propozoj që në këtë dokument patjetër të kemi kërkesën për zbatimin e konventave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, e që bën fjalë për personat e zhdukur dhe të drejtat që familjet e tyre të dinë për vendndodhjen e masakrës dhe vendndodhjen e kufomës. Gjithashtu kërkoj që Prokuroria e Shtetit të fillojë ngritjen e akuzave për krimet dhe për gjetjen e varrezave masive dhe zhdukjen e personave. Kërkoj kjo të bëhet për varrezat masive në Batajnicë, në Petrovosellë, për varrezat këtu në Kosovë, për krimet në Kosovë, gjithashtu kërkoj që të fillojë akuza shtetërore për humbjen ose zhdukjen e Ukshin Hotit. Kërkoj gjithashtu që të kërkohet zbardhja e masakrës në Dubravë, sepse edhe këtë e ka kryer shteti i Serbisë, përveç tjerave. Kosova duhet të kërkojë edhe ndihmën ndërkombëtare dhe Serbia ta lejojë që në Petrovosellë, Batajnicë dhe në varreza të tjera në Serbi të ngrihen përkujtimore për personat e zhdukur dhe të gjetur atje dhe parqet përkujtimore. Nëse shteti ynë nuk do të ketë mjete mjaft për të ngritur këto përkujtimore në Serbi, në shenjë të krimeve që ndodhën në Kosovë, atëherë kërkoj një solidaritet edhe në mesin e deputetëve, të ndajmë një shumë të hollash nga të ardhurat tona, qoftë edhe 1% gjatë një mandati që këto përmendore të ngritën edhe në emrin tonë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zonja Brovina! Ministri i Punës dhe i Mirëqenies Sociale, zoti Skender Reçica, e ka fjalën, pastaj vazhdojmë.

MINISTRI SKENDER REÇICA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar familjarë të personave të pagjetur,

Debati i sotëm parlamentarë për personat e pagjetur, sa është emocional, po aq është edhe obligues për të gjithë ne.

Personat e pagjetur, si pasojë e luftës në Kosovë, janë dhe mbeten barra dhe kujtesa jonë e përgjithshme. Kjo barrë ende po vazhdon, sepse ende kemi fëmijë, gra e burra, për fatin e të cilëve nuk dihet, pra plagët janë ende të hapura. Lufta e la Kosovën me mbi 6 000 persona të zhdukur. Deri më tani, më shumë se 4 000 persona janë identifikuar. Edhe pse 19 vjet pas luftës, ende kanë mbetur rreth 1 600 persona, për fatin e të cilëve ende nuk dihet dhe familjarët e tyre me të drejtë duan të dinë se ku i kanë më të dashurit e tyre. Ngjarjet të cilat kanë ndodhur në Kosovë peshojnë rëndë mbi supet e njerëzve, të cilët kujtojnë dhembjen dhe nuk harrojnë padrejtësitë që i janë bërë këtij populli dhe kjo është e natyrshme dhe njerëzore.

Të nderuar deputetë,

Të nderuar familjarë të personave të pagjetur,

Edhe pse ndihma dhe mbështetja nuk mjafton për të shlyer dhembjet e familjarëve, megjithatë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale të paktën në mënyrë financiare ka mbështetur dhe mbështet edhe më tej familjarët e personave të pagjetur ose të zhdukurve. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale është përfaqësuar me një anëtar në Komisionin Qeveritar për Persona të Pagjetur dhe ky anëtar bashkëpunon ngushtë me komisionin, duke dhënë informacion në fushën dhe ndërlidhjen e kësaj çështje me fushë veprimtarinë e Ministrisë Punës dhe Mirëqenies Sociale. Në kuadër të Ministrisë së Punës ne kemi shtatë zyra regjionale, të cilat janë të shtrira në regjione dhe këto zyra zbatojnë Ligjin nr. 04/L-023, për personat e zhdukur, në aspektin procedural dhe administrativ.

Në këtë rast dua të potencoj se familjarët e personave të zhdukur, të pagjetur, gëzojnë të drejta dhe beneficione sipas Nenit 13, të Ligjit nr. 04/L-023 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjarëve të tyre, për beneficione të veçanta. Nga baza e të dhënave që kemi ne si Ministri e Punës, kanë aplikuar një numër i konsiderueshëm i familjeve të personave të pagjetur për të fituar të drejtën në pensione dhe beneficione dhe tashmë këtë të drejtë e gëzojnë.

Sa i përket çështjes së përfitimit në pensione dhe beneficione, të nderuar, ju njoftoj se me Ligjin aktual nr. 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti, personi i cili është përfitues i cilitdo pension të përcaktuar me ligj, nuk mund të jetë përfitues i ndonjë kompensimi tjetër, qoftë të kategorive të dala nga lufta, qoftë edhe nga përfitimi i beneficionit për personat e pagjetur. Ne si ministri tashmë kemi dërguar në Qeveri Projektligjin për Plotësim ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-131 dhe kemi propozuar që përfituesit e pensionit kontributpagues të moshës dhe pensionit bazik të moshës, të kenë të drejtë edhe në përfitimin e pensionit familjar, të cilin e realizon familja e ngushtë e dëshmorit, familja e ngushtë e të zhdukurit të UÇK-së, familja e ngushtë e viktimës civile të luftës, viktimat të dhunës seksuale të luftës dhe familja e ngushtë e të zhdukurit civil, të përcaktuar sipas Ligjit në fuqi për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, vVetëranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre dhe ligjit të amendamentuar.

Me këtë rast dua të theksoj se së paku në aspektin financiar duhet të jemi shumë të kujdesshëm që të paktën të mos u hyjmë në hak këtyre familjarëve dhe të mos i privojmë gjithashtu nga e drejta përfituesit të cilët kanë derdhur djersë me kontributin e tyre.

Të nderuar të pranishëm,

E di që ndihma financiare nuk shlyen plagët e familjarëve të personave të pagjetur, nuk shlyen plagët e viktimave të dhunës seksuale dhe nuk shlyen plagët për heronjtë dhe dëshmorët e rënë për lirinë e Kosovës, por ne e kemi obligim që të punojmë fort që ky vend të zhvillohet ekonomikisht, të ketë arsim më cilësor, shëndetësi dhe mbi të gjitha punë dhe mirëqenie sociale, për të cilën jemi duke u angazhuar shumë.

Në fund dua të theksoj se është paraparë në kuadër të rezolutës që do ta miratojmë në fund të këtij debati Parlamenti Projektligji për personat e pagjetur. Ju siguroj që Ministria e Punës, por dhe unë si ministër, do të jemi në shërbim që ky ligj sa më parë të procedohet në Kuvend dhe si ministri do të japim kontributin në çdo moment që do të kërkohet. Faleminderit!

KRYETARI: Albin Kurti e ka fjalën!

ALBIN KURTI: Të dashur familjarë të të pagjeturve,
Qytetarë të Republikës,
Deputetë të Kuvendit,
Kabinet i Qeverisë,

Sot është Dita e të pagjeturve, 27 prilli dhe ne, 19 vjet pas luftës, para e gjatë së cilës këta bashkatdhetarë tanë u zhdukën, gjendemi në një situatë të turpshme. Them të turpshme, sepse gjatë këtyre 19 vjetëve pak është bërë për të rritur trysnin ndaj Serbisë përgjegjëse për zhdukjen e tyre. Përkundrazi, ajo çka kishim e kemi janë lojëra. Lojëra të pushtetarëve të Kosovës që sillen sikur historinë ta kenë pronë të tyre, duke kthyer në kapital e në përfitim personal meritat e luftës, gjakun e dëshmorëve, sakrificën e martirëve, por edhe dhimbjen e pakufishme e mallin e padurim për të pagjeturit. Në anën tjetër, edhe lojëra të pushtetarëve të Serbisë, të cilët kurrë nuk kanë treguar as edhe prirjen më të vogël për të marrë seriozisht kërkesat për të hulumtuar rastet e të pagjeturve, e për të vepruar sipas parimeve të drejtësisë ligjore apo të moralit bazik human.

Një filozof bashkëkohor gjerman, i cili ka ndërruar jetë para disa vjetësh, Hans Gadamer, thoshte: “Historia nuk na përket, por ne i përkasim asaj”. Dhe, sot është dita kur duhet ta kemi këtë në dijeni si asnjëherë tjetër. Sot, kur 19 vjet pas mbarimit të luftës në Kosovë edhe 1 652 persona vazhdojnë të figurojnë të zhdukur. Sot, kur e shohim që e kaluara nuk shkon.

Sigurisht, sot në këtë Kuvend të gjithë do të mbajnë një pozë serioze, solemne, pushtetarë e ish-pushtetarë, që për kaq vite me radhë nuk bënë gjë. E si të kryhet seanca, do të kthehet secili në përditshmërinë e vet. Ndërkohë mungojnë 1 652 njerëz, e njerëzit janë e vërteta e një shteti. Mungon e vërteta për ta, mungon drejtësia për ta, mungon ngushëllimi për familjet e përgjegjësia për fajtorin. Pyetjet e familjarëve, por edhe pyetjet e secilit person që ka një ndërgjegje qytetare apo kombëtare vazhdojnë të mbeten të njëjtat. Janë të gjallë apo të vdekur? Nëse janë vvarë, a ndodhen në ndonjë varrezë masive apo ndoshta trupat e tyre janë djegur nëpër shkritore?

Dikur, disa herë gjatë vitit, ktheheshin nga Serbia dhjetëra thasë me numra që përmbanin nga një grumbull jo të plotë të eshtrave. Shumë familje kosovare u detyruan t’i hapin sërish varret e më të dashurve të tyre për të varrosur edhe eshtrat e një gjymtyre të tyre që u kthye më vonë. Dikur moti kjo, sepse sot ka ngecur gjithçka sa i përket zbardhjes së fatit të të pagjeturve. Normalizimi i marrëdhënieve me Serbinë është zhvilluar duke harruar edhe historinë që e përjetuam.

Nëse nisim dhe rrëmojmë të kaluarën, atëherë do të dalin krime të mëdha dhe të tmerrshme. Kjo do t'ia dobësonte pozicionin Serbisë karshi Kosovës, të cilën ajo ende nuk e njeh si të pavarur. "Historia është mësuese e mirë", kanë pohuar shumë dijetarë, mirëpo qeveritarët tanë e ish-qeveritarët tanë, siç edhe dihet tashmë botërisht, nuk kanë qenë ndonjëherë nxënës të mirë dhe për këtë nuk kanë faj mësuesit e as historia. Një prej presidentëve më të shquar amerikan, Abraham Linkoln, thoshte se ajo çka ka ndodhur një herë, doemos që ndodh përsëri, pra historia përsëritet, nëse rrethanat lejohet të kombinohen sërish në të njëjtën mënyrë. E pushtetarët tanë po lejojnë, madje po nxisin rikrijimin e të njëjtave rrethana si në Bosnjë, me 'Zajednicën' famëkeqe që më pas atje u bë Republikë Serbe e shkaktoi spastrim e homogjenizim etnik. Në vend se të kujdesen që të vihet në vend drejtësia për viktimat civile e për martirët, në vend se të çojnë përpara projektin e dëshmorëve, në vend se të kërkojnë rikthimin e të pagjeturve, këta bëhen pjesë e planeve të Serbisë, e cila vazhdon avazin e vjetër.

Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Në qershor të vitit 1999, me rastin e tërheqjes së forcave serbe nga Kosova, mbi 5 000 shqiptarë u morën peng dhe u dërguan në Serbi. 2 050 prej tyre përfunduan në burgje zyrtare. U liruan në grupe të vogla përgjatë tri vjetëve të ardhshme, të tjerët u shpallën të zhdukur. Jo vetëm personat e rrëmbyer, por edhe familjet e tyre janë viktimat të këtij krimi të vazhdueshëm. Familjet e të pagjeturve janë në ankth ose madje edhe të traumatizuara. Përherë ka qenë shumë rëndë për to që të shohin zhvarrosjet nëpër Serbi dhe se si kufomat mbesin në duart e kriminelëve që i kanë vvarë ata. Përkundër gjithë kësaj, familjarët e të pagjeturve asnjëherë nuk e kanë ndalur angazhimin. Edhe atëherë kur arrestoheshin nga policia e Kosovës, me urdhër të qeveritarëve tanë, për shkak të prishjes së rendit të qetësisë publike. Edhe atëherë kur dihej se sukcesi i aktivizimit të nënave ishte veçse ca thasë të kthyer nga Serbia me eshtrat e djemve të tyre. Ato përherë kanë kërkuar përgjegjësi dhe drejtësi nga autoritetet për të arritur tek e vërteta për më të dashurit e tyre.

Por, çështja e pengjeve të pagjetura gjithsesi tejkalon dimensionin e problemit të familjeve të tyre, ai është problem edhe i Kosovës, i të gjithë neve, i secilit prej nesh. Është detyrë jona që këtë problem ta ndërkombëtarizojmë, ta bëjmë problem të kontinentit tonë, pse jo të botës mbarë. Të gjithë ata që thirren në vlera të qytetërimit duhet ta njohin, ta mësojnë, ta dinë tragjedinë tonë, sepse popullin tonë të shtypur e të dhunuar, pa ia dhënë kurrë drejtësinë që i takon, kanë nisur ta shohin si pjesëmarrës në dhunë. Pse? Për shkak se udhëhiqet nga një kastë politikanësh të kthyer në biznesmenë, e cila për të ruajtur pushtetin e vet, ka pranuar të negociojë e të bëjë pazar me gjithçka, duke shitur edhe vlerat e luftës, edhe respektin për viktimat.

Të pagjeturit të gjithëve na mungojnë, e me këto fjalë shpreh dhembshurinë dhe pikëllimin e të gjithë neve për të gjithë ata që s'janë me neve sot, por shpreh edhe respektin tonë për dinjitetin e tyre individual. Për ne këta njerëz nuk janë numra, por individë, çështja e tyre nuk është statistikë, por është problem humanitar dhe kombëtar. 836 shqiptarë janë gjetur vetëm nëpër varrezat masive në Batajnicë, afër Beogradit, kurse dhjetëra të tjerë janë nxjerrë nga lumenjtë e

liqenet, ku Serbia u mundua ta fundoste të vërtetën e saj. Çështja e të zhdukurve e bën të pamundur përfundimin e konfliktit, pajtimin dhe një fillim të ri të marrëdhënieve të Kosovës me Serbinë dhe të popujve të këtyre dy vendeve. Lufta e shkatërroi jetën e shumë njerëzve, por ndërtoi kujtime të hidhura të pashlyeshme. Është dhimbje e thellë, por edhe vuajtje e gjatë, u vranë në Kosovë, u varrosën në Kosovë, u zhvarrosën në Kosovë, u varrosën në Serbi, u zhvarrosën në Serbi, u rivarrosën në Kosovë dhe pjesërisht, sepse jo të gjithë u gjetën dhe pjesërisht, sepse jo të gjithë eshtrat iu kthyen të gjeturve.

Deputetë të Kuvendit,

Zgjidhja e vetme është drejtësia, por jo një drejtësi abstrakte. Drejtësia restauruese është e domosdoshme, e për të janë të nevojshme gjykata të pavarura në Kosovë e në Serbi, shumë vullnet politik e njerëzor, gjetje dhe mobilizim i dëshmimeve dhe dëshmitarëve, kompensim për viktimat. Ne si subjekt opozitar do të përkrahim çdo nismë që shtyn në këtë drejtim, nëse koha shëron plagët shpirtërore të të gjallëve për të vdekurit, ajo i rrit ato kur bëhet fjalë për personat e pagjetur. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë, do ta vazhdojmë seancën pas shfaqjes së një dokumentari, është përmbledhje e fateve të familjarëve dhe të personave të pagjetur. E ftoj regjinë që ta fillojë shfaqjen e dokumentarit.

(Shfaqja e filmit dokumentar)

* * *

KRYETARI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar i Deputetëve të Pavarur, e ftoj zotin Driton Çausi që ta marrë fjalën.

DRITON ÇAUSHI: Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Shumë të respektuar familjarë dhe më të dashur të të pagjeturve,

Kolegë deputetë,

Nuk mund të jetë në asnjë mënyrë e lehtë asnjëherë të flasësh për të pagjeturit, sidomos kur flet në një datë siç është 27 Prilli, pra masakra e Mejës, ku e humbën jetën 376 viktima civile dhe për të cilët u deshën vite me radhë që të identifikohen dhe të sillen te më të afërmit e tyre.

Sidoqoftë, sot është shumë më lehtë të flasësh për këtë temë për faktin se përballë meje, ose përballë nesh, nuk janë familjarët, nënat, prindërit, fëmijët, vëllezërit e motrat e të të pagjeturve dhe sidomos për faktin se nuk jemi pjesë e një talljeje tradicionale e institucionale në cirkun që quhet “homazhe”, e kur nga pushtetarët përsëriten çdo vit gënjeshtër se të pagjeturit janë

prioriteti ynë, se ata do të jenë prioritet në dialogun e Brukselit, e se përgjegjësit e këtyre krimeve do të dalin para drejtësisë.

1 652, ky është numri i të pagjeturve në Kosovë, që po përsëritet. Secili e ka një emër, normalisht se të gjithë janë të barabartë, kështu që nuk do të përmend emra. Me gjithë keqardhjen që mund ta ndiejmë, kur ky fakt ose kjo shifër përsëritet, te një çështje siç janë të pagjeturit, numrat asnjëherë nuk na shërbejnë mirë për ta trajtuar këtë çështje. Po, janë 1 652 viktima civile të pagjetura. Natyrisht se për të qenë të drejtë do të duhej të thoshim se në fakt janë dhjetëra mijëra viktima, vëllezër, motra, nëna, baballarë, fëmijë, për të cilët terrori vazhdon për 19 vjet. Në fakt, edhe kur themi 19 vjet shmangemi nga e vërteta e vuajtjes së tyre. Si mund ta ndiejmë ne atë që ata përjetojnë?

Ne mund të ndajmë disa minuta me familjet e tyre vetëm në këto data të shënuara, siç është 27 Prilli, pak më shumë minuta nëpër fushata elektorale, por dhembja e tyre është e përditshme, është dhembja e ditëlindjeve, e festës së Vitit të Ri, e secilës mbrëmje kur i kujtojnë të dashurit e tyre, duke i parë vitet që ikin shpejt e kanë vetëm një shpresë. Besoj që këtu jam i saktë. Është një kërkesë modeste, duke parë që vitet shkojnë shpejt, që të mos vdesin para se ta marrin vesh se ku janë. Nuk po flasim për familjarët e gjallë të tyre, por “Ku janë?” Kjo është kërkesa e vetme e tyre.

Një dhembje e tillë nuk të pyet për përkatësi etnike dhe mendoj se është korrekte dhe e drejtë të thuhet se kur e përdorim këtë shifër, 1 652, rreth 500 viktima të pagjetura janë të komuniteteve joshqiptare.

Natyrisht se është e qartë besoj për secilin prej nesh se ku bie barra e përgjegjësisë. Në një dhunë sistematike të një shteti, në një spastrim etnik do të duhej që natyrisht barra të ishte e atij shteti, që të merrej me të kaluarën dhe të jepte përgjegjësi dhe drejtësi për këto viktima. Besoj se e dimë që institucionet e drejtësisë në Serbi janë marrë me diku 25 raste, jo vetëm me të pagjeturit, por në totalin e rreth 10 mijë viktimave shqiptare në Kosovë. E pamë nga kolegja Bogujevci se edhe ato pak raste që janë trajtuar nuk e marrin drejtësinë përfundimtare dhe nuk janë në gjendje të përballen me të kaluarën. Por, natyrisht se dhjetë vjet shtet nuk mund ta shmangim përgjegjësinë tonë për të gjitha këto viktima, për të gjithë këta 1 652 civilë të vrarë dhe e dimë se vetëm mund të përsëritemi. Kjo çështje është neglizhuar dhe asnjëherë nuk ka qenë temë e debatit në dialogun e Brukselit.

Këto viktima kërkojnë vetëm pak dinjitet. Këtë dinjitet e meritojnë edhe familjet e tyre. Unë, thënë të drejtën, nuk kam shpresë që do të ketë një ndryshim rrënjësor në trajtimin e kësaj çështjeje, për shkak se është thënë shumë, e nuk është vepruar fare. Megjithatë, do ta shfrytëzoja këtë mundësi t’ia kujtoja Qeverisë Haradinaj se e ka rastin që për herë të parë të dalë para këtyre qytetarëve, ta trajtojë këtë çështje me peshën dhe me barrën që e meritojnë. Për herë të parë, nëse

e trajtojmë seriozisht, natyrisht se nënkuptohet se kjo çështje duhet të jetë kusht në bisedimet e Brukselit, për këtë e kam fjalën. E kam fjalën për trajtim institucional. Faleminderit!

KRYETARI: Zotëri Ahmet Isufi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së.

AHMET ISUFI: Të nderuara familje të të pagjeturve,

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar kryetar i Kuvendit,

Pas dokumentarit që u shfaq pak më herët, fjalët tona janë të tepërta dhe duhet të kursehemi shumë, sepse e prekim një plagë, e cila po vazhdon edhe pas 19 vjetësh, e që kur vendi ynë po hynte në fazën e fundit të luftës për liri me mbështetjen e NATO-s dhe me një popull shumë aktiv, okupatori e përdori krejt arsenalin për t'i zhdukur qytetarët e Kosovës. Disa javë më vonë ky pushtues kapitulloi, Kosova u çlirua, populli u kthye në vendlindjen e vet. Shumë të vrarë e të varrosur anekënd Kosovës po rivarroseshin me respektin dhe nderin më të madh, por plaga e cila mbeti e hapur është plaga e të pagjeturve, që edhe më tutje është brengë e çdo njeriu që pak ka ndjenjë, madje edhe pavarësisht nga nacionaliteti, pavarësisht nga bindjet, sepse kemi të bëjmë me një terror, me një gjenocid, me një veprim antinjerëzor, që ka ndodhur në Kosovë. Dhe, këtë më së miri e përshkruan një familjar, një prind, i cili, thënë më autentikisht, i thotë Dautit që është i ulur aty, i cili e kishte vajzën të zhdukur e djalin dëshmor, "Më qejf kisha pas ta kisha varrin e çikës se të më ngjallej djali". Kjo thënie e ka kuptimin më të plotë të asaj që ka ndodhur në Kosovë, e që ne njerëzisht duhet ta shikojmë këtë problem duke u thirrur në institucionet tona, që ta bëjnë të pamundurën në angazhimin e tyre që trupat e të pagjeturve të kthehen në Kosovë.

Rezoluta që do të dalë nga ky Parlament duhet të jetë përmbajtjesore që fton, edhe shoqatat, edhe individë të caktuar, po sidomos institucionet e vendit, në këtë rast edhe Qeverinë, që çdo ditë të bëjnë veprime, të cilat mundësojnë kthimin e të pagjeturve në Kosovë. Unë e di që është hapur një zyrë në kuadër të Qeverisë, e ka një angazhim të drejtpërdrejtë edhe të kryeministrit, e ka emëruar një këshilltar, zotin Jahja Lluka, që duhet në vazhdimësi të këmbëngulë në realizimin e një qëllimi, kthimin e të pagjeturve në Kosovë.

Prandaj, nuk po e zgjas më shumë, por në këtë ndjenjë jemi, së pari si njerëz, pastaj duhet të kemi shumë kujdes në fjalorin tonë, të mos lëshohemi në fraza të cilat mund ta lëndojnë shpirtin e cilitdo familjar që ende nuk i kanë gjetur të dashurit e tyre. Faleminderit!

KRYETARI: Jasmina Zhivković në emër të Grupit Parlamentar Lista serbe.

JASMINA ŽIVKOVIĆ: Hvala, predsedniče!

Ova tema nije nimalo laka ni za pokretanje debate, ni za pričanje o njoj, ni uopšte za preživljavanje ove teme.

Nažalost, jedna ovako ljudska i humanitarna tema već odavno je postala politička tema i nažalost, ja se obraćam pre svega članovima porodica kidnapovanih i nestalih, koji se vode kao nestali i sama kao član porodice, to da je ovo postala više politička tema, i da se sve izvrgava u suprotnosti onome što je ljudski i ono na čemu svi trebamo raditi jeste nažalost i danas više prazne klupe poslanika nego pune klupe, a tema je ovako važna i tema je ovako bitna.

Ja nikad ne ističem broj zato što je za članove porodice korišćenje brojki vrlo uvredljiva. Sve su to ljudi koji su kidnapovani i čiji je život promenjen samih njih, a naravno i članova porodica. Ja danas ne želim da ističem ni slučaj svog oca, ni svog strica, zato što smatram da svi zaslužuju jednako tretiranje, jednaku istinu i jednako postupanje svakom pojedinačnom slučaju, i jednaku pažnju, jer je i jedan slučaj puno kada je kidnapovanje u pitanju, i da se ta lica još uvek vode kao nestali.

Ja danas nemam ni film o svom ocu, niti o bilo kom drugom, ali mogu vam reći da je patnja i moje majke i ostalih srpskih majki ista, i da se te majke mogu međusobno razumeti. Jako je puno bola zato što je teško doći do istine. Teško je doći do istine i iz razloga zato što se opet ovo pitanje uplelo u politiku. Teško je doći do istine na politički način, zato što se mora priznati da su određena junaštva činjena nad civilima, jer su kidnapovani koji se vode kao nestali civili, koji su kidnapovani jedni zato što su Srbi, jedni zato što su Albanci.

Potrebno je nakon 19 ili 20 godina, i verujem da me porodice mogu razumeti, jer ja danas ne želim da pričam kao političar i da time vređam porodice, ali da porodice mogu me razumeti da je vreme da zajedno tražimo da je vreme da se izađe sa istinom, jer ja verujem i znam da porodice znaju da istina nije sakrivena, da je istina poznata, smo se još uvek nije izašlo sa tom istinom, i bojim se da će možda proći još vremena kada se društvo i kada se oni koji su radili zločine budu spremni da se suoče sa istinom.

Ova rezolucija koja je pripremljena za danas, nažalost je pripremljena jednostrano, jer moram da ponovim da glasovi kidnapovanih Srba ne ostanu nemi, da je hiljade Srba takođe kidnapovano i vode se kao nestali, i da tu tajnu krije Kosovo. Sve ovo što se današnjom rezolucijom traži od odgovornih institucija, da ih ne nabrajam one koje su ovde nabrajane, potrebno je da i samo Kosovo nudi isto to, jer se jedino tako može doći do istine, i da članovi porodice konačno ne budu na najniži način vređani tako što se još uvek skriva istina, a vode se samo političke debate i politički dogovori bez pravog razumevanja onoga što je porodicama zaista potrebno, i ono što kidnapovani, a koji se još uvek vode kao nestali, zaslužuju.

Hvala i nadam se razumevanju od strane kolege!

KRYETARI: Përfaqësuesi i Grupit Parlamentar Nisma, Albulena Balaj-Halimaj.

ALBULENA BALAJ-HALIMAJ: Po i them zonjës nga Lista serbe se këtu nuk ka politikë, këtu ka histori. Kosova është ndërtuar mbi një histori të madhe dhe shumë të dhembshme. Ju po mundoheni t'i barazoni viktimat. Mos u viktimizoni, sepse viktimat nuk janë të njëjta.

Nëse jeni vërtet të interesuar të punoni në këtë çështje, atëherë edhe ju si Listë serbe ushtroni presion në institucionet tuaja në Beograd që të na ndihmojnë dhe bashkë t'i gjejmë këta persona.

Të nderuar qytetarë,

I nderuar kryetar,

Kolegë deputetë,

Është me të vërtetë për të të ardhur keq që gati dy dekada pas përfundimit të luftës ende nuk është ndriçuar fati i të gjithë personave të pagjetur. Është e pafalshme që 19 vjet pas luftës, përpos që u vranë pa asnjë faj, ata u dërguan në territorin e Serbisë dhe sot e kësaj dite nuk dihet asgjë për fatin e tyre. Kjo është e papranueshme dhe jo vetëm për familjet e tyre, por për gjithë shoqërinë tonë.

Kur e shohim gjendjen në të cilën jemi tani lidhur me të pagjeturit shtrojmë shumë pyetje dhe dilema. Pse nuk kemi bërë më shumë për të pagjeturit? Nuk jemi angazhuar mjaftueshëm, apo nuk kemi mundur të bëjmë më shumë për të adresuar këtë problem, që prek thellësisht, sikur thashë më lart, jo vetëm familjet e tyre, por prek edhe në emocionet e çdo qytetari të Republikës së Kosovës? Përkundër faktit se që nga shpallja e pavarësisë e deri më tani edhe në këtë Kuvend është diskutuar lidhur me këtë temë, asnjëherë nuk është bërë mjaftueshëm që çështja e personave të pagjetur të zgjidhet njëherë e përgjithmonë. Madje, në vitin 2012, pikërisht ky Kuvend kishte nxjerrë edhe një rezolutë për çështjen e të pagjeturve, mirëpo që asnjëherë nuk është respektuar dhe sikur edhe shumë rezoluta të tjera ka mbetur vetëm në letër.

Tentimet tona që problemin e personave të pagjetur ta adresojmë në nivel krejt teknik, siç jemi të gjithë dëshmitarë, janë penguar dhe vazhdojnë të pengohen nga Serbia. Deri më tani ne nuk e kemi parë një vullnet të Serbisë për ta zgjidhur këtë çështje dhe se vullneti i tyre ka qenë më shumë i bazuar në kalkulime politike, varësisht nga interesi momental politik i tyre. Ne është dashur më herët ta shndërrojmë në prioritet shtetëror dhe të ndërmarrim masa më rigoroze në raport me Serbinë, në mënyrë që ta arrijmë efektin e duhur për ta adresuar problemin e të pagjeturve. Tani është momenti i fundit që kjo çështje të zgjidhet. Tani, në fazën finale të dialogut, çështja e personave të pagjetur duhet të shndërrohet në top-prioritet të kësaj faze të dialogut. Madje, insistoj që çështja e të pagjeturve të jetë parakusht për vazhdimin e dialogut.

Vetëm kështu do të mund t'i hapet rrugë edhe ndërtimit të raporteve normale në të ardhmen me Serbinë. Nuk mund të ketë një dialog të mirëfilltë dhe me rezultat pa e pasur një epilog dhe një marrëveshje konkrete, e cila e zgjidh çështjen e këtyre njerëzve. Tanimë vetëm nivelet e deklarimeve politike, debatet në Parlament dhe deklaratimet se çështja e të pagjeturve do të

zgjidhet, nuk mjaftojnë. Ne si Kuvend, por edhe Qeveria, duhet të vendosë kushte të qarta për Serbinë, në mënyrë që të arrijmë në rezultate konkrete.

Duke u bazuar në gjendjen në të cilën jemi për momentin, si dhe preokupimin shumëvjeçar të shoqërisë dhe shtetit tonë për t'i dhënë zgjidhje kësaj odiseade, mendoj se Kuvendi duhet ta rikonfirmojë edhe një herë rezolutën e votuar kohë më parë, pra në vitin 2012, për personat e pagjetur. Faktorët ndërkombëtarë, SHBA-të dhe BE-ja, duhet të ushtrojnë presion ndaj Serbisë, në mënyrë që ajo të detyrohet të bashkëpunojë me një dinamikë më të madhe që kjo çështje të zgjidhet. Përveç veprimeve konkrete, si nga Kuvendi, ashtu edhe Qeveria, e shoh si shumë të efektshme edhe nevojën për krijimin e një konsensusi politik ndërmjet të gjitha partive politike, në mënyrë që kësaj çështjeje t'i qasen pak më ndryshe dhe jo siç është vepruar deri më tani, në mënyrë ad-hoc dhe pa një politikë të qartë shtetërore. Faleminderit!

KRYETARI: Zonja Zhivković e ka kërkuar ndërkohë fjalën.

JASMINA ŽIVKOVIĆ: Hvala predsedniče!

Moram da se odazovem ovaj nažalost tvrdim i sigurno sam da ovo pitanje više nego iz politizovano, jer nakon 19 godina da se ne dođe do istine ne može drugačije nego samom tim što se uprela politika.

Druga stvar odvajanje žrtve je više nego diskriminacija i više nego vređanje i malte ne bezobraznog, jer su žrtve kidnapovani koji se vode kao nestalih podjednako istim bolje ista.

Srpska lista danas prisutna ovde, svi članovi Srpske liste su rođeni i žive na Kosovu, možemo li mi dobiti odgovor ovde da bi smo posle zajedno sve tražili druge odgovore. Hvala!

KRYETARI: Albert Kinoli, Grupi Parlamentar "6+".

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit, zoti Veseli,

E nderuar zonja ministre,

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Të nderuar ju familjarë të personave të pagjeturve në Kosovë,

Në emër të Grupi "6+" dëshiroj t'i them disa fjalë lidhur me temën, për të cilën jemi mbledhur sot, e që ka të bëjë me personat e pagjetur në Kosovë.

Për të diskutuar për personat e pagjetur në Kosovë më besoni me sinqeritetin më të madh ju them që personalisht nuk e kam të lehtë dhe nuk mund të jem shumë profesional kur diskutohet për këtë temë, sepse në qoftë se sado pak kemi shpirt human dhe vendosim veten në petkun e familjarëve të të pagjeturve, e vërejmë se sa e dhimbshme është kjo temë, e më e dhimbshme bëhet kur e dimë që mbi 1652 persona ende llogariten të pagjetur në Kosovë.

Familjarët e të pagjeturve kanë të drejtë të pamohueshme të dinë për fatin e familjarëve të tyre të pagjetur, të jenë të informuar lidhur me vendndodhjen dhe rrethanat e zhdukjes së tyre. Kështu thuhet edhe në nenin 5 të Ligjit për personat e zhdukur.

Shteti, së bashku me ne, me secilin nga ne e ka për obligim të angazhohet në zbardhjen e fatit të të pagjeturve.

Si deputet të zgjedhur nga vullneti i popullit, si politikëbërës, por edhe si qytetarë duhet të jemi të shqetësuar me neglizhimin që u bëhet personave të pagjetur dhe familjarëve të tyre, duke mos u angazhuar sa duhet në zbardhjen e fatit të të pagjeturve në Kosovë.

Këtë e them, sepse edhe 19 vjet pas përfundimit të luftës së Kosovë dhe 10 vjet nga shpallja e pavarësisë, shteti ynë ende nuk e ka prioritet këtë çështje, duke i lënë familjet e personave të pagjetur ende nën akthe, për të marrë ndonjë informacion lidhur me vendndodhjen e këtyre personave dhe të dashurve të tyre.

Gjatë këtyre viteve kemi dëgjuar nga organizatat apo shoqatat për të pagjeturit që kanë kërkuar nga institucionet të punojnë në zbardhjen e fatit të tyre, por deri më tani pak është bërë, sepse ka munguar një bashkëpunim dhe një angazhim më i madh edhe nga shteti për të zbardhur fatin e të pagjeturve.

Prandaj, duke ditur për obligimet që kemi ndaj qytetarëve, duke qenë të vetëdijshëm që pak jemi angazhuar në zbardhjen e fatit të të pagjeturve, ne duhet të angazhohemi e të bëjmë gjithçka që është e mundur që kjo çështje të trajtohet me prioritet të lartë nga institucionet e vendit.

Gjithashtu mendojmë se duhet t'i bëjmë ftesë shtetit serb dhe faktorit ndërkombëtar që temën e personave të pagjetur ta vendosin në mesin e prioriteteve të bashkëpunimit në mes të dy shteteve, për të vetmin qëllim ndërtimin e një së ardhme më të mirë dhe të një fqinjësie mes dy shteteve si dhe normalizim të marrëdhënieve fqinjësore. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Tani jemi në radhën e deputetëve sipas radhës së paraqitjes, në fakt, sipas radhës së paraqitjes do të mundohem, bile secilit nga ju që ka familjarë do t'ia jepja në fillim, ose vendbanimet nga vijnë, nga qyteti, apo lagje ose fshatra, ku ka pasur masakra.

Milaim Zeka e ka nënën e zhdukur, lajmërohuni me dorë nga këta që janë lajmëruar, jua jap më përpara fjalën. Faleminderit!

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryetar!

Së pari fjalimin tim po e filloj me deputeten, kolegën Jasmina.

Jo rrallë këtu dhe jashtë flasin njerëzit, të cilët as nuk kanë përjetuar më të voglën plagë nga regjimi i Serbisë, as nuk kanë njerëz të zhdukur, as nuk kanë njerëz të vrarë dhe ata shesin patriotizëm.

Unë i takoj brezit që jam burgosur dhe tërë jetën time jam munduar të jem kundër regjimit të ish-Jugosllavisë, kam qenë i burgosur, kam qenë i torturuar dhe mbi bazën e kësaj e di se çfarë torturash ka përjetuar një i burgosur qoftë shqiptar, qoftë rom, qoftë serb.

Dhe gjatë luftës kur ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës i kanë zënë robër ushtarët serbë, po e them me emër dhe mbiemër gjatë marrjes në intervistë të një ushtari serb, i cili kishte qenë pjesëtari kryesor i masakrës të Lubeniqit, një komandant me emrin Nasim Haradinaj më provokoi dhe tha: “Futja një shuplakë”. Kurrë në jetë, thashë, nuk i bie njeriut të lidhur, kurrë në jetë s’e kisha torturuar dikë, kurrë në jetë s’e kisha vrarë një fëmijë dhe një nënë serbe, kurrë.

Dhe unë nga kjo foltore po të them, se ashtu qysh i bëj thirrje Vuçiqit dhe Qeverisë serbe, i bëj thirrje Qeverisë sime që t’i gjejë të gjithë të zhdukurit serbë, romë, boshnjakë, pa marrë parasysh kanë qenë civilë apo kanë qenë kriminelë, le t’i varrosin njerëzit familjarët e tyre. Kjo është e para.

E dyta, kam menduar që sot në këtë seancë do të flasim për mospunën e delegacionit tonë në Bruksel për çështjen e të pagjeturve, sepse unë mendoj se është bërë një punë shumë pak dhe pajtoj në mënyrë absolute me Albin Kurtin, i cili tha se kjo çështje është përdorur si fasada në mes të dy qeverive.

Nuk kemi ne çka të bisedojmë me palën serbe kur ata luajnë me kufomat tona, nuk kemi ne çka të bisedojmë seriozisht me Daçiqin e me Vuçiqin, kur ata bëjnë lobim për tërheqjen e pavarësisë së Kosovës. Por, e dashur Jasmina, një fjalë e urtë suedeze thotë që “dy shalqinj nuk mund t’i mbash në njërën dorë”, nuk mundeni ju kryet në Beograd, e pjesën e trupit në Prishtinë, e herë kryet në Prishtinë e pjesën tjetër në Beograd. Ju, kur shkoni në biseda me Vuçiqin atje, ju duhet ta hapni çështjen e të pagjeturve, sidomos ti personalisht që paske pasur tragjedi familjare.

Unë sot mund të të tregoj ty një rrëfim që në fshatin tim, në Obri, forcat serbe kanë marrë bebën dymuajsh dhe pasi e kanë prerë me kosë duhani familjen Delijaj, ia kanë mbushur cuclën me gjak të nënës së vet dhe ia kanë lënë te goja. Këto janë masakra, unë e kam intervistuar ushtarin serb, i cili për momentin jeton në Perëndim, që thotë se ne i kemi marrë kufomat e shqiptarëve dhe i kemi bërë asfalt, i kemi përzier me gurë të asfaltit dhe asnjë njeri nga delegacioni i Kosovë nuk është marrë me këtë temë në Bruksel.

Ju e dini fort mirë se një letër anonime e një fëmije nga Shtërpca, që më vonë ka dalë që ia ka shkruar krejt dikush tjetër, është bërë temë diskutimi nga Ivica Daçiqi në Këshillin e Sigurimit të

Organizatës së Kombeve të Bashkuara, ndërsa këta ‘baloshët’ tanë këtu që merren me të pazhdukurit, këta injorantët, këta tupanxhinjtë që nuk i kisha dërguar as në fermë të lopëve, se jo në Bruksel të bisedojnë me Serbinë, këta as nuk janë të interesuar të merren me raste konkrete dhe të ngrihen çështjet e tilla deri në Organizatën e Kombeve të Bashkuara.

Prandaj, unë pajtoj edhe me ty, kam dëgjuar intervistën edhe të kryetarit të Parlamentit mbrëmë në një emision televiziv, i cili tha që nuk do t’ua lëmë barrë konfliktin shqipto-serb ose Kosovë - Serbi fëmijëve tanë.

Ne kemi luftuar, ne jemi gjakosur, ne e dimë fort mirë se me çfarë sakrifice kemi ardhur deri te pavarësia.

Problemi i disa serbëve është ky se ju nuk po kuptoni që ndihmëtari më i madh i pavarësisë së Kosovës dhe shkatërrimit të kombit serb është pikërisht Milosheviqi.

Është bërë një debat një Evropën Perëndimore se a ekziston faji kolektiv dhe filozofët më të mëdhenj, gazetarët më të mëdhenj, analistët më të mëdhenj të Perëndimit kanë ardhur në përfundim se ka ekzistuar faji kolektiv serb, pasi që pjesa dërmuese e tyre e kanë përkrahur dhe i kanë shkuar mbrapa një njeriu të sëmurë psikikisht, siç ka qenë Slobodan Milosheviqi, i cili është arkitekt i shkatërrimit të kombit serb, i cili është armiku më i madh i kombit serb, sepse po të mos ishte Milosheviqi e të mundahej t’i shfaroste shqiptarët, ndoshta ne kurrë s’ishim pavarësuar.

Prandaj, mbi bazën e kësaj ju kisha lutur edhe juve Listën serbe këtu në Parlament të kthjelleni pak, të ktheheni kah Kibla, se Kibla juaj nuk është Beogradi, po është Prishtina, se këtu jemi, edhe nëse rrihemi, bashkë rrihemi, s’ ju mbron Vuçiqi në Prishtinë këtu, edhe ata të pagjeturit bashkë do t’i gjejmë.

Prandaj, t’i mbyllim plagët e luftës, ta rrëzojmë për dhe atë urrejtjen tonë 110-vjeçare.

E tha një nënë në film dokumentar, e mori shembull Skandinavinë. Ne e dimë që Norvegjia është ndarë me paqe nga Suedia, ne e dimë, është i njohur baseni i gjakut në Stokholm, që Suedia ka qenë nën sundimin e Danimarkës, po sot këta popuj nuk kanë as luftë, as hasmëri, as inat.

E vetmja recetë për mbijetesë të vendeve ballkanike është modeli skandinav, në qoftë se e duam modelin skandinav, duhet ta riprogramojmë trurin tonë. Nuk mund të flasim me trurin e Milosheviqit dhe të thuhet po ulemi po bisedojmë me palën kosovare. Po edhe delegacioni kosovar duhet të dijë kush na përfaqëson atje? Nuk duhet të na përfaqësojnë njerëz hipokritë.

Ju, e nderuar Sarandë dhe Andini, që i falënderoj nga foltorja për këtë sensibilizim të trurit tonë, që e keni bërë me këtë thirrje të kësaj seance, që të të tregoj ty çka ka përjetuar Saranda, se besoj që je e ndjeshme dhe je njeri, një muaj ditë nuk fle.

Këtu ka njerëz të cilët kanë përjetuar tmerre prej Albin Kurtit e zotit Kurteshi që kanë qenë nëpër burgjet, më falni, ka plot të burgosur politikë këtu, që i kanë përjetuar torturat e poshtërimet më të mëdha. E keni doktoreshën Flora Brovina, Flora, më fal, se jam nën emocione, janë njerëz që kanë përjetuar gjëra të rënda.

Po të tregoj ty se si më janë kidnapuar prindërit e mi në Sofali më datën 12 prill të vitit 1999 dhe se si e kanë futur në banjë dhe e kanë kallur nënën time dhe babai ka shpëtuar gjysmë i gjallë, po ashtu trishtohesh, ashtu siç unë mund të trishtohem nga historia e familjes tënde.

Prandaj, mbi bazën e kësaj i bëj thirrje Listës serbe që të ndikoni në Qeverinë e Beogradit të na i dorëzojnë njerëzit tanë, t'i varrosim, ata qysh unë do të mundohem si deputet i këtij Parlamenti t'i bëj thirrje Qeverisë sime, institucioneve të mia, prokurorisë dhe policisë që t'i gjejmë eshtrat e njëri-tjetrit, pa dënime, nuk ka rëndësi të dënohet kush ma ka vrarë nënën time. Vrasja më e madhe për Serbinë dhe Qeverinë e Serbisë është që ne ia kemi marrë 'Jerusalem', që kanë thënë "Kosova je srca Srbije". Ia kemi marrë zemrën, ia kemi marrë 'Jerusalem', jemi bërë të pavarur, në qoftë se dimë të krijojmë shtet. Po, nejse, kanë thënë ashtu, Ganimete, kanë thënë, nuk ka rëndësi çka themi, a po më kupton, ka rëndësi çka bëhet.

Ka rëndësi që Kosova është shtet i pavarur dhe mbi bazën e kësaj ju do të jetoni në Kosovë, bashkë me neve dhe dashtë Zoti që kurrë lufta të mos përsëritet dhe dashtë Zoti që kurrë më njerëz të mos vriten në këto hapësira gjeografike. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ndërkohë zonja Zhivković e ka kërkuar fjalën, i është përmendur emri. Urdhëro, fjala për ju, zonja Zhivković.

JASMINA ŽIVKOVIĆ: Baš ono što sam na samom početkom rekla jeste, da i moj govor izazvao više neki političke reakcije i opet nerazumevanje i opet odvajanje žrtava, što nije u redu. I opet svođenje na neku politiku političke stvari koje opet odvajaju porodice članove kidnapovani i nestalih i udaljavaju od rešavanja.

Sve to što ste rekli naravno da se zgražavam i naravno da sam čitala o koleginci Sarandi i naravno da to nije u redu i naravno da se zgražavam kao što sam i u na početku rekla, ja neću spominjati ni slučaj mog oca i slučaj mog strica jer znam da bi to nadam se zapravo da bi to izazvalo istu reakciju, isto gađanje, isto razumevanje i za sve te slučajeve. Jer su civili stradali, govorim o civilima koji su kidnapovani izvlačili iz svoj kuće isto što ste i vi spomenuli.

Kažete mi da ja idem u Beograd i pitam Vučića, možete li vi meni pomoći onda da ja nađem odgovor ovde, i ko me može pomoći da ja nađem odgovor ovde jer kao što sam i ponavljam se i Kosovo krije tajnu kidnapovani Srba koji se još vode kao nestalih. Hvala!

KRYETARI: Blerta Deliu Kodra, e ka fjalën, të bëhet gati Daut Haradinaj.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuara familje të personave të pagjetur,

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Ndonëse që prej fillimit u thanë shumë gjëra nga parashtruesit e këtij debati, nga zonja Saranda dhe Andini, do të mundohem që në cilësinë e një vajze të fshatit Rezallë të përçoj diçka nga ajo që ka ndodhur në masakrën e Rezallës, gjithsesi të mos duket kjo që është personalizim i çështjes, sepse krimi që ka ndodhur besoj shumë që ka prekur secilën familje e secilën qytetar të Republikës së Kosovës.

Në fillim të këtij muaji bashkë me familjarë të fshatit Rezallë ishim pjesë e 19-vjetorit të masakrës së Rezallës, në të cilën nga ushtria dhe nga policia serbe janë ekzekutuar 98 shqiptarë, 44 prej të cilëve aso kohe janë munduar të zhduken. Për këtë masakër dhe të tjerat e viteve '98 dhe '99 ende nuk kanë dalë para drejtësisë ata që kanë urdhëruar dhe kanë ekzekutuar aso kohe.

Në vend që të ketë diçka konkrete në zbardhje të fatit të të pagjeturve si dhe dënimin e kryerësve të krimeve, autoritet e Beogradit kanë vazhduar talljen me këtë proces, sa të rënda aq edhe të dhimbshëm, duke vazhduar që t'i dekorojnë kryesit e këtyre krimeve makabre.

Fondi për të Drejtën Humanitare dhe aktivistja për të Drejtat e Njeriut, zonja Natasha Kandiq, pati deklaruar se ekzistojnë prova të mjaftueshme që gjenerali serb Diković ka qenë i përfshirë në krimet e luftës, madje ka udhëhequr brigadën që ka operuar kryesisht në fshatrat Burojë, Vojnik, Turjanë, Izbicë, e që kjo brigadë ka qenë përgjegjëse për 147 persona të varrosur në Izbicë dhe jo vetëm në Izbicë.

Masakra e Reçakut, masakra e Krushës së Madhe, e Rahovecit, masakra e Rugovës së Hasit, në të cilat janë vrarë shumë shqiptarë, janë dëshmi e krimit dhe gjenocidit serbë, krim për të cilën shteti serb dhe autoritetet serbe po heshtin tash e 19 vjet.

Të nderuar kolegë deputetë,

Dua vetëm të bëj të qartë që për masakrën e Rezallës tashmë avokati Arianit Koci e ka dorëzuar kallëzimin penal në emër të familjarëve të viktimave me komplet dëshmitë e dokumentuara dhe ne po presim që të fillojnë procedurat penale.

Lëndën për këtë masakër e ka marrë një prokuror ndërkombëtar dhe po ashtu familjarët janë në pritje që pas kaq vjetësh të kemi diçka konkrete dhe kryerësit e këtyre veprave të vihen para drejtësisë.

Po ashtu në përvjetorin që është mbajtur në Rezallë, ministri Tahiri e ka shpalosur që tashmë është në themel e sipër një departament i veçantë për drejtësi tranzicionale. Besoj shumë që ministri sot këtu do të flasë çka do të përmbajë ai departament, besoj shumë që do të arrijë ky departament të unifikojë të dhënat për krimet e luftës që kanë ndodhur në Kosovë, në mënyrë që ndjekja penale e secilit person të kryhet nga ky mekanizëm.

Po ashtu kemi dëgjuar disa herë edhe deklaratat e zyrtarëve të Bashkimit Evropian, të cilët kanë kërkuar vazhdimisht bashkëpunim më të madh ndërmjet dy qeverive, ndërmjet Qeverisë së Prishtinës dhe asaj të Beogradit, për të bërë përpjekje serioze nga dyja palët për të siguruar informacione të reja për fatin e të pagjeturve.

Unë dua të them që Qeveria e Beogradit vazhdimisht ka heshtur, përkundër faktit që presioni që tentuar të rritet. Ne nuk kemi pasur asnjë argument të vetëm që ata po punojnë në këtë drejtim për të siguruar paqe të qëndrueshme për dy vendet.

Ndonëse janë bërë përpjekje nga institucionet e Kosovës, këto institucione ku përfshihen edhe familjarët e të pagjeturve, edhe faktori ndërkombëtar, fatkeqësisht ende nuk kemi pasur një përgjigje të saktë për trupat e pagjetur, të cilët ndodhen në Serbi.

Është Serbia ajo që ka bërë gjenocid në Kosovë dhe ka bërë po ashtu zhdukjen e personave dhe kjo është thënë disa herë, do të thotë ekzistojnë dëshmi për këtë.

Edhe një herë apeloj që Bashkimi Evropian të vazhdojë tryshinë ndaj Beogradit dhe jo vetëm Bashkimi Evropian, po edhe faktori ndërkombëtar për kthimin e trupave të pagjetur në Republikën e Kosovës dhe po ashtu tema e të pagjeturve të jetë njëra ndër pikat kryesore të diskutimeve të rëndësishme, të cilat do të jenë në Bruksel.

KRYETARI: Atëherë do të shkoj në bazë të radhës, po shoh nuk ka të paraqitur drejtpërdrejt.

Korab Sejdiu, nga Lidhja Demokratike e Kosovës e ka fjalën.

KORAB SEJDIU: Të nderuar,

Të dashur familjarë të personave të pagjetur,

Është pak vështirë të flitet pas fjalëve të cilat u thanë edhe nga familjarët që janë të pranishëm këtu, po edhe ato që i pamë në këtë incizimin që u tregua më herët.

Është një çështje shumë e ndjeshme, një çështje që i tejkalon politika ditore, pra po flasim për humanizëm.

Shumë prej nesh sot vazhdojmë prej kësaj seance e u kthehemi familjarëve tanë, përderisa diku 1952 familje nuk mund ta përjetojnë këtë ndjenjë, për arsye se familjarët e tyre mbesin të zhdukur, prej të cilëve diku rreth 100 janë fëmijë.

Mbi të gjitha, edhe vetë prokurori serb për krime lufte ka deklaruar se një pjesë e këtyre qytetarëve tanë, diku 82 prej tyre janë bartur të gjallë në Serbi dhe e kanë gjetur vdekjen, zhdukjen, pikërisht atje.

Mbesin edhe 300 mbetje mortore në Institutin e Mjekësisë Ligjore, mbetet e hapur edhe çështja e të varrosurve dhe të identifikuarve gabimisht, e kështu me radhë.

Pra, e tërë kjo tregon se në shoqërinë tonë ekziston një varrë e hapur, një plagë për familjet e këtyre personave, këtyre vëllezërve dhe motrave tanë.

Unë isha para pak kohe në Podujevë, ku dëgjova tmerret që disa qytetarë të kësaj ane kishin përjetuar dhe përjetime të ngjashme kemi dëgjuar edhe nga pjesët e tjera të Kosovës, nga Gjakova, Skenderaj, disa prej atyre ngjarjeve u përmendën edhe këtu.

Por, pothuajse të gjithë ishin unikë në atë që e thanë se tmerret që i kanë përjetuar gjatë luftës nuk janë asgjë në krahasim me ndjenjën që kanë nga fakti që të dashurit e tyre ende nuk dihet se ku janë.

Dhe ne vazhdimisht po flasim për normalizim të raporteve me Serbinë, por nuk ka, le të dihet qartë, se nuk ka normalizim derisa kjo çështje mbetet e pazgjidhur.

Në fakt, është për keqardhje që dialogu me Serbinë deri më tani nuk është kushtëzuar me zgjidhjen e çështjes së qytetarëve tanë të pagjetur.

Por sa flasim për të kaluarën, është mirë të thuhet dhe të flitet për të ardhmen dhe të bëhet një herë e përgjithmonë e qartë se dialogu me Serbinë nuk guxon të vazhdojë përderisa kjo çështje nuk diskutohet dhe nuk zgjidhet e para në radhën e çështjeve që mbesin të pazgjidhura.

Qytetarët e Republikës së Kosovës, pavarësisht përkatësisë, janë viktimë e një lufte agresore që është bërë nga një regjim i Serbisë dhe vërtet e tërë shoqëria jonë ka nevojë për shërim të kësaj plage dhe kjo nuk mund të ndodhë assesi përderisa vëllezërit dhe motrat tona mbesin të zhdukur dhe njëkohësisht përderisa nuk ka drejtësi, e cila i adreson dhe me të cilën ballafaqohen ata që janë shkaktarë të drejtpërdrejtë të këtij krimi.

Ne si institucione kemi përgjegjësi institucionale, por mbi të gjitha kemi një përgjegjësi edhe më të lartë, atë morale. Mjaft kemi folur, mjaft kemi mbajtur seanca, mjaft kemi mbajtur edhe mbledhje komemorative. Ka ardhur koha që të gjithë ne të kalojmë nga fjalët në veprime konkrete dhe një herë e përgjithmonë familjarëve të këtyre qytetarëve tanë që mbesin të humbur dhe fati i tyre nuk dihet, t'u tregojmë se kanë edhe shtet, por kanë edhe njerëz, të cilët mendojnë për ta. Faleminderit!

KRYETARI: Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, e ka fjalën.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: I nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë ministra,

Nga të gjitha temat që mund të jenë subjekt i diskutimit në Kuvend, çështja e personave të zhdukur gjatë luftës, për të cilët ende drejtësia nuk është vënë në vend, pa dyshim se është një nga temat që na shkakton dhembje e, në anën tjetër, më shumë se çdo gjë vërtet na bën të reflektojmë mbi përgjegjësitë tona si institucione ndaj këtyre personave dhe ndaj familjarëve të tyre.

Edhe pas dy dekadash nga përfundimi i luftës, familjarët dhe shoqëria jonë në tërësi vazhdojnë të vuajnë mungesën e mbi 1652 personave, për të cilët ende nuk ka të dhëna se ku gjenden, apo çfarë fati mund të kenë pasur.

Të nderuar deputetë,

Republika jonë sot është shtet i pavarur, i pranuar nga më shumë se 115 vende të botës, po ashtu institucionet tona janë në një proces të pandalshëm të fuqizimit, të konsolidimit të shtetit tonë si një Republikë sovraane, unike, e pandashme, si dhe drejtë realizimit të agjendës së saj euro-atlantike. Sidoqoftë, qytetarët tanë edhe pas këtyre arritjeve, duhet të dinë për fatin e familjarëve të tyre të zhdukur në luftën e fundit. Ata nëpërmjet këtij procesi duhet të sigurojnë drejtësinë e munguar deri më tani, natyrisht kjo nuk do të thotë hakmarrje, sepse vetëm në këtë mënyrë mund të ndërtohet një paqe e qëndrueshme dhe afatgjatë. Kjo nuk nënkupton harresën e asaj që ka ndodhur, por për të angazhuar një proces që nëpërmjet vendosjes së drejtësisë për të mos lejuar përsëritjen, kurrë më, të atyre që kanë ndodhur pothuajse 20 vjet më parë.

Ka një adresë konkrete ku duhet të kërkohen të dhënat për fatin e këtyre personave dhe kjo adresë pa dyshim që është Republika e Serbisë, janë organet e saja, të ushtrisë dhe drejtësisë, të cilat në mënyrë direkte kanë qenë pjesë e kryerjes të këtyre veprave. Pra, kanë pasur dhe kanë njohuri dhe të dhëna për personat që neve na mungojnë. Prandaj, në konsultim me Komisionin shtetëror dhe me familjarët e të të pagjeturve jemi duke përgatitur një seri notash verbale ndaj vendeve më të fuqishme evropiane dhe më gjerë për të kërkuar që kjo të jetë temë e diskutimit në çdo takim formal, e joformal, ku është e pranishme Republika e Serbisë, që të bëhet presion i

vazhdueshëm deri në gjetjen e këtyre personave. Në anën tjetër, kam ndjekur me vëmendje dhe punën që është duke u bërë në Institutin e Mjekësisë Ligjore për çështjen e të pagjeturve dhe jam i përkushtuar që kapacitetet tona të mjekësisë ligjore të forcohen, në mënyrë që të bëjmë punën tonë në identifikim sa më parë të rasteve për të cilat tashmë ka gjurmë.

Është e udhës të theksohet se Instituti i Mjekësisë Ligjore është agjencia e vetme në Kosovë e autorizuar të bëjë kërkimin, gjetjen dhe zhvarrimin, si dhe përcaktimin e fatit, identifikimin dhe dorëzimin e mbetjeve mortore të personave të pagjetur që ndërlidhen me luftën e Kosovës. Aktualisht, Ministria e Drejtësisë, përmes Institutit të Mjekësisë Ligjore, është duke zhvilluar gërmime në komunën e Gjakovës, ku janë gjetur mbetje mortore. Gërmimet janë ende duke vazhduar, në ndërkohë janë bërë planifikime për gërmime edhe në 20 lokacione të ndryshme brenda Kosovës. Përkundër një pune voluminoze dhe tejet profesionale të bërë deri më tani, planifikoj që Institutin e Mjekësisë Ligjore ta ngre në nivelin e agjencisë. Kjo do të bëhet me qëllim që të rritet efikasiteti në trajtimin e këtyre rasteve dhe të intensifikohen aktivitetet dhe më tutje në zbardhjen e fatit të të gjithë të pagjeturve.

Të nderuar deputetë,

Ne duam paqe dhe fqinjësi të mirë me të gjitha vendet e rajonit, por dihet se pa u zgjidhur çështja e të zhdukurve të luftës, nuk mund të jemi të qetë dhe nuk duhet të rrimë indiferentë. Është e patolerueshme që sot e 19 vjet pas përfundimit të luftës kjo barrë e rëndë të mos marrë fund akoma.

Të nderuar të pranishëm,

Pa dashur t'i shmangem për asnjë moment përgjegjësisë time që kam si ministër i Drejtësisë, besoj që jeni të vetëdijshëm për rolin e misioneve ndërkombëtare, sidomos në çështjen e Institutit të Mjekësisë Ligjore, së pari UNMIK-ut, pastaj EULEX-it dhe tani kur më 14 qershor të këtij viti përfundon mandati i EULEX-it, të gjitha kompetencat do të jenë në duart tona, konkretisht të Ministrisë së Drejtësisë. Edhe sa i përket çështjes së themelimit të Departamentit për drejtësi tranzicionale, kjo do të jetë për qëllim unifikimin e politikave tona sa i përket çështjes së të pagjeturve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Adem Mikullovc, nga Lëvizja Vetëvendosje, e ka fjalën.

ADEM MIKULLOVCI: Faleminderit, zoti kryetar!

Dy a tre ministra, faleminderit që jeni të pranishëm,

Deputetë të nderuar,

Unë vetëm dua shkurt të shpreh pakënaqësinë time dhe keqardhjen që sipas mendimit tim, as Kombet e Bashkuara, as Brukseli, as Gjykata e Hagës, as këto OJQ-të e shumta që gjenden nëpër Evropë, pak sikur nuk po u kushtojnë kujdesin e mjaftueshëm viktimave dhe të pagjeturve.

Kisha pasur dëshirë që në rezolutën e përfundimit që do ta nxjerrë ky Kuvend, ta vëmë edhe këtë, nuk po punohet mjaft. Nuk është bash e vërtetë që ne nuk kemi bërë asgjë, kemi tentuar, jemi munduar të bëjmë më tepër, por të mos harrojmë se ky Kuvend, legjislacionet e mëparshme, ka nxjerrë rezoluta për këtë temë, Ismet Pllana ka botuar 5-6 libra, doktor Krasniqi për laparaskopi tash e botoi një libër voluminoz me shumë të dhëna, të gjitha i ka shpërndarë gjithandej Evropës, po tentojmë, por prapë po jetë kyçe që në bisedat me Serbinë të vihet pika. Aty do të tentojmë, aty do të kushtëzojmë. Ky është mendimi im që këtë ta fusim gjithsesi në rezolutë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Mexhide Mjaku-Topalli e ka fjalën.

MEXHIDE MJAKU-TOPALLI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ministra,

Të respektuara familje të të pagjeturve.

Fillimisht mund të them se këto fakte të dokumentuara që u shfaqën sot këtu ishin pamje të një realiteti të prekshëm, një realitet që ende vazhdon të shkaktojë dhimbje gjithandej. E tëra ishte një pasqyrim real i viteve të kaluara, një realitet që lutem të mos ndodhë kurrë më.

Të nderuar kolegë,

Sot, më 27 prill, shënohet si Dita e të Pagjeturve, datë kjo kur në vitin '99 në Mejë afër Gjakovës forcat serbe kanë rrëmbyer nga kolonat e refugjatëve dhe kanë masakruar e zhdukur 377 shqiptarë. Ajo ishte një nga kolonat e shumta të spastrimit etnik të rreth 1 milion shqiptarëve të dëbuar nga Kosova. Në vitet '98-'99 në Kosovë forcat serbe paramilitare vranë e masakruan rreth 13 mijë shqiptarë, e mijëra të tjerë i zhdukën duke i dërguar e groposur në Serbi apo edhe duke i djegur. Menjëherë pas luftës kanë rezultuar më se 5 mijë e 650 persona të zhdukur dhe se për familjarët ende mbetet njëra ndër temat kryesore.

Të nderuar kolegë,

Familjarët e personave të zhdukur gjatë luftës për më shumë se një dekadë e gjysmë po jetojnë me plagën e tyre shpirtërore për të pagjeturit. Gjatë takimeve që i kemi me ta, ata vazhdimisht akuzojnë faktorin vendor dhe atë ndërkombëtar se nuk është bërë sa duhet për ta mbyllur këtë plagë të hapur, duke ushtruar presion te Serbia për të treguar vendndodhjen e varrezave masive, ku u groposën trupat e shqiptarëve të vrarë e të masakruar nga forcat serbe. Ata këmbëngulën që së paku çështja e të pagjeturve të renditet si problem dialogu, po ashtu kërkojmë plotësim-ndryshimin e ligjit ekzistues.

Në lidhje me këtë çështje Kuvendi ka miratuar një rezolutë në maj të vitit 2012, me të cilën kërkohej që të kushtëzohet vazhdimi i çfarëdo dialogu me Serbinë pa u zbardhur fati i personave të rrëmbyer e ende të pagjetur. Po ashtu, në vitin 2015 është debatuar dhe janë votuar disa

rekomandime të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, të cilat u harmonizuan me rezolutën e vitit 2012. Mirëpo, edhe pse ka kaluar më shumë se një dekadë e gjysmë pas luftës, Kosova mban në evidencën e të pagjeturve gjatë luftës në Kosovë edhe rreth 1 mijë e 652 persona, fati i të cilëve mbahet i pandriçuar për shkak të fshehjes së informacioneve nga pala serbe për vendndodhjen e varrezave masive. Moszbardhja e fatit të të pagjeturve bën që Kosova të mbetet ende dosja e madhe e krimit të pandëshkuar, e fajtori dihet, ka adresë dhe ky ishte shteti i Serbisë, i cili jo vetëm që nuk kërkoi falje për atë që bëri në Kosovë, por nuk shprehu asnjë fije humaniteti për të treguar së paku vendndodhjen e varrezave masive. Mendoj që këtë që e them, nuk e them për hakmarrje, por sigurisht si një shembull që do të ndikonte dhe ndihmonte në mospërsëritjen e këtij krimi të rëndë kundër civilëve të pafajshëm dhe kategorisë që i mbron ligji për të drejtën humanitare dhe zakonet e luftës.

Autoritetet serbe, edhe kur kanë treguar për ndonjë varrezë masive, këtë e kanë shfrytëzuar maksimalisht për përfitime të shumta, duke filluar nga fondet për gjurmime e deri te favorët edhe në dialog me Kosovën dhe në dialog me Bashkimin Evropian. Ky proces i zvarritur për personat e pagjetur konsideroj se është shkelje e të drejtave të familjarëve, sepse po bëhet e padrejtë ndaj së vërtetës. Familjarët e gëzojnë të drejtën e tyre për të marrë informacione dhe të kërkojnë të afërmit e tyre. Unë them se kam analizuar rekomandimet e paraqitura në formë të rezolutës dhe po ashtu mund të them se disa prej tyre janë përsëritje të disa rekomandimeve të dala nga po ky Kuvend në formë të rezolutave. Ndërsa, për rekomandimet e tjera mendoj që duhet të ulen grupet parlamentare për harmonizim, edhe pse për shumicën pajtohem dhe i mbështes. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Frashër Krasniqi e ka fjalën, në emër të Grupit të Deputetëve të Pavarur.

FRASHËR KRASNIQI: Të nderuar qytetarë,
Familjarë të personave të pagjetur,
Të nderuar deputetë,

Edhe për mua është mjaft e vështirë të flas, sidomos pasi folën deputetët, të cilët kanë persona të zhdukur në familjet e tyre, mirëpo në anën tjetër, e konsideroj që është shumë e rëndësishme që secili prej nesh, e sidomos ne që nuk kemi persona të zhdukur në familjet tona të flasim, ngase të mos e vazhdojmë traditën institucionale në Kosovë, ku çështja e fatit të personave të pagjetur u është lënë pothuajse tërësisht familjarëve të tyre dhe me këtë çështje, pra, nuk janë marrë sa duhet institucionet.

Ne kemi vendosur të flasim një ditë të caktuar për personat e pagjetur, duke harruar me ose pa vetëdije që çdo ditë është ditë e personave të pagjetur për familjarët e tyre dhe duke harruar se çfarë ndjenje e rëndë duhet të jetë që çdo mëngjes ngrihesh me mendjet te vajza, djali, gruaja apo burri i zhdukur dhe të përballësh çdo natë me ankthin që vjen nga mosdija për fatin e tyre. Shpeshherë, madje, e kam përshtypjen që bash kur nuk duam të merremi seriozisht dhe çdo ditë

me një çështje, krejt çka bëjmë është që ia caktojmë një ditë të veçantë, disi si për ta hequr qafe. Është shumë mirë, pra, që Kuvendi po e shënon Ditën e të Pagjeturve, por duhet ta kemi parasysh që çdo ditë për familjet e të pagjeturve po bëhet një ditë më e rëndë dhe më e vetmuar pikërisht ngase indiferenca institucionale po bëhet përditë e më e madhe. Dikur së paku deputetë e Kuvendit dhe zyrtarë qeveritarë të hyrja e Kuvendit i kanë pasur disa foto të personave të pagjetur, sot nuk janë as ato, gjë që tregon në mënyrë simbolike se çdoherë e më pak institucionet tona merren me këtë çështje.

Moszbardhja e fatit të personave të pagjetur është pasojë e refuzimit të Serbisë që ta pranojë fajin dhe përgjegjësinë për krimet e luftës në Kosovë. Serbia, pra siç e dimë, asnjëherë nuk e mori përgjegjësinë në mënyrë institucionale dhe shtetërore për krimet e luftës dhe pikërisht ngaqë nuk do ta pranojë këtë përgjegjësi, refuzon dhe madje dhe saboton çdo ndërmarrje për zbardhjen e personave të pagjetur, e cila në mënyrë direkte do të inkriminonte shtetin e Serbisë për dhunën dhe vrasjet sistematike që i ka bë në Kosovë. Dhe, këtu kemi me dhjetëra, madje qindra raste të mos bashkëpunimit dhe madje edhe të sabotimit të Serbisë të këtyre ndërmarrjeve, e kemi rastin e Rashkës, i cili prej vitit 2010 deri në vitin 2014 është prolonguar qëllimisht nga ana e Serbisë. E kemi, ta zëmë, një shembull të deklaratës së kryeprokurores për krime lufte në Serbi, në maj të vitit 2017, e cila thekson se do të fokusohet dhe do të merret vetëm me krimet e luftës ndaj civilëve serbë, ani pse përgjegjësia e shtetit të Serbisë është shumë e madhe dhe shumë sistematike në raport me krimet e luftës në Kosovë.

Në anën tjetër, po ashtu e kemi mosgatishmërinë e Serbisë që të përballet dhe që t'i nxjerrë para drejtësisë kriminelët që janë përgjegjës për krimet që ndodhën në Kosovë. Rreth 1 mijë e 650 persona janë të pagjetur, nga ata, siç u tha dhe më herët, rreth 500 janë qytetarë nga komunitetet pakicë në Kosovë, pra serbë, romë, ashkalinj, e tjerë dhe ata po ashtu janë familjarë dhe qytetarë të Republikës së Kosovës, për të cilët Republika jonë duhet të gjejë kurajën që të angazhohet seriozisht dhe sinqerisht për zbardhjen e fatit të tyre. Kur fola më herët për çështjen e mosinteresimit të institucioneve të Republikës së Kosovës që të bëjë trysni më të madhe për zbardhjen e fatit të personave të pagjetur, ndërkohë e pashë një lajm, një deklaratë të Presidentit Hashim Thaçi, i cili sot, pra në vitin 2018 paska deklaruar që çështja e të pagjeturve duhet të diskutohet në negociata në Bruksel. Më shumë se një dekadë po bëhet që ne bëjmë negociata në Bruksel, pjesa më e madhe e këtyre negociatave është drejtuar pikërisht nga Hashim Thaçi, asnjëherë çështja e të pagjeturve nuk është konsideruar e denjë që të futet në negociata me Serbinë, asnjëherë për çështjen e të pagjeturve nuk u kushtëzua Serbia. Të gjitha ato kompromise iu pranuan Serbisë gjatë këtij procesi negociator dhe asnjëherë nuk iu vë kusht që të zbardhet fati i personave të pagjetur. Ne e dimë që zgjidhja për zbardhjen e këtij fatit të këtyre personave do të vinte vetëm nëse Serbia do të detyrohej me presion ndërkombëtar dhe me kushtëzim nga Kosova që të jepte informacione mbi krimet sistematike që i ka kryer ndaj shqiptarëve.

Hera e parë që është përmend çështja e të pagjeturve në negociatat e Brukselit tregon se me çfarë mungese të seriozitetit e kanë trajtuar këtë çështje institucionet tona, e kam fjalën për vitin 2016, kur Edita Tahiri kishte deklaruar vetë se ne e kemi hapur në Bruksel çështjen e të pagjeturve, mirëpo diplomatët ndërkombëtarë na thanë që për këtë çështje duhet të keni një regjistër, duhet të keni një bazë të të dhënave mbi personat e pagjetur që janë zhdukur gjatë luftës së fundit në Kosovë.

Pra, Edita Tahiri, e cila e përfaqësonte Republikën e Kosovës në këto negociata, nuk e ka ditur, nuk ka qenë e vetëdijshme që një bazë e tillë e të dhënave, që një përmbledhje e tillë e dokumentacionit ekziston dhe është bërë në Kosovë shumë vjet para se të ndodhte kjo deklaratë. Pra, kjo tregon se me çfarë tallje dhe me çfarë papërgjegjësie është diskutuar dhe është marrë Republika e Kosovës me çështjen e të pagjeturve. Prandaj, dua ta shfrytëzoj rastin që të bëj thirrje edhe për institucionet e Kosovës, sidomos për Qeverinë e Republikës së Kosovës çështja e të pagjeturve të mos jetë një çështje, e cila diskutohet dhe për të cilën ka ndjeshmëri vetëm gjatë javës së të pagjeturve, vetëm në Ditën e të Pagjeturve, por për këtë çështje të kushtëzohet Serbia, të bëhet pjesë e kushtëzimit edhe për vazhdimin e negociatave dhe për këtë çështje të bëhen hapa seriozë dhe të sinqertë që të zbulohet fati i personave të pagjetur. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Muharrem Nitaj e ka fjalën.

MUHARREM NITAJ: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra,

E dhimbshme tema e të zhdukurve, është folur gjatë dhe shumë për këtë temë, fatkeqësisht gjatë dhe shumë po flitet edhe sot. Edhe sot po flasim dhe secili e ka përvojën e vet me të zhdukurit, me një temë shumë sensitive, sigurisht kolegët deputetë e kanë më të madhe dhe më të fortë, edhe Andini, edhe zonja Bogujevci, edhe Zhivkoviq, edhe Zeka, e tjerë, e tjerë. Realisht, ajo që unë nuk mund ta kuptoj ose e kam problem ta kuptoj është a duhet që kjo temë të përsëritet, të bëhet njëfarë lloj rituali i përvitshëm, duke përfshirë edhe Kuvendin e Kosovës që ne të miratojmë dokumente të ndryshme, rezoluta të ndryshme dhe, fatkeqësisht, pa shumë rezultat. Tani Kosova dhe Serbia janë në fazën finale të përmbjlljes së një etape të normalizimit të marrëdhënieve të tyre, me gjasë me njohjen e ndërsjellë. E dëgjiova zotin Kurti nga fjalimi i tij, e mbajta në mend atë fjalinë që tha ndoshta ose të paktën kjo çështje, kjo tematikë duhet edhe një herë të rikthehet nëse mund të themi në tavolinat ndërkombëtare ose të bëhet çështje ndërkombëtare.

Unë e kam një pyetje konkrete për liderin e Partisë Demokratike të Kosovës, po të ishte edhe kryeministri i vendit këtu, zoti Haradinaj, do ta bëja të njëjtën pyetje për të dytë: a ka mundësi që çështja e të pagjeturve të rikthehet edhe një herë në tavolinën e bisedimeve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në këtë fazë finale? A ka mundësi, për shembull, të prodhohet një tjetër rezultat apo

do të duhet që ne të presim edhe disa vjet edhe ta përcjellim këtë temë se si do të vijë duke u zbehur dhe që nuk do ta marrë kurrë dhe asnjëherë epilogun përfundimtar.

Fare në fund, e kam edhe një lloj si replikë me zonjën Zhivković, është e vërtetë që viktimat nuk kanë kombësi dhe janë të njëjtë. Por, fatkeqësisht, numri i viktimave ndër shqiptarë dhe ndër serbë ka një dallim, ka një ndryshim shumë të madh dhe kjo nuk ka shanse të mos thuhet. Kosova në gjithë këtë histori, zoti kryetar i Kuvendit, në vend që ta kishte të zbardhur fatin e po thuhet edhe të 1 mijë e 652 persona janë të pagjetur akoma, e ka fituar Gjykatën Speciale, edhe një Gjykatë Speciale njëetnike. Zoti kryetar, a mund të bëhet në këtë temë diçka? Apo veç edhe një debat më tepër, vetëm edhe disa fjalë më shumë dhe asgjë tjetër. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Nitaj!

Në cilësinë e kryetarit, duke pasur parasysh si pyetjet ishin të drejtpërdrejta dhe për mua si kryetar i Kuvendit, çështja e të pagjeturve përveç dimensionit human, e ka edhe dimensionin kryesor të kësaj pjese të dialogut në të cilën jemi se nuk mund të ketë pajtueshmëri në mes të palëve deri në momentin kur edhe kjo çështje nuk zgjidhet, për arsye se ka shqetësime reale dhe në të njëjtën kohë pajtueshmëria ndërmjet dy popujve nuk mund të arrihet pa ditur për fatin e secilit se ku gjendet. Për korrektësi, kjo çështje është biseduar shumë herë, edhe pse nuk kam qenë unë asnjëherë pjesë e dialogut drejtpërdrejt, po jua konfirmoj, është fat jo i mirë që nuk janë ata që kanë marrë pjesë, por unë kam kërkuar zyrtarisht që ta di, dhe është hapur shpeshherë nga delegacioni i Kosovës, po e them. Dhe, është ripërsëritur për aq sa shpeshherë në të njëjtën formë, sikur po flasim edhe sot.

Pala e delegacionit të Serbisë e ka hapur çështjen e të pagjeturve, të cilët lidhen në shumicën e rasteve, shumica absolute e rasteve janë pas luftës. Do të thotë, të pagjeturit në rastin e familjarëve që janë nga Serbia, janë në shumicën absolute, në 99,9% pothuajse janë të pasluftës, përderisa në situatën e pasluftës një anarki dhe në momente të tilla Republika e Kosovës s'ka qenë Republikë, nuk ka pasur institucione, ju e dini si e kemi trashëguar dhe e kemi pasur një situatë tepër të rëndë, ku tentohet tash t'i bëhet barrë e përgjegjësi shtetit të Kosovës për rastin e krimeve që janë kryer nga Serbia në Kosovë, të cilat shumica absolute gjatë konfliktit janë kryer nga formacionet zyrtare shtetërore serbe, ushtria, policia.

Vetë fakti i dokumentarit tregon se si është bërë masakër mbi masakër dhe shumica e trupave të familjarëve tanë janë gjetur edhe në vende zyrtare, institucionale, e Serbia duhet të marrë, kjo është një shtysë më shumë, që duhet ta marrë përgjegjësinë edhe për padinë për gjenocid. Ka qenë një krim i vetëdijshëm, i cili është bërë katërçipërisht me një paramendim për zhdukjen e shqiptarëve nga trojet e tyre.

Sido që të jetë, qeveritë do të ndërrohen në Republikën e Kosovës, të jeni të sigurt. Sot kur po ju drejtohem jemi në ndjenjat e familjarëve, të cilët na dëgjojnë dhe do të na mbeten disa nga

problemet, plagët nuk do të na shërohen, të cilat na i ka shkaktuar Serbia. Për aq sa për Listën serbe, edhe pse s'qenka tani askush, ne do të punojmë që deri në fund ta marrim përgjegjësinë që asnjë plagë e një familjari të qytetarëve të Republikës së Kosovës të mos mbetet pa shkuar deri në fund në zgjidhje. Këtë pjesë ne do ta bartim prapë, edhe rezoluta besoj, të cilën do ta kemi tani, do të jetë edhe më obligative edhe për institucione që të shkojmë edhe më konkretisht, vendimmarrja është e Kuvendit, në fund të fundit është vendimtare edhe për Qeverinë e Kosovës, për ne të gjithë, edhe për presidentin, në mënyrë që të hapen ndoshta, nuk jemi për të bërë kushtëzime, por sido që të jetë hapet në mënyrë edhe më transparente.

Por, është biseduar, jo një herë, është biseduar dhjetëra herë dhe ka pasur momente tepër tensionuese ndërmjet delegacioneve pikërisht për këtë çështje.

Fjalën e ka pa grup parlamentar, është i vetmi, pastaj janë LDK-ja, PDK-ja dhe VV-ja, të gjithë deputetët, Veton Berisha. Nuk qenka këtu. Rikthehemi prapë, Naser Rugova. Pastaj, për pauzë do të ishte mirë të më tregojnë grupet parlamentare nëse synojnë, për arsye se janë edhe 13 deputetë, pastaj plus rezolutën, e cila duhet të harmonizohet.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

27 Prilli që pothuajse 19 vite si një datë e ndarjes së dhembjes me familjarët e personave të pagjetur dhe një solidaritet, në radhë të parë i njerëzores dhe pastaj i institucionales, por gjithsesi pa i ikur kurrë përgjegjësisë institucionale që e kemi, sidomos këto dhjetë vjetët e fundit si shtet i pavarur.

Unë ndaj dhembjen edhe të një përvoje që e kam pasur më 2005-2006 si anëtar i Komisionit Qeveritar për Persona të Pagjetur dhe kur vërtet bisedat që zhvilloheshin atëherë, si Institucione të Pavarura Vetëqeverisëse të Kosovës me mbështetjen e Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq, me Komisionin e Qeverisë së Republikës së Serbisë në atë kohë, së pari dua të ndaj solidarizimin njerëzor me kolegët deputetë këtu, që i kanë humbur më të dashurit e tyre dhe le të jetë kjo ditë që na unifikon, që na bashkon dhe na jep motiv që për këtë pjesë të shoqërisë, mbase më e dhimbshmja e pothuajse 19 vjetëve në liri, tentojmë t'u japim një përgjigje apo një alternativë institucionale, sepse tani jemi shtet.

Kam pasur rastin t'i vizitoj të gjitha shoqatat që kanë bërë një punë të jashtëzakonshme të familjarëve të personave të pagjetur dhe jo rrallë kemi mbetur pa tekst, edhe nga emocionet, edhe nga dhembja, por mbase nganjëherë edhe nga pafuqia institucionale që këtyre njerëzve t'u japim përgjigje institucionale. Meja, Krusha, Rezalla, Izbica, Pokleku, Çyshku, Dubrava, Lubeniqi, Mitrovica, Suhareka, Rogova, Rahoveci, konsideroj se janë ndërgjegje e vrarë e qytetërimit të vjetër të Evropës. Forma e holokaustit ka ndodhur jo më larg se 18 vjet në këtë vend. Jemi në zemër të Evropës.

Prandaj, bëj apel si deputet i zgjedhur dhe si njeri që jam marrë me këtë çështje, zoti kryetar, që nga ju si kryetar i Kuvendit, Qeveria, të gjitha partitë politike që janë pjesë e këtij Kuvendi, që në platformën e ardhshme, pothuajse në finale të bisedimeve me Serbinë, nuk guxojmë që kjo pjesë kaq e rëndësishme, kaq e ndjeshme edhe për raportet e ardhshme ndërmjet dy popujve dhe ndërmjet dy shteteve fqinje të mos jetë pjesë e rëndësishme e kësaj platforme. Në draftin që është votuar në Qeveri nuk e kam parë.

Ju lus edhe një herë, nuk dua të adresoj kritika, as ta politizoj këtë çështje, por vërtet është momenti i fundit që si institucione, si të zgjedhur të popullit, të bëhemi bashkë, ta adresojmë dhe të jetë pikë kyçe e finales së dialogut me Serbinë. Në këtë kuptim, unë nuk po i shoh sot këtu përfaqësuesit e familjarëve të personave të pagjetur. Janë lodhur edhe ata me ne. Edhe ne nganjëherë i kemi lodhur me refrene boshe dhe pa veprime konkrete institucionale. Prandaj, bëj apel edhe një herë që në platformën e ardhshme për këtë finale që parashihet të jetë me Republikën e Serbisë, ju lutem mos e neglizhoni dhe mos e anashkaloni një çështje që është goxha kruciale për pajtim ndërmjet dy vendeve dhe ndërmjet dy popujve.

Dhe, krejt në fund, të zhdukurit e etnive të tjera, pajtohem zoti kryetar, janë pjesa dërmuese pas 12 qershorit 1999, ndërsa personat e zhdukur apo të pagjetur të shqiptarëve të Kosovës, të popullit mazhorancë këtu, kanë adresë, kanë kohë, kanë datë dhe dihen formacionet. Ju lutem, Serbia ka pasur president në atë kohë, kryeministër, ministër të Drejtësisë, ministër të Mbrojtjes, ministër të Punëve të Brendshme, komandantë të ushtrisë, të korpuseve, të policisë, të nënstacioneve policore dhe të formacioneve tjera, ndërsa në dy vjetët e luftës '98-'99 ku kemi qenë dhe si kemi qenë ne? Kemi luftuar për mbijetesë. Dihet kush e ka pasur përgjegjësinë në qershor pas 12 qershorit të vitit 1999. Janë adresat.

Prandaj, duke u solidarizuar fuqishëm edhe një herë me familjarët e personave të pagjetur, nuk dua të theksoj, as të përmend numër, të bëhemi bashkë edhe një herë me një logjikë institucionale, sepse shteti fqinj verior i Kosovës, Serbia, i ka të adresuar, e ka bazën e të dhënave, na e dëshmoi edhe dokumentari, por edhe dëshmitë tjera nga mekanizmat dhe institucionet ndërkombëtare. Ju bëj apel miqve tanë strategjikë, që po insistojnë që vërtet t'i vihet kapak një tragjedie në këto troje dhe një paqeje të qëndrueshme me Serbinë, që ta bëjnë presionin e nevojshëm që njëherë e përgjithmonë t'i jepet përgjigje kësaj çështjeje dhe drejtësia ta thotë fjalën e vet. Faleminderit!

KRYETARI: Sala Berisha-Shala e ka fjalën. Të bëhet gati Ismajl Kurteshi.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

E nderuar Saranda Bogujevci,

I nderuar Andin Ukshin Hoti,

Të nderuara dhe të respektuara familje të të pagjeturve,

Çfarëdo që të themi sot lidhur me këtë temë dhe këtë plagë të rëndë 19-vjeçare do të jetë shumë pak.

Sigurisht se edhe unë do të përsëritem nga kolegët e mi, që më parë e morën fjalën, por do ta filloj fjalimin tim me thënien, “Koha shëron plagë.” Ndërkohë që në këtë rast është e kundërta, sepse edhe 19 vjet pas luftës mbi 1 500 familje kosovare presin me ankth që të dinë për fatinë e më të dashurve të tyre. Në vitin ’99, në qershor ka përfunduar lufta në Kosovë, plagët ende kanë mbetur të hapura. Të zhdukurit e luftës së fundit në të vërtetë janë plaga më e madhe që kemi marrë dhe që mbetet akoma e hapur. Akoma të hapura mbeten shumë varre në Kosovë, që fillimi i pasluftës ishte një shpresë, se do t’u kthehen të gjallë familjarëve dhe Kosovës qytetarët e rrëmbyer nga forcat serbe.

Sot është dita për të përkujtuar edhe një herë se sa shumë kemi vuajtur dhe sa shumë po vuajmë nga ajo që kemi kaluar. Pra, e tërë kjo javë i dedikohet Javës së të Zhdukurve. Shteti i Serbisë e ka përgjegjësinë e plotë për gjithçka që u ka ndodhur atyre. Pa dashur të anoj me fajësi dhe pafajësi, kjo është një e vërtetë, sepse Serbia me arsenalin e saj të milicisë, me arsenalin e saj shtetëror represiv ka shkaktuar tri luftëra në Ballkan, e ka shkaktuar edhe luftën në Kosovë dhe ka lënë shumë plagë të hapura.

Ky vend, domethënë Kosova, ka qenë e pushtuar nga Serbia, nga Serbia është djegur, njerëzit e këtij vendi janë vrarë, njerëzit e këtij vendi janë rrëmbyer dhe zhdukur po nga Serbia, nga aparatura shtetërore e Serbisë, prandaj Serbia duhet të ballafaqohet në këtë situatë, duhet t’i gjejë të zhdukurit dhe t’i kthejë eshtrat e tyre. Sado pak, me këtë veprim do ta pastronte vetveten së paku.

Kur një shtet nuk ballafaqohet me ndërgjegjen e vet për të bërë pastrimin e së keqes, ai shtet do të vazhdojë të jetë pa ndërgjegje dhe kriminal. Të nesërmen, kush e di, mund ta ketë shumë më të errët sesa të djeshmen dhe të sotmen.

Është një tentativë që kërkohet ta harrojmë këtë histori, por harresa është një fenomen që nuk i shërben paqes, lirisë, pajtimit dhe afrimit, përkundrazi i shërben krimin, dhembjes dhe ndarjes. Prandaj, ne si institucione duhet vazhdimisht të kërkojmë nga Serbia dhe me çdo çmim që të zbardhet fati i të zhdukurve. Përveçse është një e drejtë që s’mund ta mohojë askush, sepse kur kjo e drejtë mohohet, siç është rasti shumë herë në vitet e fundit, e drejta jonë për revoltim është e shenjtë dhe e pacenueshme.

U përsërit nga shumë kolegë të mi, përveçse janë zhdukur, ne mund të flasim edhe me orë të tëra dhe ditë të tëra për masakrat që i ka shkaktuar Serbia. Po e përmend masakrën e Poklekut të Vjetër dhe të Poklekut të Ri. Në Poklek të Vjetër, gra, fëmijë e pleq janë masakruar e vrarë dhe

së fundmi janë djegur nga forcat serbe. Ndërkohë që në Poklekun e Ri janë marrë nga shtëpitë e tyre njerëzit, janë zhdukur dhe nuk dihet asgjë për fatin e tyre.

Është Java e të zhdukurve, pra po e përsëris, para kësaj jave dhe kësaj dite ka pasur të zhdukur dhe të kidnapuar edhe më herët, që kanë vazhduar të jenë edhe pas kësaj date e kësaj dite, po e përmend në këtë rast se Serbia nuk ka zgjedhur as moshë, as gjini, as status, ka rrëmbyer, zhdukur e masakruar fëmijë, gra, burra e pleq dhe shumë intelektualë. Kur them intelektualë, po e veçoj rastin, duke kërkuar ndjesë nga raste të shumta, rastin e profesor Ukshin Hotit, dr. Hafir Shalës dhe një aktivisti dhe ish-veprimtari të çështjes kombëtare, Xhavit Haziri, i cili kur u kidnapua nga forcat serbe ishte në detyrën e tij fisnike si aktivist i Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut.

Kemi dëgjuar rrëfime nga familjarët prej më të ndryshmeve. Patëm rast edhe sot përmes videos këtu në Kuvend, kam pasur rast shpesh të dëgjoj rrëfime nga familja e doktorit Hafir Shala, i cili u kidnapua më 10 prill të vitit '98 dhe për fatin e tij s'dihet asgjë. Familja ka kërkuar vazhdimisht dhe sistemi i drejtësisë pas luftës, i udhëhequr nga UNMIK-u, i ka thënë familjes se kjo është çështje politike, në të cilat janë të përziera organet politike të Serbisë, kështu që UNMIK-u nuk ka qasje në të dhënat zyrtare. Kompetente për këtë është Serbia dhe varet se sa është bashkëpunuese në këtë drejtim. Dhe, sa është bashkëpunuese Serbia sot e kësaj dite, tashmë është e ditur.

Rasti nga UNMIK-u ka kaluar në EULEX, i cili familjes i ka dhënë të njëjtën përgjigje, bile përkundrazi është mbyllur hermetikisht, as informacione të tjera më s'ka arritur të ketë kjo familje. Dhe, përderisa thuhet, po e përmend këtë rast, se janë të gjitha rastet kështu, "është çështje politike", atëherë kjo nuk është çështje me të cilën duhet të merret familja, por duhet të merret politika dhe politika duhet të ketë një bashkëpunim edhe me faktorin ndërkombëtar, po e përmend qëllimisht, sepse sistemin e drejtësisë në Kosovë deri më tash e kanë udhëhequr UNMIK-u dhe EULEX-i dhe vazhdon ende ta ketë, derisa t'i skadojë mandati.

Institucionet e Kosovës duhet të jenë më këmbëngulëse dhe efikase, të punojnë më shumë në zbardhjen e fatit të të gjithë të zhdukurve, pa përjashtim, edhe pse i përmenda këta intelektualë të shquar të Kosovës.

Po i kthehem historisë së zhdukjes së Ukshin Hotit, e cila mbetet ende e mistershme. Njeriu që punoi aq shumë për filozofinë e çlirimit të Kosovës, i përndjekur vazhdimisht nga forcat serbe, prej majit të vitit '99 ka humbur pa gjurmë. Ai ishte një nga mendjet më të ndritura shqiptare. Libri i tij emblemantik "Filozofia politike e çështjes shqiptare" është një skicë e qartë e idealeve tona kombëtare dhe mbase, siç shprehet shkrintari ynë i madh, Kadare, pikërisht ky nivel i lartë ka qenë edhe burim i fatkeqësisë që e ka ndjekur atë hap pas hapi.

Një intelektual si Ukshin Hoti nuk duhet të mbetet pa gjurmë, e them edhe më të vështirën, pa varr, sepse varri i tij do të ishte një vend kujtimi i të gjithë neve për ëndrrat e tij për Kosovën, për t'i rindërtuar idealet e tij dhe të gjithë atyre që ranë për këtë vend. A ka ndërgjegje udhëheqja e Serbisë që të flasim për pajtim, kur ne kërkojmë t'i respektojmë ata që u vranë për liri, duke e mbrojtur pragun e shtëpisë dhe kur ne kërkojmë t'i kthejnë ata që i rrëmbyen dhe i zhdukën. Me sa duket, ndërgjegjen e tyre e ka mbuluar heshtja, ndërkohë që heshtja është krim i dytë që po na bëhet të gjithëve.

Angela Merkel kërkon falje për krimet e Hitlerit, ndërsa serbët nuk e bëjnë këtë për krimet që kryen në Kosovë. Ne duhet ta zbardhim të vërtetën. Institucionet e Kosovës dhe ato ndërkombëtare duhet të bëjnë çdo gjë për ta zbardhur fatin e të gjithë të zhdukurve. Ta ndihmojmë ecjen e Kosovës. T'i ndihmojmë familjarët, së paku t'i shërojmë dhembjet e tyre. Njëzet vjet janë shumë të vështira që të jetohet në ankth dhe në dhembje.

Të nderuar kolegë deputetë,

Më lejoni që në fund t'ua shtoj rekomandimeve edhe një rekomandim nga unë.

Jemi në finalizimin e Javës së të Zhdukurve dhe kërkoj që kjo javë të fillojë më 12 maj dhe të përfundojë më 16 maj, në datën kur u kidnapua dhe u zhduk i madhi, filozofi e veprimtari Ukshin Hoti. Kjo është kërkesë e imja. Ndoshta, dikush do ta ketë ndonjë mospajtim, se ka qenë 23-27 prill, mirëpo edhe para 23 prillit kemi pasur të kidnapuar e të zhdukur, edhe pas 27 prillit.

Kështu që kërkoj që finalizimi i datës së të zhdukurve të lidhet me datën e zhdukjes së Ukshin Hotit. Faleminderit për mirëkuptim dhe për vëmendje!

KRYETARI: Ismajl Kurteshi e ka fjalën, bëhet gati Liburn Aliu.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Të nderuar familjarë të të zhdukurve,

Të nderuar deputetë,

Serbia ka ushtruar aq shumë dhunë mbi shqiptarët, sa shpesh nuk kemi mundësi as t'i përmendim masakrat që Serbia i ka ushtruar mbi shqiptarët, që nga viti 1878, e sidomos pas vitit 1912, kur dhuna sistematike shtetërore e Serbisë është intensifikuar mbi popullin shqiptar në trojet e okupuara nga Serbia. Terrori serb mbi shqiptarët e Kosovës vazhdoi deri në qershor të vitit 1999.

Pas qershorit të vitit 1999, Serbia e filloi lojën më të ndyrë të mundshme, fshehjen e mbi dymijë kufomave të shqiptarëve të masakruar gjatë luftës së fundit. Derisa për dhjetëra mijëra të zhdukur shqiptarë nga Lufta e Parë deri në fund të Luftës së Dytë Botërore as që është diskutuar ndonjëherë, janë harruar masakrat e vitit 1912 në Kumanovë, kur u masakruan mbi 25 000 shqiptarë; masakra e Gjilanit e vitit 1944, kur u zhdukën mbi 8 000 shqiptarë, në mesin e tyre

edhe dy gjyshërit e mi; masakra e Tivarit, e shumë masakra të tjera, për të cilat Serbia asnjëherë nuk u ndëshkua, derisa të zhdukurit e luftës së fundit po shfrytëzohen për përfitime politike të Serbisë.

Në vend se Serbia të dënohet për gjenocid mbi popullatën civile të Kosovës dhe fshehjen e kufomave të tyre nga faktori ndërkombëtar çdo kufomë e zbuluar nga ata që e fshehën krimin, cilësohet si kontribut i Serbisë për normalizim të marrëdhënieve dhe integrim në Bashkimin Evropian. Asnjë shtet në botë dhe asnjë udhëheqje normale e asnjë shteti nuk do të hynte në bisedime pa u gjetur kufomat e të zhdukurve, sepse kështu, duke i injoruar, ajo që është më e çmueshme e një vendi, ne kemi pranuar që të futemi në projektet e Serbisë që edhe të zhdukurit e luftës së fundit ta pësojnë fatin e qindra-mijëra të zhdukurve të mëhershëm, për të cilët as që është shtruar ndonjëherë ndonjë kërkesë për zbulimin e tyre.

Është në dorën e këtij Kuvendi që të mos lejojë bisedime me Serbinë para se ajo të kërkojë falje për masakrimin e rreth 15 000 shqiptarëve të pafajshëm në luftën e fundit dhe të qindra-mijëra shqiptarëve që nga viti 1878.

T'i identifikojë dhe t'i dënojë autorët e krimeve të luftës së fundit, t'i kthejë të gjitha kufomat që Serbia po i mban peng për përfitime politike dhe t'i kompensojë dëmet e luftës.

Zbulimi i personave të pagjetur është në dorën tonë, zbulimi nuk vjen duke e lutur Serbinë që t'i kthejë personat të pagjetur, por zbulimi dhe kthimi i të pagjeturve mund të ndodhë vetëm atëherë kur ne në këtë Kuvend vendosim të ndërpriten bisedimet me Serbinë.

Bisedimet me Serbinë duhet të ndërpriten, sepse edhe ashtu normalizim me Serbinë nuk do të ketë, pavarësisht marrëveshjeve të nënshkruara, pa zbulimin e të pagjeturve dhe pa ndëshkimin e autorëve të krimit, e autori dihet, kjo është Serbia. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Liburn Aliu.

LIBURN ALIU: Nuk mendova ta prish radhën.

Vërtet unë pajtohem me shumicën e asaj çka u tha këtu dhe jashtëzakonisht i vlefshëm ishte edhe filmi dokumentar që e pamë. Pothuajse në të gjitha fjalimet shtrohet çështja e negociatave dhe çështja e kushtëzimit të negociatave me Serbinë, e që lidhet me çështjen e të pagjeturve.

Filmi i parë që u shfaq këtu ishte ai për profesor Ukshin Hotin, edhe pse nuk e kisha ndërmend të flas qëllimisht, edhe ai film, ndër të tjera, më shtyu që të them, meqenëse kanë qenë disa bashkë me profesor Ukshin në burg deri në ditën e fundit kur është marrë dhe është hequr nga Burgu i Dubravës, ku kemi qenë bashkë.

Të gjithë të burgosurit jemi përshëndetur me profesor Ukshinin, ai ka dalë prej aty i gjallë, askush deri më sot nuk e ka konfirmuar vdekjen e tij.

Është në listën e personave të pagjetur dhe për të nuk kemi marrë asnjëherë asnjë informacion.

Në anën tjetër, më kujtohet që gjatë kohës sa kemi qëndruar në burg kanë qenë negociatat që janë bërë në Rambuje, ku mendoj se aso kohe është dashur që në ato negociata të kërkohet që të jetë profesor Ukshin Hoti pjesë e ekipit negociator, një gjë e tillë nuk ndodhi.

Pastaj kemi pasur negociatat në Vjenë, patëm negociatat në Bruksel. Unë konsideroj që aso kohe, përpos që është dashur të kushtëzohen negociatat me çështjen e të pagjeturve, është dashur që ne të kemi synim që në ato delegacione tona ta kemi Ukshin Hotin, që të na i udhëhiqte negociatat.

Për shkak se konsideroj që, mbase mund të jem subjektiv, kam qenë me te në një dhomë, po unë mendoj që në çfarëdo lloj negociatash me Serbinë, Ukshin Hoti do të kishte qenë njeriu që mua personalisht do të më bënte të ndihesha më i sigurt që në ato negociata çështja e shqiptarëve të Kosovës dhe çështja e Kosovës në përgjithësi do të mund të mbrohej më mirë.

Prandaj, unë kërkoj që për negociatat e radhës tash e tutje Kosova ta vendosë në krye të delegacionit profesor Ukshin Hotin, le të kërkojë nga Serbia të na e kthejë të gjallë dhe negociatat t'i kemi me Ukshin Hotin në delegacion. Nuk po shoh ndonjë tjetër, prej atëherë e deri sot, dikush që do të na udhëhiqte dhe të na përfaqësonte më mirë me Serbinë sesa Ukshin Hoti. Askush nuk e ka konfirmuar deri më sot vdekjen e tij, e kemi në listën e të pagjeturve, le të gjendet dhe ta kemi në delegacionin tonë në negociatat e radhës. Ky le të jetë edhe kushti, le të jetë kushti i negociatave, meqenëse jemi të gjithë këtu dakord që t'i kushtëzojmë negociatat me të pagjeturit, po në delegacionin tonë të radhës, në negociatat e radhës që do t'i kemi në Vjenë me Serbinë, në Bruksel apo kudo, ta kemi Ukshin Hotin në delegacionin tonë.

Për sa u përket të tjerave, ato që u fol këtu në çështjen e dallimit, pra po flitet që çështja e të pagjeturve dhe çështja e zhdukurve dhe e luftës në përgjithësisht e viktimave është politike dhe të mos politizohet, ajo është politike.

Lufta me Serbinë ka qenë luftë e karakterit politik, nuk ka qenë luftë e karakterit as etnik madje, e as fetar. Ne nuk kemi luftuar me Serbinë për shkaqe të dallimeve në fe apo shkaqe të dallimeve etnike, ka qenë thjesht politike.

Cilido këtu që po flet, po thotë shumë qartë, me Serbinë. Ne shqiptarët e Kosovës kemi luftuar me Serbinë dhe kjo i jep karakterin e qartë politik luftës sonë kundrejt Serbisë, ka qenë Serbia shteti i cili na ka pushtuar, i cili ka krijuar çarjet dhe dallimet dhe ka ndikuar madje edhe në

dallime, ka krijuar ndarje në baza etnike, të cilat kanë qenë shumë më tepër të theksuara pas pushtimit nga Serbia sesa para dhe kjo i jep shumë qartë luftës sonë karakter politik, dhe nëse nuk shtrohen politikisht këto probleme, atëherë ato shumë thjesht mund të përsëriten në të ardhmen.

Te çështja e të harruarit ose jo, përgjegjësia kryesore për të mos harruar atë çfarë ka ndodhur i takon shtetit, tek në fundit vjen qytetari, i cili nuk do të duhej të harronte. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Rasim Selmanaj.

RASIM SELMANAJ: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të respektuara familje të të zhdukurve në Kosovë,

Në Kosovë gjatë vitit 1998-99 ushtria dhe policia serbe, në bashkëpunim edhe me grupet paramilitare, kanë bërë një varg masakrash, të cilat kanë mbetur të pandëshkuara edhe sot e kësaj dite.

Por, ne sot po flasim për të zhdukurit e Kosovës.

Ende sot e kësaj dite konsiderohen të zhdukur mbi 1 650 persona, mbi një milion shqiptarë të ballafaquar me vdekjen u dëbuan jashtë Kosovës gjatë operacionit për spastrimin etnik.

Duhet cekur, së pari ushtria, policia dhe forcat paramilitare serbe bënë masakra, ndërsa shërbimet serbe e përgatisnin planin dhe operacionet sekrete për t'i fshehur dhe zhdukur gjurmët e krimet.

Në këto operacione për zhdukjen, shkatërrimin e dëshmimeve dhe fshehjen e kufomave të masakruara kanë marrë pjesë strukturat më të larta shtetërore të Serbisë.

Këtë fakt e dëshmon edhe zbulimi i varrezave masive me trupat e shqiptarëve në Batanjiçë, Petrovo Selo, Danub, Rudnicë të Rashkës e të tjera.

Sipas disa dëshmitarëve serbë, të cilët janë prononcuar tash edhe para mediave, çmenduria e kriminelëve serbë kishte shkuar aq larg sa që me kafkat e shqiptarëve kishin bërë llamba ndriçuese për tavolinat e tyre.

Për të gjitha këto, edhe pse Serbia në krye me Slobodan Milosheviqin i lau me gjak për më shumë se një dekadë pothuajse të gjitha hapësirat e ish-Jugosllavisë, krimet serbe në Kosovë dhe në këto hapësira u dënuan pak, apo në disa raste aspak.

Gjyqi i Slobodan Milosheviqit u zvarrit tej mase në procesin e Tribunalit të Hagës kundër tij.

Kreu i Serbisë, Milutinović, u shpall i pafajshëm, ndërkaq u dënua vetëm disa ushtarakë e kryepolicë të Serbisë për përgjegjësitë e tyre për krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë dhe atë për “krime kundër njerëzimit”. Pa e përmendur dhe pa i dënua për veprat e vërteta penale që i kanë kryer në Kosovë, të cilat në të drejtën ndërkombëtare kualifikohen si gjenocid.

Në mesin e këtyre ngjarjeve kaq të dhimbshme që kanë ndodhur, duke i përfshirë këtu një varg masakrash e krimesh kundër popullit shqiptar, problemi i të zhdukurve apo i të pagjeturve është problem në vete, i cili do trajtim të veçantë, sepse tash për tash është ndër problemet më delikate.

Sipas regjistrimit të Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq, në përfundim të luftës në Kosovë konsideroheshin të zhdukur 5 982 persona.

Duhet cekur se një pjesë e të zhdukurve janë gjetur gjallë në burgjet e Serbisë, ndërsa një pjesë e të zhdukurve janë gjetur në varreza masive dhe janë kthyer në Kosovë.

Në mesin e personave të zhdukur 261 janë femra dhe 1 407 meshkuj, 135 prej tyre kanë qenë nën moshën 18-vjeçare, ndërsa 331 ishin mbi moshën 65-vjeçare.

Edhe pse të gjitha qeveritë e gjertanishme kanë qenë të përkushtuara rreth problemit të të pagjeturve, megjithatë është bërë pak për të zbardhur të vërtetën rreth fatit të 1 650 personave që ende figurojnë të zhdukur, pra, të pagjetur në Kosovë.

Rreth kthimit të trupave të të pagjeturve është dashur të bëhej një presion i vazhdueshëm ndërkombëtarë ndaj Serbisë për t'i kthyer trupat e tyre në Kosovë. Nëse këto veprime kanë munguar gjerë më tani, tani është koha e përshtatshme për ta bërë këtë.

E dimë që Serbia ka kohë që këtë proces e ka kushtëzuar me kthimin e afro 400 trupave të serbëve, romëve e boshnjakëve që, sipas Serbisë, janë vrarë në Kosovë, por ky problem do trajtim e hetim special, ngase gjatë historisë strukturat e shërbimit serb sekret kanë vrarë dhe njerëz të vet për t'i fajësuar më pastaj shqiptarët, siç ndodhi me rastin “Panda” në Pejë, e një varg rastesh të tjera të ngjashme me rastin “Panda”.

U bënë njëzet vjet që problemi për të pagjeturit rri plagë e hapur që kullon gjak për ditë. Familjarët e të pagjeturve kanë brena të mëdha për të afërmit e tyre, ata duan ta dinë dhe të kenë një varr për ta, që shpirti i tyre të qetësohet e të pagjeturit të prehen në paqe.

Pos problemeve të shumta me këtë kategori, institucionet përkatëse, si Instituti i Mjekësisë Ligjore, Kryqi i Kuq Ndërkombëtar i të Drejtave të Njeriut, Forumi për të Drejtat Humanitare, e

institucione të tjera janë marrë me këtë problem, jo rrallë herë janë ballafaquar edhe me problemin e identifikimit të personave të zhdukur. Kështu që një numër jo i vogël i pagjeturve që u kthe në Kosovë u varrosën pa ADN, që do të thotë se ata ende janë pa varr.

Shoqëria kosovare nuk duhet ta humbë interesimin për t'u marrë me çështjen e personave të zhdukur, me asnjë kusht. Që nga themelimi i institucioneve të Kosovës janë bërë vërejtje në vazhdimësi për mosangazhim në zbardhjen e fatit të zhdukurve nga lufta e fundit në Kosovë. Kjo brengë nuk do të harrohet dhe do të bëjmë çmos për të çuar këtë proces përpara derisa ta gjejmë edhe personin e fundit.

Më kujtohet rasti i nënës Pashke Markaj, nga Korenica, e cila për ta zgjuar ndërgjegjen njerëzore, pasi iu kthyen eshtrat e dy djemve, Gjovalinit, 36 vjeç e Milanit, 35 vjeç, nga varrezat masive të Batajnicës së Serbisë, katër ditë pasi i varrosi bijtë e saj në Lëndinën e Lotëve në Mejë, më 27 maj të vitit 2003 u vetëflijua, duke e djegur veten me benzinë, ashtu siç vepruan forcat serbe ndaj trupave të djemve të saj.

Ne si politikë e Kosovës, vendit kemi ditur t'ia dhurojmë një Gjykatë Speciale njëetnike, vetëm për shqiptarët, por kemi dështuar ta zgjidhim problemin e të pagjeturve.

Kosova i ka faktet me emër e me mbiemër, kush i ka bërë krimet, prandaj ata kriminelë dhe Serbia e dinë saktë ku ndodhen trupat e të pagjeturve. As nuk janë dënuar kriminelët, e as nuk janë zbuluar varrezat masive të të pagjeturve, pa të cilët liria nuk do të jetë kurrë e plotë.

Kush ka bërë krime në këtë vend? Serbia që bërë masakër në Lubeniq, në Qyshk, Mejë, Beleg, në Burg të Dobravës, në Izbicë, në Reçak e gjithandej nëpër Kosovë, e përtej kësaj po vazhdon t'i mbajë të fshehura varret masive në Serbi të 1 650 njerëzve të Kosovës apo UÇK-ja dhe shqiptarët që luftuan për lirinë e Kosovës?

A do të duhej të merrej Gjykata Speciale me këto masakra dhe me 1 650 të pagjeturit, apo me krimet e pretenduara të shqiptarëve?

Unë nuk jam kundër nëse vërtetohet që qoftë edhe një shqiptar që ka bërë krime ta thotë drejtësia fjalën e saj, por rrjedhimisht, edhe sot e kësaj dite nuk kemi arritur t'i gjejmë trupat e njerëzve tanë, e as të dënohen kriminelët serbë për gjithë atë gjenocid, por kemi krijuar një gjykatë speciale vetëm për shqiptarët që është një padrejtësi historike e gjithsesi me pasoja për të ardhmen e vendit tonë.

Paramendoje sikur Serbia t'i kishte argumentet e gjithë këtyre masakrave, se cili do të ishte imazhi ynë në botën demokratike.

Dua t'i marr dy shembuj konkretë. Për shembull, masakra e Belegut, dihet saktë se krimineli Zoran Gjurishiq i Prapaqanit është personi që mund t'i dijë ku janë 38 të zhdukur të kësaj masakre. Mirëpo askush nuk merret me këtë punë.

Krejt në fund, unë bashkë me Nait Hasanin e Liburn Aliun jemi dëshmitarë dhe të mbijetuar nga masakra e Burgut të Dubravës, sikurse edhe qindra shqiptarë të tjerë. Ne i dimë emrat e kriminelëve, ata nuk kanë dalë para drejtësisë, e që do të duhej të tregonin vendin ku gjenden edhe disa të burgosur të ekzekutuar nga po këta kriminelë tashmë të njohur.

Veprimtari dhe njeriu gjenial i Kosovës, Ukshin Hoti, është zhdukur pa gjurmë, dihet data e lirimt dhe ata që e "kanë shoqëruar" nga burgu, por nuk dihet asgjë ende për fatin e tij.

Lehtë është të kritikosh apo të dalësh si pozitë apo opozitë në Parlament të flasësh, por të gjithë ne këtu duhet dhe mund të bëjmë më shumë për të pagjeturit që vazhdon të jetë plagë jo vetëm e familjarëve, por e krejt Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, Rasim! Fjalën e ka deputeti Veton Berisha.

VETON BERISHA: Faleminderit, i nderuar kryesues Shala!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashura familje të personave të pagjetur,

Më lejoni që po ashtu të jap kontributin tim në temën të cilën po e diskutojmë, është një prej çështjeve jashtëzakonisht më të ndjeshme, sa herë që vjen 27 prilli kjo çështje ngritet dhe është jashtëzakonisht e ndjeshme edhe në Kuvendin e Kosovës, ku ne këtu nga vetë kolegët tanë dëgjojmë përjetime personale apo të familjarëve të tyre dhe në këtë rastin tonë duhet të jemi shumë të kujdesshëm edhe për fjalimet tona, sepse duhet të kujdesemi që të mos lëndojmë deri në atë masë sa që të prekët njëri apo tjetri.

Unë jam nënshkruar i kësaj iniciative dhe do të jem gjithmonë mbështetës i këtyre çështjeve deri në zbardhjen e fatit të secilit të pagjetur, pa dallim etnie në Kosovë dhe çdo herë do të jem mbështetës dhe do të jem kërkues i drejtësisë për secilin pa dallim.

Në mesin e 1652 familjeve me dhjetëra prej tyre të pagjeturve janë edhe nga komuniteti egjiptian dhe ashkali dhe normalisht kjo na bënë më të përgjegjshëm për të diskutuar dhe kërkuar në të njëjtën kohë drejtësi edhe për të njëjtit, sepse të gjithë nga këta ishin viktimat civile.

Dhe, tani neve nuk na mbetet gjë tjetër përpos që të ngulim këmbë dhe të kërkojmë dhe diskutojmë dhe t'u japim një shpresë familjeve të tilla që dikush interesohet dhe kujdeset për ta.

Mendoj se secili i zhdukur dhe secila familje, pavarësisht etnisë, e ka ndjenjën e njëjtë të lëndimit apo që i mungon familjari dhe vërtet në këtë aspekt, të gjitha viktimat dhe të gjitha familjet e personave të pagjetur mendoj që duhet të trajtohen barabartë.

Personalisht nganjëherë nuk ndihem mirë, për shkak që në iniciativat edhe në iniciativat e pajtimit, po edhe në deklaratimet publike të zyrtarëve të lartë të shtetit komuniteti egjiptian dhe ashkali përjashtohet, domethënë nuk përmenden që ky komunitet ka edhe viktimat civile, ka edhe të pagjetur, ka edhe të vrarë, ka edhe dëshmorë, ka edhe persona të cilët kanë qenë të angazhuar edhe në luftën e fundit në Kosovë në anën e shqiptarëve dhe, aq më tepër, kur janë dëshmuar si persona të cilët kanë qenë goxha të përgjegjshëm.

Nuk jemi këtu për t'i mbajtur krah njërit apo tjetrit, po vërtet kemi qenë pjesë e politikave që kanë qenë jashtëzakonisht agresive të Slobodan Milosheviqit, i cili në një formë apo tjetrën na ka keqpërdorur dhe na ka vënë në një pozicion ku pas vitit '99 është krijuar një urrejtje, e cila edhe sot nuk e ka kuptimin.

Kjo urrejtje, disa prej familjeve ose personave të pagjetur, janë pjesë e vazhdimësisë të asaj urrejtjeje të krijuar gjatë konfliktit të fundit. Andaj, mendoj që e kemi obligim si institucione, qoftë në Qeveri, qoftë këtu në Kuvend të Kosovës, kemi obligim të punojmë, sidomos në raport me ne, të punojmë jashtëzakonisht shumë dhe të tregohet e vërteta kush ishim ne dhe çka bëmë ne?

Komisioni shtetëror për pajtim dhe vërtetësinë e së vërtetës, ne si komunitete na ka përjashtuar prej pjesëmarrjes në atë komision dhe mendoj që ne duhet të jemi të pranishëm.

Aq më tepër nuk ndihemi mirë kur nderohen viktimat civile të shqiptarëve dhe serbëve dhe asnjëherë nuk ndërmerret veprim, qoftë nga presidenti i shtetit, apo edhe vartës të tjerë që të nderojnë apo të respektojnë edhe viktimat e komuniteteve të tjera.

Nuk jemi duke kërkuar mëshirë, s'po kërkojmë asgjë tjetër, përpos që këto familje të nderohen dhe normalisht që kërkojmë edhe drejtësi.

Pritet shumë prej neve, pritet që drejtësia të marrë fatin e atyre në dorë dhe asnjëherë të mos etiketohet asnjë mekanizëm institucional, i cili ka pasur mundësi t'i bëjë.

Secili veprim ka qenë individual dhe mendoj duhet të trajtohet edhe si i tillë dhe asnjë prej neve, unë i përcolla të gjitha fjalimet këtu, askush nga ne nuk ishte këtu që të mbrojë personat të cilët kanë kryer këto vepra dhe as nuk duhet mbrojtur.

Andaj, më lejoni që nga këtu të kërkoj po ashtu që ne të ngulim këmbë dhe të jemi pjesë aktive e të gjitha veprimeve jo vetëm më 27 prill, por ne kemi mundësi edhe jashtë 27 prillit të ndërmarrim secilin veprim që është i nevojshëm, në mënyrë që këto familje ta dinë fatin e familjarëve të tyre.

Kishim dashur të jemi pjesë e hartimit të rekomandimeve në fund, për shkak se thjesht më në fund dëshirojmë të kemi hapësirë të rekomandimeve dhe institucioneve t'u bijë në vesh. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Besa Gaxherri.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, nënkryetar zoti Shala!

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot tema të cilën po e diskutojmë, është e vështirë, e rëndë për secilin prej nesh, kemi këtu persona që kanë momente edhe më të vështira, ndoshta dallojnë prej njëri-tjetrit, por sinqerisht ne nuk kemi asnjë familje në Republikën e Kosovës, shqiptarë, që s'e ka prekur dhembja drejtpërdrejt apo tërthorazi.

Njëkohësisht edhe unë pajtohem që sot e me këto tema ne kurrë nuk duhet të ndahemi pozitë e opozitë, por realisht nuk mund t'i ikim realitetit, se na shohin qytetarët, është mjerim, askujt nga Qeveria nuk i intereson të ulemi të debatojmë. Ne nuk mund t'i ngjallemi të vdekurit tanë, as nuk mund ta detyrojmë Serbinë të na i kthejë ata të cilët janë atje, por ne duhet të ulemi këtu, të na shohin të gjithë se jemi të unifikuar për këto çështje dhe ne kërkojmë drejtësi, kërkojmë sidomos nga faktori ndërkombëtar që vërtet ta shohë këtë popull se ka vuajtur shumë, po vuan ende dhe dikush ende, edhe pas kaq vitesh, e në këtë rast Serbia po pretendon të luajë me dhembjen tonë.

Kosova natyrisht që ka mijëra të zhdukur, ka me mijëra të pushkatuar, me mijëra të gjymtuar, me mijëra të dhunuar fizikisht e seksualisht, qindra-mijëra shtëpi, objekte të shkatërruara dhe natyrisht unë pajtohem se dhimbja është e njëjtë si për të pagjeturit shqiptarë, si për të pagjeturin serb, çdo familje dhembjen e ka të njëjtë, por ne sot po diskutojmë nga institucioni më i lartë i këtij vendi, siç është Kuvendi i Republikës së Kosovës, ne jemi të zgjedhurit e këtij popullit. Andaj ne nuk guxojmë t'i relativizojmë gjërat dhe nuk mund të themi se është e njëjtë si të jenë të vrarë 200, 300, si 20 mijë, 30 mijë.

Dhe, çka duhet nxjerrë ne prej këtij debati, unë u ndjeva mirë kur i pashë në fillim kolegët e mi deputetë nga Lista serbe këtu, e tash nuk më vjen mirë që nuk janë.

Ne duhet ta gjejmë forcën së paku këto familje shqiptare që për 20 vjet, me gjithë këto dhembje, sot ende gjejnë fuqinë, jo që s'e kemi ditur e që s'po e dimë sot, por ne taksapaguesit e këtyre shqiptarëve, e këtyre familjeve, i paguajnë kolegët tanë deputetë dhe ministrat tanë serbë. Dhe,

ata kanë obligim të punojnë me ne për çdo çështje, kanë obligim në aspektin financiar, por edhe moral. Shumë më shumë moral. Unë konsideroj se është momenti, ndoshta, për të mos pak vonë, por është momenti i duhur për kolegët tanë serbë që vërtet ata së paku ta gjejnë fuqinë të dalin këtu, të kërkojnë falje dhe të bashkohemi të punojmë për Kosovën bashkë, sepse Serbia kurrë më nuk do ta ketë mundësinë që ta sundojë Kosovën, as ta nënshtrojë, as ta poshtërojë kurrë, asnjëherë. Dhe, këtë duhet ta dinë edhe kolegët tanë deputetë, edhe Serbia.

Por, në këtë rast, ndoshta është mirë t'i drejtohem edhe Bashkësisë Evropiane, sidomos Brukselit. Ne sot kur e shikuar këtë dokumentarin këtu, kemi nevojë ta shikojmë dhe unë mendova se duhet ta lëshojmë shumë më shpesh. Ne shohim nëpër medie tona, por këtu në këtë institucion duhet ta lëshojmë. Duhet ta lëshojmë që ta shohë ndonjëherë edhe ndonjë lider institucional yni që habitet e nuk e kryen punën me përgjegjësi, por ta shohë edhe bota, sepse ne vërtet po ballafaqohemi, një popull i tërë, me dhimbje e me trauma dhe po ndërtojmë shtet. Dhe, po e zgjatim, po e gjejmë forcën për ta zgjatur dorën te komuniteti serb, që është në Kosovë. Pra, jemi të gatshëm të jemi fqinjë të mirë edhe me Serbinë dhe a s'është mjaftë kjo? Dikush duhet ta vlerësojë këtë.

Dhe, a s'është mjaft me këtë varfëri tonën, me dhimbjet tona, që ne të gjejmë fuqinë e të paguajmë financa për serbët e veriut, edhe energjinë që e shpenzojnë ata? A s'është mjaft kjo për Brukselin që ta shohë se ne vërtet e kemi pasur dhe e kemi seriozisht sot edhe për ta bërë shtetin, por edhe për ta shtrirë dorën ndaj komunitetit serb? Por, çka është mjaft, natyrisht është mjaft.

Kategoria e familjarëve të zhdukurve kanë të drejtë ligjore. I kemi bërë disa mundësi ligjore, por sidomos ne deputetët do të jemi gjithmonë pranë tyre sa i përket asaj për t'u ofruar nëpërmjet ligjit ndonjë mbështetje, e ndoshta, e pa ndoshta, për ta nuk ka mbështetje më të fuqishme, vetëm ajo morale. Sot, kolegë të nderuar deputetë, ne nuk është hera e parë që kemi bërë debat për këtë temë dhe kemi nxjerrë rezoluta, por unë mendoj se sot dhe besoj që do të jemi të gjithë të unifikuar rreth një rezolute, e cila duhet të ketë qëllim përkushtimin tonë dhe unitetin tonë rreth këtyre temave, gjithmonë pa u ndarë në grupe, dhe natyrisht për të kërkuar nga Serbia se pse të zhdukurit e komuniteteve tjera nuk mund të relativizohen me shqiptarët. Ne e pamë dokumentarin, dëshmitarët, zyrtarët serbë, të cilët dëshmojnë sesi i kanë pushkatuar, masakruar dhe si i kanë zhdukur kufomat tona. Atë e ka bërë shteti në mënyrë të organizuar. Neve ka mundur të na ndodhë ndonjë person, individ që ka vlarë dhe ka zhdukur person të komunitetit tjetër, por ai është individ, ndërsa neve duhet të na japë llogari Serbia për të zhdukurit tanë dhe për tragjedinë që ka ndodhur në Kosovë. Dhe shiko, edhe mbi këtë dhimbje te ne ende nuk është pranuar që ka pasur gjenocid. Në Kosovë ka pasur gjenocid. Kolegët tanë, deputetë serbë, duhet t'i shohin këta dokumentarë, se unë jam e sigurt që propaganda e shtetit serb nuk shfaq kësi dokumentarësh dhe shumica e popullit serb nuk e di, është i manipuluar se çfarë ka ndodhur në Kosovë. Dhe, unë mendoj se këta duhet ta shohin që në Kosovë ka pasur gjenocid dhe Serbia

duhet të përgjigjet për gjenocidin. Edhe Serbia duhet ta dijë që është mjaft. Çka është mjaft, është mjaft.

Ne nuk kemi kohë. 20 vjet kanë kaluar. Nuk kemi kohë për të humbur. Të ulemi të bisedojmë me Serbinë për njerëzit tanë që na kanë masakruar dhe na kanë humbur. Të ulemi të bisedojmë me Serbinë për pasurinë tonë që na ka vjedhur dhe na ka shkatërruar. Të ulemi të bisedojmë me Serbinë për gratë dhe vajzat tona që na i ka dhunuar, dhe ta presim Serbinë a po e pranon a s'po pranon Kosovën. S'po e presim Serbinë, por duhet t'i drejtohem Bashkësisë Evropiane. Mjaft është mjaft!

Ne kemi rrugën tonë, një shtet të pavarur, dhe nuk mund të humbim kohë me Serbinë, por duhet të humbim kohë me përfaqësuesit tanë kur ata nuk i realizojnë premtimet dhe të ecim tutje dhe t'i qëndrojmë afër çdo kategorie që ka shumë dhimbje, e që fatkeqësisht shumica jemi të përfshirë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zenun Pajaziti nuk është në sallë, kështu që po ia jap fjalën deputetes Ganimete Musliu, dhe pas saj propozoj që të marrim pauzë deri në orën 15:30.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Të nderur ju pak kolegë deputetë që jeni sot në sallë,

Sinqerisht kisha planifikuar të flas krejt diçka tjetër sot, por më duhet ta ndryshoj për shkak të gjendjes që e kemi në sallën e Kuvendit.

E them me sinqeritetin më të madh që sot kur po diskutojmë për një temë kaq të ndjeshme, ndihem shumë e turpëruar pse jam pjesë e këtij Kuvendi, pjesë e këtyre institucioneve. E kisha një kërkesë direkte për kryeministrin Haradinaj: Zoti kryeministër, të kisha lutur shumë atyre 200 zëvendësministra që i keni emëruar në Qeverinë e juaj, që bashkërisht i kemi emëruar, shtojua edhe nja 22 zëvendësministra, të cilët do të jenë përgjegjës ekskluzivë që të merren me Kuvendin e Republikë së Kosovës, meqë ju asnjëherë nuk po keni kohë të na dëgjoni, nuk po keni kohë asnjëherë të na jepni përgjigje si deputetë dhe thjesht na injoroni deri në pafundësi.

Të nderuar deputetë,

Kolegë të dashur,

Ka ardhur momenti i fundit që Parlamentit të Republikës së Kosovës përfundimisht t'i kthehet dinjiteti, e dinjiteti i kthehet vetëm nëpërmjet neve si deputetë. Thjesht, të mos e durojmë këtë paturpësi, e cila po ndodh dhe këtë ofendim që është duke na u bërë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, nga ata të cilët ne i kemi votuar. Kemi ditur shumë mirë të jemi të zëshëm kur kemi qenë shpeshherë ndoshta edhe në ulëset e opozitës për ministrat, të cilët kanë qeverisur më herët. Duhet të dimë ta ngremë zërin edhe sot kur jemi në Qeveri dhe të kërkojmë përgjegjësi prej secilit ministër që e ka marrë votën tonë. Nëse qytetari na e ka dhënë besimin neve të jemi

deputetë dhe t'i përfaqësojmë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, ne ua kemi dhënë besimin këtyre ministrave dhe i kemi në dorën tonë që t'i thërrasim në përgjegjësi dhe ta kthejnë vëmendjen te Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Sot kisha shumë pyetje për ministrat tanë përkatës, të cilët do të kontribuonin direkt në zgjidhjen e problemit të të pagjeturve, ose thjesht në zgjidhjen e fatit të tyre. Sot kisha dashur të di se ku është tema e të pagjeturve në tavolinat e Brukselit. Nuk e di kë ta pyes! Asnjëherë nuk kemi marrë ndonjë dokument që të na raportohet saktë se ku është gjendja e diskutimit të tyre. Sot kisha dashur ta pyes edhe ministrin e Punëve të Jashtme: ku janë diplomatët tanë, sot kur Serbia anekënd botës ka marrë ofensivë për t'i tërhequr njohjet e Republikës së Kosovës si shtet, ku janë diplomatët tanë? Çka bëjnë ata? Pse paguhen diplomatët e Kosovës nëpër botë? Thjesht, ne, ose duhet të punojmë, ose duhet të tregojmë që jemi të pazotë për t'i zgjidhur problemet e vendit tonë.

Asnjë diplomat i Republikës së Kosovës, përjashtim bën vetëm Vlora Çitaku, asnjëherë nuk e sensibilizon opinionin për gjenocidin që ka ndodhur në Kosovë, ndërsa shkojnë e fryhen si gusana para gjenocidit të huaj, edhe duke i respektuar varrezat e të huajve. Askush nuk ta pranon ty mirënjohjen dhe nderimin nëse nuk e nderon vetveten dhe nuk e respekton vetveten. Sot kisha pasur dëshirë që ta shoh sallën plot me deputetë, fatkeqësisht nuk janë. Sot kisha dashur t'i shohë edhe përfaqësuesit e bashkësisë ndërkombëtare, ambasadorët e vendeve botërore, të cilët janë në Kosovë, për të cilët e dimë shumë mirë angazhimin e tyre kur kemi çështje të ndjeshme, siç ishte Gjykata Speciale në Kosovë. Dhe, sot ky debat më së paku i ngjan një debati që do të duhej të ndodhte. Sot ne treguam histori. Nuk jemi ne të denjë për ta shkruar historinë, dikush tjetër duhet të merret me të. Sot ne e luajtëm rolin edhe të vajtoveve këtu në foltore. Nuk është roli i deputetit të vajtojë. Roli i deputetit është t'i thërrasë në përgjegjësi personat, të cilët janë përgjegjës për ta zbardhur fatin e të pagjeturve.

Prandaj, shpreh indinjatën time të thellë për këtë mospërgjegjësi të Qeverisë, në rend të parë, por edhe të kolegëve deputetë dhe personave tjerë përgjegjës. E mbi të gjitha, sot dua të solidarizohem me të gjithë familjarët e të pagjeturve dhe ju kërkoj falje, sepse nuk do të ndalem me emër për asnjë të pagjetur, nuk do të përmend asnjë fshat, ose asnjë masakër, nga frika se po i hyjnë në hak dikujt dhe ka familjarë, të cilët asnjëherë nuk i ka përmendur askush dhe nga modestia dhe mjerimi kanë mbetur nën pluhuron e harresës. Sot dua të bashkëndiej me të gjithë ata familjarë të personave të pagjetur dhe uroj që kjo të jetë thirrja e fundit dhe të mos mblidhemi të debatojmë, sepse jam deputete në tri mandate dhe nuk bëjmë asgjë më shumë veçse debatojmë dhe flasim ndërmjet vete dhe tregojmë se kush më shumë ka bërë për këtë punë, e në realitet s'kemi bërë asgjë dhe thjesht foltoren e Parlamentit jemi duke e shfrytëzuar për promovim të vetvetes.

Unë uroj që ky të jetë debati i fundit që ne debatojmë ndërmjet vete dhe thjeshtë në vazhdim të kërkojmë përgjegjësi, raport nga Qeveria, dhe thjesht të kemi informata të sakta se ku është gjendja e dialogut dhe tema e të pagjeturve në tavolinën e bisedimeve në Bruksel. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Andin, e ke një ndërhyrje më duket? Po, urdhëro!

ANDIN HOTI: Faleminderit, kryesues!

Unë dhe Saranda me mirëkuptimin tuaj, i ftojme përfaqësuesit e grupeve parlamentare që në kohë të pazhës, meqenëse pauza do të bëhet tash në orën 14:00, të mbledhemi, të takohemi, në mënyrë që t'i harmonizojmë qëndrimet, rekomandimet e kësaj rezolute dhe deputetët, të cilët kanë rekomandime dhe në vazhdimësi ata që nuk kanë arritur që të flasin deri tash, t'i dërgojnë ato te përfaqësuesit e tyre të grupeve parlamentare dhe t'i harmonizojmë tash, në mënyrë që të mos vonohemi më vonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, lus përfaqësuesit e grupeve parlamentare që t'i dërgojnë anëtarët që të diskutojnë, ose nëse doni deklaroni tani sipas radhës. Avdullah Hoti e ka fjalën.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues!

Ne e kemi caktuar, është deputetja Lirije Kajtazi që do të punojë bashkë me grupet tjera parlamentare.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i PDK-së?

GANIMETE MUSLIU: Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e propozon doktoreshën Flora Brovina.

KRYESUESI: Faleminderit! Lëvizja Vetëvendosje? Saranda është, a po? Në rregull! Grupi i Deputetëve të Pavarur?

DARDAN SEJDIU: Faleminderit!

Grupi i Deputetëve të Pavarur e propozon doktor Driton Çausin.

KRYESUESI: Faleminderit! Nga AAK s'është askush në sallë, po ashtu as nga Lista serbe. Nisma gjithashtu, "6+"? S'është askush!

Atëherë, do ta vazhdojmë punën në ora 15:30. Faleminderit!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Kujtim Shala.

KRYESUESI: Të nderuar kolegë, e vazhdojmë seancën. Sipas radhës, fjalën e ka deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesues!

Kolegë deputetë të respektuar që vazhdoni të jeni të pranishëm në temën e debateve për një çështje, e cila jo vetëm që është sensitive, por është edhe përgjegjësi edhe për gjuhën ndonjëherë çfarë po përdorim, qoftë si deputetë, si përfaqësues të qytetarëve të vendit, të cilët duhet të jemi të përgjegjshëm para çdo veprimi, i cili e sjell të vërtetën në vend, mbi të gjitha i shëron sadopak plagët e qindra familjeve, të cilët presin çdo ditë te Zyra e Personave të Zhdukur ndonjë lajm për prindin, vëllain, apo bashkëshortin e zhdukur gjatë luftës.

Shumë herë është biseduar në këtë Kuvend për fatin e të pagjeturve të zhdukur në kohën e luftës, në raste të veçanta edhe sot të përshkruara me tmerrin e asaj lufte dhe më shumë është se sa tmerruese që edhe 19 vjet pas kemi më shumë se 1 650 persona, të cilët akoma nuk dihet për fatin e tyre. Dhe, ditët e tilla kur më shumë i ngjajnë thirrjes së vënies para përgjegjesisë, qoftë të atyre që i kanë kryer këto krime, por në pjesën tjetër që është përgjegjësi institucionale për të biseduar edhe në mënyrën e asaj që tash po ndërlidhet edhe me raportet ndërshtetërore, por me një situatë dhe me një koherencë të gjatë kohore, e cila ndërthen në vete dy elemente. E para, përgjegjësia institucionale e institucioneve tona, pa e ndarë edhe përgjegjësinë e faktorit ndërkombëtar, që ishte për vite të tëra e ndërlidhur me fatin e këtyre njerëzve, dhe pjesa tjetër që ndërlidhet me dënimin dhe vënien para përgjegjesisë të të gjithë atyre që i kanë kryer këto krime.

Edhe sot e kësaj dite, pjesa e mbetur e atyre, të cilët nuk janë gjetur dhe sot kur po bisedohet këtu dhe kur i dëgjuam, edhe ku e shikuam edhe pjesën e dokumentarit, deshëm apo s'deshëm është më shumë se sa thirrje, më shumë se sa vënie para përgjegjesisë morale dhe pjesa që ndërlidhet me përgjegjësinë ligjore.

Kujt i bie kjo përgjegjësi? Sepse, ata që kanë kryer këto krime, interesimi gjithmonë ka qenë për t'i fshehur këto krime, ndërsa ata që me vetëdije insistojnë apo mundohen për çfarëdo arsye, qoftë ajo që ta fshehin një krim të tillë, bëhen pjesë e atij krimi. Dhe, tash duke u bërë pjesë e atij krimi zbehet edhe serioziteti, zbehet edhe madhështia e vetë luftës, mbi të gjitha zbehet edhe e ardhmja, sepse është iluzion të bisedohet për normalizim të raporteve ndërshtetërore derisa nuk mbyllet çështja e të pagjeturve. Ne e dëgjuam sot njërin nga ministrat, që së paku e dha pjesën e tij deklarative, se cili është angazhimi institucional. Angazhimi institucional duket i mangët, nuk e ka guximin ta thotë fjalën e vet sipas përgjegjesisë kushtetuese dhe morale, dhe pjesa tjetër që ndërlidhet me marrjen e meritave, duke luajtur me fatin apo duke u tentuar që të tregohen moralizues në një "dhimbje", po e quaj kështu, por në prapavijë, duke fshehur interesat e tyre

deri aty ku e garojnë për shembull që në Republikën e Kosovës ka vite të tëra që nuk mund të zgjidhet drejtori i Institutit Ligjor.

Ndërsa sot ne dëgjuam që flitet për avancim të këtij instituti, por gara se kush dhe cili njeri pa meritë të vijë në krye të institutit është në logjikën e qeveritarëve.

Të nderuar kolegë deputetë,

Lufta për fatin e familjarëve të zhdukur sot duket që është brengë e kufizuar e vetëm atyre që akoma përballen me rastin e familjarëve të vet të pagjetur. Kjo çështje asnjëherë në seriozitetin e duhur nuk është shtruar në bisedimet me Bruksel, as në të kaluarën, siç duket as tash.

Ne e quajmë mungesë ose mungesë të vullnetit politik, pjesa tjetër e quan që janë të kushtëzuar që të mos bisedojnë për këto tema dhe në praktikën e të drejtave të njeriut nuk e njohin, apo nuk njihen si parim që diskriminon njërin palë, duke ia mohuar palës tjetër të drejtën për të pasur informacione për fatin e më të dashurve të tyre.

U përmendën edhe nga kolegët deputetë shumë masakra, pa dashur që të sjellim në kujtesën e tmerrshme, qoftë edhe atyre njerëzve familjarëve që na dëgjojnë, sepse po duket që po shndërrohemi në një situatë kur edhe ne po kontribuojmë vetëm me retorikë boshe, por pa arritur që ta kemi një përfitim të së vërtetës dhe përmbushje të qëllimit, që së paku familjarët t'i kenë pranë tyre edhe pak eshtra që u kanë mbetur nga krimi i bërë nga okupatori dhe pushtuesi serb i asaj kohe.

Kolegë deputetë,

Mendoj që seancat e tilla nuk duhen të përdoren dhe në njëfarë forme të shndërrohen në mbledhje komemorative. Është e vërtetë që duhet të thirremi në kujtesën tonë, të vendosim më shumë sesa ndërgjegje përgjegjësinë institucionale, por mbi të gjitha përgjegjësinë ligjore dhe si deputetë të Kuvendit të Kosovës na takon që ta respektojmë atë që edhe ne e njohim - të drejtën elementare të çdo individi pa diskriminim, dhe të kërkojmë që të dihet për fatin e të gjithë të zhdukurve, qofshin ata shqiptarë që neve na dhemb drejtpërdrejt dhe në masë të madhe, dhe qofshin ata qytetarë tjerë të Kosovës që kanë jetuar në Kosovë gjatë luftës dhe pasluftës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, ju njoftoj se të paraqitur janë edhe gjashtë kolegë, kështu që unë do të kërkoja nga drejtuesit e grupeve parlamentare që ta sigurojnë kuorumin që të mund ta votojmë në fund rezolutën e propozuesit.

Meqë nuk ka të paraqitur ndonjë deputetë të Grupit Parlamentar të PDK-së, kalojmë te Lëvizja Vetëvendosje. Fjalën e ka deputeti Sami Kurteshi.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuara e të dashura familje të personave të pagjetur dhe të zhdukur,
Kolege dhe kolegë deputetë,

Unë dëgjova shumë dhe nuk do të përpiqem që t'i iku pjesës emocionale sot, sepse ka njerëz që janë shumë më të prekur dhe kanë emocione më shumë. Unë do të përpiqem të fokusohem më shumë në aspektin ndërkombëtar dhe dokumentar të kësaj çështjeje.

Cila është gjendja e këtyre termave? Krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë janë të ngjashme me ato në Kroaci dhe në Bosnjë-Hercegovinë, e sidomos sa i përket çështjes së personave të zhdukur me forcë dhe të pagjetur. Kjo është një përvojë kriminele e kopjuar nga puçet ushtarake në Amerikën e Jugut në vitet '60 dhe '70, kur zhdukja me forcë ishte mënyra më e rëndë e frikësimit dhe përzënies nga vatrat e tyre të njerëzve që i kundërshtonin regjimet ushtarake.

Që nga viti 1992, Organizata e Kombeve të Bashkuara në Komisionin për të Drejtat e Njeriut, në komitete të ndryshme, por edhe në Asamblenë e Përgjithshme ka miratuar dhjetëra dokumente të ndryshme, rezoluta, deklarata për persona të zhdukur dhe të pagjetur kundër ish-Jugosllavisë dhe Serbisë. Dëshmitë e krimit sot janë në duart e pushtetit dhe të Qeverisë serbe, qoftë në formë gjaku, apo qoftë në formë dokumentesh. Ajo i mban këto dëshmi si leva për bisedime, në vend se të konsiderohen si fakte për fajësinë e tyre. Në këtë drejtim, Qeveria e Kosovës duhet ta radhisë si temë kryesore në bisedime me Serbinë çështjen e personave të zhdukur me forcë dhe çështjen e personave të pagjetur, shifra të cilat u përmendën këtu.

Cila është çështja e dokumenteve ndërkombëtare për Serbinë dhe ish-Jugosllavinë?

Deklarata e parë për mbrojtjen e personave nga zhdukja me forcë nga Asambleja e Përgjithshme vjen nga viti 1992 - 47/33, që kërkon nga shtetet palë të Kombeve të Bashkuara të tërhiqen dhe të mos marrin e të zhdukin me forcë persona të ndryshëm, sepse kjo është shkelje e konventave të Gjenevës për konflikte të armatosura, katër konventave, dhe protokollit shtesë 1, që ndalon zhdukjen me forcë të personave, sidomos personave civilë.

Të gjitha shtetet palë që janë nënshkruese të këtyre konventave obligohen që ta bëjnë regjistrimin, dokumentimin e të zhdukurve, t'i regjistrojnë të gjitha varrezat individuale dhe grupore dhe t'i mbrojnë ato e t'ua dorëzojnë këto të dhëna familjeve të tyre. Se cili është qëndrimi i Serbisë në lidhje me këtë çështje, prej fillimit të luftërave në ish-Jugosllavi, tregon reporteri special i Organizatës së Kombeve të Bashkuara në vitin 1997, Manfred Novak, i cili detyrohet të japë dorëheqje në Selinë e Kombeve të Bashkuara sa ishte në funksionin e reporterit special për hetimin e zhdukjes së 20 000 personave në Bosnjë-Hercegovinë dhe nja 5 000 në Kroaci. Në dokumentin që e dorëzon më 1996 ai në organizatë konstaton se më 1995 Qeveria e ish-Jugosllavisë, do të thotë e Serbisë, insistonte në mosbashkëpunim dhe ndalim të hetimit ndërkombëtar të këtyre krimeve.

Në njërën nga rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme garantohen të drejtat e familjeve për të ditur për fatin e të zhdukurve. Informimi i familjeve për fatin e të zhdukurve është obligim i qeverive. Kërkohet respektimi dhe zbatimi i të drejtës ndërkombëtare, e kjo e drejtë ndërkombëtare përfshihet në katër konventat e Gjenevës të vitit '49 dhe protokollin shtesë 1, që ka të bëjë me obligimin dhe detyrimin e shteteve për fatin e njerëzve të zhdukur me forcë dhe ata të pagjetur.

Autoritetet shtetërore janë të detyruara që t'i kenë informatat nga të gjitha hallkat e zinxhirit komandues të Ushtrisë dhe Policisë. Të dhënat për krimet ekzistojnë në Serbi. Ato duhet të nxirren dhe të verifikohen, të krahasohen me të dhënat e krimeve në Kosovë dhe zbatuesit e krimeve të dënohen. Deri atëherë, sigurisht nuk do të duhej të kishte bisedime ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Serbia është duke e bërë lojën e rrezikshme edhe me institucionet ndërkombëtare, duke krijuar gjykata speciale e prokurori speciale, duke u bërë nënshkruese e konventave, duke u bërë pjesë e komisioneve ndërkombëtare, por duke mos e respektuar asnjërin nga obligimet e marra në aspektin ndërkombëtar.

Këtu kemi edhe ndarjen e fajtorëve që bëhet në gjykatat e Serbisë. Çfarë ka ngjarë deri tash? Shumë fajtorë të drejtpërdrejtë janë liruar nga aktakuzat dhe lirimi i këtyre kriminelëve është bërë duke i madhëruar ata nga funksionarët më të lartë në Serbi. Kërkesa e Qeverisë së Kosovës me çdo kusht duhet të jetë respektimi i konventave të Gjenevës dhe protokollit shtesë 1, si dhe zbatimi i tyre për të gjithë personat e pagjetur dhe të zhdukur me forcë në territorin e Kosovës gjatë luftës. Raportimi i Serbisë, dhe ky është komenti i fundit, në Komitetin e OKB-së për të drejtat e njeriut, për të drejtat civile dhe politike në vitin 2017 ka pasur mangësi të tilla dhe këto mangësi i konstaton vetë ky komitet në raportin e vet në tetor të vitit 2017. Komiteti konstaton se:

- a) Progresi i kufizuar për gjetjen e personave të zhdukur dhe të pagjetur në Serbi është i madh;
- b) Niveli i ulët i dënimeve për krime të luftës të bëra gjatë konfliktit të armatosur, përfshirë krimet e bëra nga zyrtarët e mesëm dhe të lartë;
- c) Kërkesa që viktimat e deklaruara, të zhdukura dhe të pagjetura të deklaruar të vdekur të marrin kompensim; dhe
- d) Komiteti konstaton mungesë të resurseve për Zyrën e Prokurorit për Krime të Luftës në Serbi, mungesën e prokurorit të ri për krime lufte, si dhe presionin e madh që ushtrohet nga Qeveria e Serbisë në Zyrën e Prokurorit për Krime të Luftës.

Kjo është gjendja sot në Serbi, që nuk është e sotme, që së paku për luftërat në ish-Jugosllavi prej vitit '91 vazhdon me intensitet dhe me metodën e njëjtë. Me pushtetarët e sotëm, Vuçiq dhe

Daçiq, që kanë qenë pjesë e makinerisë vrasëse në Kosovë, por edhe në Bosnjë dhe në Kroaci, nuk mund të bisedohet për këto çështje për fatin e personave të pagjetur dhe për fatin e personave të zhdukur me forcë, derisa Qeveria e Kosovës nuk ngul këmbë që kjo të jetë një çështje e vendosur në mandatin e saj dhe të mos bëhet asnjë bisedim pa u sqaruar fati i këtyre njerëzve, sepse në fund çdo bisedë ka të bëjë me fatin e njerëzve dhe me njeriun. Të gjitha çështjet tjera janë çështje të dorës së dytë dhe të tretë.

Kjo nuk është duke ngjarë. Kosova i ka të gjitha adutet, Qeveria e Kosovës i ka të gjitha adutet në dorë, e sidomos kërkesën për respektimin dhe zbatimin e dokumenteve ndërkombëtare, rezolutave të Asamblesë së Përgjithshme, rezolutave të organeve të ndryshme të OKB-së, e sidomos të konventave të Gjenevës dhe të protokollit shtesë numër 1, që i obligon shtetet të ofrojnë informata për familjarët e personave të zhdukur me forcë dhe të pagjetur. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas radhës, fjalën e ka deputeti Fidan Rekalju.

FIDAN REKALJU: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Si deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës e vlerësoj si mjaft të qëlluar iniciativën e dy kolegëve që e kanë iniciuar thirrjen e kësaj seance për njërën nga plagët ende të pashëruara të luftës së fundit.

Kuvendit të Republikës së Kosovës si institucioni më legjitim dhe më i lartë përfaqësues i popullit dhe i shtetit të Kosovës i takon të merret seriozisht, por edhe të marrë qëndrim të qartë dhe të vendosur për çështjen e të pagjeturve në vend. Ashtu siç duhet të jemi të qartë, të drejtë dhe parimor, kur e shprehim mirënjohjen e thellë për ndihmën vendimtare që miqtë tanë ndërkombëtarë i kanë dhënë vendit, po kaq të drejtë dhe parimorë duhet të jemi kur duhet t'i kritikojmë ata.

Nëse ka një rast kur organizmave ndërkombëtare duhet t'u themi se ne s'jemi të kënaqur me qasjen tuaj, atëherë ky është fenomeni me të pagjeturit. Ata kanë mundur dhe mund ta detyrojnë Serbinë që ta zgjidhë këtë çështje. Institucionet përfaqësuese të Republikës së Kosovës, më saktë bartësit e tyre, sot nuk duhet të ndihen mirë. Edhe ata kanë mundur të bëjnë më shumë për ta shtyrë shtetin e Serbisë që ta marrë përgjegjësinë e vet. Nuk ka vlerë, as parim, as politikë e as pragmatizëm, që mund të justifikojë heshtjen përballë fshehjes së krimeve.

Siç dihet botërisht, fshehja e krimit është krim në vetvete. Familjet kosovare pa dallim, qytetarët dhe vetë shteti i Kosovës, kanë të drejtë të kërkojnë në çdo moment zgjidhjen e kësaj plage që vijon e pambyllur tash gati e 19 vjet.

Fqinjësia e mirë, ndërtimi i marrëdhënieve dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve me rrugë paqësore janë attribute themelore të shteteve perëndimore demokratike, për të cilat Kosova i ka pranuar dhe synon që t'i avancojë ato. Megjithatë, asnjë lloj pajtimi historik i fqinjësisë së mirë apo normalizim marrëdhëniesh nuk mund të jetë i qëndrueshëm me një problem apo plagë kaq të rëndë, që qëndron ndërmjet dy shteteve tona.

Ka një moment kur diplomacia, politika dhe pragmatizmi duhet të heshtin. Ato janë faktet dhe rrethanat që për bosht e kanë vlerën më të lartë të njerëzimit, e që në këtë rast është raporti i palëve në jetën e njeriut. Rrjedhimisht, përfundimi më i qartë logjik dhe i rastit si ky do të ishte që të aplikoheshin parimet themelore evropiane, respektimi i të drejtave dhe dinjitetit njerëzor dhe cilado përpjekje për fillimin e normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do të duhej të niste me zgjidhjen e këtij problemi kaq të rëndë, siç janë të pagjeturit.

Në funksion të arritjes së qëllimeve nga të gjitha palët, përfshirë edhe bashkësinë ndërkombëtare, e vlerësoj se duhet të kërkohet me vendosmëri që vijimi i procesit të normalizimit të marrëveshjes ndërmjet Serbisë të përfshijë në radhë të parë zgjidhjen e problemit me të pagjeturit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Xhevahire Izmaçu.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, nënkryetar!

Përsëritje për kolegët deputetë,

Për qytetarët që janë duke na përcjellë në një seancë që është më e ndjeshme se të gjitha seancat tjera, veçanërisht përsëritje për dy deputetët tanë, Andinin dhe Sarandën, të cilët e dhanë një shembull dhe i tejkaluan interesat partiake, duke vënë qëllimin kryesor, domethënë që të diskutohet për një temë, e cila është jashtëzakonisht e ndjeshme dhe që na shqetëson të gjithëve.

Ka tri mandate, kur radhazi në këtë datë kemi diskutuar, qoftë në prill, qoftë në maj, kur vjen momenti prej marsit, periudha në të cilën i kujtojmë të rënë dhe kryesisht masakrat më të mëdha që janë bërë në vend. Kemi pasur diskutime, qoftë jashtë rendit të ditës, qoftë nëpër seanca, mirëpo sot është diçka më e veçantë, sepse nismëtarët e kësaj janë dy deputetë tanë, të cilët të dy janë viktima, të dy kanë familjarë të zhdukur, por sigurisht se edhe vetë janë pjesë e atyre masakrave, siç është edhe e mbijetuara, kolegja jonë Saranda.

I lexova të gjitha fjalimet që i kisha thënë me radhë për çdo vit. Domethënë, fjalimet janë të njëjta dhe asnjë ndryshim nuk ka ndodhur. Çka u befasoja sot, sepse fjalimin do ta kem shumë të shkurtër, meqenëse është konsumuar dhe i kam dëgjuar kolegët deputetë, i kanë përfshirë gati të gjitha, është interesant interesimi i paktë i zyrave ndërkombëtare dhe i ambasadave, me përjashtim të Ambasadës Amerikane, prej mëngjesit i kam përcjellë, e kam parë që të tjerët shumë pak kanë qenë të interesuar.

E kujtova seancën e Gjykatës Speciale dhe seancën e demarkacionit. Sinqerisht, po të përkushtoheshin vetëm 20% të angazhimit që e kanë pasur për të marrë pjesë në votimin dhe për të sugjeruar votimet tona se si të votojmë në ato drejtime, po të drejtohej e koncentrohej krejt ajo forcë në përpjekjen për t'i bindur edhe organizmat tjerë, edhe shtetet e tyre për t'i bërë presion Serbisë, ma merr mendja se sot do të ishim në krejt tjetër situatë.

Po flas dhe po koncentrohem pak në komunën time. Është komuna e Vushtrrisë, ku ndër masakrat tjera janë dy që do të kujtohen, njëra është me 2 maj, kur janë vrarë mbi 120 persona, të gjithë kanë qenë civilë, gra, fëmijë, pleq, të rinj dhe asnjë i armatosur. Pastaj, është ngjarja e 22 majit, e cila kryesisht lidhet me ngjarjen e sotme, pra kanë qenë viktimat dhe të rinj që janë marrë fjetur në shtëpi, është gati ngjarje e njëjtë me Gjakovën dhe deri në vitin 2015 nuk është ditur për fatin e tyre. Prej tyre, prej 66-ve, sot vetëm një është i zhdukur, është një grua, kufoma e së cilës ende nuk dihet se ku është, dhe 65 të tjerë janë varrosur deri në vitin 2015. Ngjarja më e rëndë e cila e ka përthekuar, pra viktimat të cilat janë marrë në shtëpi dhe janë dërguar në shtëpinë e të ndjerit Kahriman Pasomës, ku janë masakruar. Po e përfshij këtë temë edhe një herë, meqenëse është e ndjeshme edhe për familjarët që më dëgjojnë tash, meqenëse pas luftës kemi qenë të angazhuar me Këshillin për Lirinë dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, dhe fatkeqësisht emrat e atyre që kanë marrë pjesë në masakër i kemi dhënë, ka vite që i kemi dërguar në EULEX. Është e çuditshme, asnjë nuk është dënuar. Ka disa prej tyre që e dimë se jetojnë në Beograd, edhe me emra i kemi thënë. Pra, sot është momenti edhe një herë të theksohet, ne e dëshirojmë, e çmujmë partneritetin dhe nuk do ta harrojmë kurrë, jemi mirënjohës tërë jetën për ndihmën që na është dhënë si popull në çlirim e në pavarësim. Por, sigurisht që s'do t'i harrojmë që edhe përkushtimi drejt gjetjes së fajtorëve dhe zbulimit të këtyre personave, ka qenë shumë i paktë, apo të them shumë racional.

Duke bashkëndjerë dhimbjen që sot kanë të gjithë ata qytetarë që kanë familjarë të zhdukur, më lejoni të theksoj që nisma të tilla sigurisht se na krijojnë dhimbje, na i kthejnë dhimbjet, mirëpo ka nevojë që të përsëriten deri në momentin kur ne do ta dimë deri në kufomën e fundit, deri në të zhdukurin e fundit, se ku do të jenë. Po ashtu, më lejoni të theksoj se unë bashkëndiej me të gjithë civilët e pafajshëm, të cilët janë zhdukur edhe të komuniteteve tjera në vendin tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Drita Millaku.

DRITA MILLAKU: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar qytetarë,

Familjarë të të pagjeturve,

Të nderuar kolegë deputetë,

Përfundimi i luftës e gjeti Kosovën me dhjetëra e mijëra shqiptarë të vrarë, të plagosur e të dhunuar. Numri i tyre, pos që u vranë, madje edhe kufomat e tyre u zhdukën, plagë e cila

shoqëron edhe sot një numër të konsiderueshëm familjesh. Edhe pas 19 vjetësh të përfundimit të luftës, në vendin tonë ende janë të zhdukur 1 652 persona.

Pavarësisht faktit se nga Parlamenti i Kosovës u nxorën rezoluta për të zhdukurit, u propagandua se Kosova do ta padisë Serbinë për gjenocid, në fakt këto dhe të ngjashme si këto asnjëherë nuk ndodhën. Mbetën në kujtesën tonë kolektive vetëm si marketing politik të pushtetarëve për konsum të brendshëm dhe asgjë më shumë, sepse asgjë nuk u bë në këtë drejtim.

Para çdo rundi të negociatave me Serbinë pala kosovare deklaronte me patetizëm se të zhdukurit pa dyshim do të jenë çelës për fillimin e negociatave me palën serbe, por gjatë procesit të tillë kjo çështje nuk përmendej, ose përmendej vetëm si çështje periferike.

Madje edhe rezoluta e Parlamentit të Kosovës, e cila në mënyrë decisive e kushtëzonte vazhdimin e negociatave me Serbinë, me çështjen e të zhdukurve u injorua plotësisht nga Qeveria e atëhershme. Prandaj, të zhdukurit pothuajse janë njëra nga kategoritë më të keqpërdorura nga pushtetet e pasluftës. Klasa politike me përjashtim kur i shërbente për marketing politik, asnjëherë nuk e mori seriozisht çështjen e zgjidhjes së kësaj problematike, respektivisht nuk u mor me krimet serbe ndaj shqiptarëve, sepse brengë kryesore kishin diçka tjetër, pasurimin e tyre.

Motoja nga e cila udhëhiqeshin ishte “kushdo le të bëjë çka të dojë” mjaftonte që këta të liheshin rehat në hallin e tyre, pra në pasurimin marramendës. Kur e merrnin ndonjë pickim nga ndërkombëtarët, atëherë të tillët politikanë dëgjoheshin duke kërcënuar, “do të ngremë padi për gjenocid”, e në fakt nënkuptonte porosinë “na lini rehat, sepse ne nuk jemi duke ju trazuar për të zhdukurit dhe krimet serbe në Kosovë”. Opinioni në Kosovë ishte përballur me disa iniciativa, sikur i ashtuquajtur Komisioni për të Vërtetën dhe Pajtimin, që më shumë ngjason në eksperimente që krijon huti e revoltë te familjarët, sesa që i shërben zgjidhjes së këtij problemi.

Çfarë joserioziteti është treguar ndaj kësaj çështjeje, kjo më së miri mund të ilustruhet edhe nëpërmjet rastit të profesor Ukshin Hotit, siç e thanë edhe parafolësit e mi. Me vite të tëra delegacioni i Kosovës është takuar me Ivica Daçiçin, pra me njeriun që ishte dora e djathtë e Millosheviqit, porse çuditërisht asnjëherë opinioni nuk u njoftua se ky rast u ngre në këto takime.

Edhe pse Ukshin Hoti ishte brenda institucioneve, pra Burgut të Dubravës, për asnjë dyshim prej Daçiçit nuk patën një seriozitet se ku ishte ky njeri, ku u largua ky njeri dhe që nga ai moment asnjëherë nuk u duk më. Ai do të kishte njohuri, sepse jo vetëm Ukshin Hoti, por edhe shumë të tjerë, por asnjëherë nuk u bëri përshtypje autoriteteve të Kosovës. Prandaj, institucioneve të Kosovës në vend se t’i shërbenin si model sesi ato angazhohen për fatin e qytetarëve të saj të zhdukur, ato e dhanë shembullin e kundërt. Procesi i gjetjes së të zhdukur do t’i ndihmonte në masë të madhe arrestimi i autorëve, të cilët i zhdukën këta persona.

Në këtë kontekst, është pritur që autoritetet tona të drejtësisë ta përgatitnin terrenin për një gjë të tillë, porse për çudi organet përkatëse nuk e panë të arsyeshme të angazhojnë ekupe profesionistësh, të cilat drejtpërdrejt në terren do t'i evitonin të gjitha krimet serbe në Kosovë, e në bazë të këtyre provave ata edhe do t'i nxirrnin përpara drejtësisë të dyshuarit për krime lufte dhe me këtë do t'i ndihmohej çështjes së të zhdukurve.

Ato mjaftoheshin duke e përsëritur klisenë e njohur, “ne nuk kemi kompetenca për t'i proceduar këto lëndë”, edhe pse asnjë ligj nuk ua ndalonte të mblidhnin dhe t'i arkivonin këto prova, të cilat më vonë do të procedoheshin. Me kalimin e viteve, ky mosinteresim ka pasur si pasojë zbehjen e dëshmimeve dhe vdekjen e dëshmitarëve. Prandaj, jorastësisht këtë mosinteresim të institucioneve tona e ka shfrytëzuar maksimalisht Serbia, duke e krijuar opinionin se viktimat e vërteta janë serbët, e jo shqiptarët.

Në kontekst të ruajtjes së dëshmimeve, e të cilat do të ndihmonin të sqaroheshin edhe fati i personave të zhdukur, shoqatat e familjarë kanë përgatitur vetë monografi, përmbajtja e të cilave mund të shfrytëzohet si material akuzues për ata që i kanë të zhdukur në këtë masë të madhe njerëzish.

Monografi të tilla, pos tjerash, do të jenë edhe akuzë e hapur publike ndaj të gjithë atyre që janë të thirrur t'i evidentojnë dhe procedojnë krimet serbe në vendin tonë. Është akuzë ndaj tyre, të cilët sa herë kanë nevojë për marketing politik thonë se do ta paditin Serbinë për gjenocid dhe pos tendencës për të manipuluar me opinionin, nuk ndërmarrin asgjë në këtë drejtim.

Derisa ndërkombëtarët menjëherë pas luftës ishte evidente të udhëhiqen nga motoja, sipas së cilës hulumtimi mbi krimet serbe në Kosovë duhej të shtyhej sa më gjatë që të ishte e mundur, dhe kjo vetëm për disa arsye. Nëse krimi serb do të hulumtohej me kohë me tërë dimensionin e tij, domethënë do të merreshin në konsideratë të gjithë ata të cilët kanë qenë të përfshirë në këto krime dhe me këtë do t'i ndihmohej ndriçimit të fatit të të zhdukurve, atëherë do të dështonte projekti i bashkësisë ndërkombëtare për kthimin e serbëve në Kosovë. Duke i shtyrë sa më gjatë këto hulumtime, me kalimin e viteve do të vdesin një numër i madh i dëshmitarëve. Me kalimin e viteve do të zbeheshin po ashtu dëshmitë e dëshmitarëve dhe këto dëshmi pastaj do të bëheshin të pavlefshme.

Këtë sjellje të ndërkombëtarëve e kishin kuptuar me kohë vendorët. Prandaj, veprimi sipas logjikës së ndërkombëtarëve, respektivisht moshulumtimi i krimeve serbe do t'u sillte favore të ndryshme.

Për ta ishte me rëndësi të jenë sa më të pëlqyeshëm për ndërkombëtarët, pra, sa më servilë ndaj tyre, sepse kjo u ndihmonte në krijimin e privilegjeve të tyre.

Veprime të tilla, të cilat në njërin apo në anën tjetër i fyejnë dhe i lëndojnë viktimat, natyrisht janë të gjykuara të dështojnë, mirëpo aktorët e këtyre lojërave do të mbesin në kujtesë si persona, të cilët jo rrallë herë vepruan në kundërshtim me vullnetin e familjarëve dhe jo rrallë herë i torturuan shpirtërisht përmes veprimeve të tilla të ulëta.

Rastin konkret e kemi në fshatin Krushë e Vogël të komunës së Prizrenit, ku janë të vrarë 113 qytetarë, prej tyre vetëm 45 janë të identifikuar, ndërsa 68 janë ende të zhdukur.

Para një viti kriminel i cili i bëri këto krime, Darko Tosiq, lirshëm vinte nëpër komunën e Prizrenit dhe nëpër këto fshatra ku bëri masakër.

Me insistimin e fshatarëve të këtyre fshatrave, ai u arrestua vitin e kaluar dhe tash para dy ditësh, derisa ne e kishim paralajmëruar që do të kishim një seancë të jashtëzakonshme për këtë çështje, filluan hetimet ndaj tij, domethënë ja se çfarë është duke punuar kjo Qeveri dhe si i ka mundësitë të punojë më shumë konkretisht për këtë çështje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Daut Haradinaj e ka fjalën.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryesues!

Nuk dua ta zgjas, mendoj se të gjithë deputetët pajtohemi që është temë shumë e ndjeshme.

Megjithatë ne i dimë edhe kapacitetet e Kosovës, e dimë edhe qysh jemi çliruar, me çfarë mbështetjeje jemi çliruar, e dimë kush ka bërë agresion këtu, kush ka vrarë, kush ka zhdukur dhe natyrisht ne i kemi të drejtat, do të kërkojmë drejtësi përjetësisht, pavarësisht diskriminimeve.

Nuk pajtohem që ne ia kemi marrë Kosovën ose Jerusalemin, siç thanë, Serbisë, sepse kjo ka qenë jona, kështu të paktën më kanë mësuar kur kam qenë i vogël, po ne veç e kemi rikthyer aty ku ka qenë dhe shpresoj që në të ardhmen të bashkohem në Evropë edhe me Shqipërinë, pse jo.

Por, kisha pasur dëshirë që në fund të këtij debati, të paktën ata deputetë që diskutuan deri tash, të jenë në sallë, sepse duhet votuar, jemi tre diskutues pas meje, të vijmë të votojmë, sepse do të dalim qesharakë që gjithë këta lot krokodili që i nxorën, e në fund të mos ketë kuorum të votojmë një rezolutë është marre, është marre të paktën për djalin e Ukshin Hotit, për zonjën Bogujevci, e cila edhe fizikisht i ka përjetuar këto plagë.

Në fund të asaj rezolute kisha kërkuar konkretisht prej atyre harmonizuesve që ta riamendamentojnë ligjin, për shkak se familjet e të zhdukurve kanë probleme edhe sociale, financiare.

Unë i kuptoj që ata nuk pajtohen që, për shembull, ata mund të jenë të vrarë ose ku ta di unë çfarë statusi do ta kenë.

Por, të paktën, institucionet e Kosovës t'i trajtojnë në mënyrë meritore, të mos kenë edhe një plagë shtesë ekzistencën ekonomike, sepse po flasim pas 19 vjetëve. Për çdo 27 prill ne do t'i nderojmë, por ne duhet të mendojmë për çdo ditë, sa herë të sillemi nëpër Kosovë, ata meritojnë respekt.

Kemi raste të panumërta në tërë territorin e Kosovës kudo që sillesh, kemi varre, qofshin ushtarë të UÇK-së, që askush s'po i përmend, edhe ata janë njerëz të Kosovës, edhe ata e meritojnë një respekt, qofshin njerëz që janë zhdukur. Duhet bërë me gisht, e mos e bëni përgjegjëse Qeverinë e Kosovës se nuk i ka vrarë Qeveria e Kosovës, po e dini shumë mirë, përmendni, thoni regjimi i Milosheviqit, të paktën cekni.

Ju e dinë sa ka kapacitet Kosova, e vetmja mundësi është presioni në Bruksel që të kërkohej përgjegjësi mbi institucionet e Serbisë. Me këtë mendoj edhe bashkërisht si kolegë në fund duhet ta ndajmë edhe këtë që ta ushtrojmë presionin pikërisht mbi atë adresë.

Ne kemi pasur Tribunalin Ndërkombëtar të ish-Jugosllavisë, i ka bërë disa gjykime periferike, kisha thënë, po asnjëherë nuk janë marrë me raste konkrete, të cilat kanë ndodhur në Kosovë.

Ne kemi pasur 27 raste të gjykimeve të ish-pjesëtarëve të UÇK-së në Kosovë nga UNMIK-u, nga EULEX-si, nga institucionet lokale, tash e kemi edhe një sihariq, Gjykatën Speciale, etnike, dhe ne prapë, edhe këtu ku jemi, në emër të opozitës gjuajmë gur në institucionet tona. Ktheni gishtin aty ku është përgjegjësia, është e vërtetë që duhet shtrënguar Qeverinë, ekzekutivin, të kërkojë përgjegjësi, të nxjerrë kushte në dialog me Serbinë, të diskutohet në Bruksel çështja e të zhdukurve, të gjithë jemi dakord, dhe nuk duhet ndalur deri në fund deri sa të zbardhet edhe qytetar i fundit, pavarësisht etnie, qytetarët e Kosovës meritojnë, të paktën ata të zhdukurit e meritojnë drejtësinë. Por të mos e përdorim këtu si arenë politike dhe po ju siguroj që sivjet nuk ka zgjedhje, hiç mos i jepni zor, po më mirë vendosni lule për ditë të ato varrezat e të zhdukurve dhe të masakruarve, më falni, se jo të zhdukurve.

Po, fundi i fundi jemi njerëz, duhet t'i kuptojmë e të mos i lëndojmë edhe më shumë plagët e familjeve, të cilat tash e 19 vjet i kërkojnë më të afërmit e tyre.

Bëj edhe një herë apel publik, deputetë, kthehuni në sallë për votim, se i kemi edhe tre diskutues. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Nait Hasani.

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

Është një ngjarje mjaft e ndjeshme kur përkujtohen ose debatohet për të zhdukurit dhe ajo që më ngjalli më shumë një ndjenë ishte dokumentari që u shfaq, sidomos te pjesa e Tribunalit të Hagës.

Asnjë koment nuk duhet ta kemi, asnjë dëshmi më shumë e as më pak, përveç se të dëshmojmë, siç dëshmuar ata në Tribunal serbët për krimet që kanë bërë dhe bartjen e kufomave, zhdukjen e kufomave nëpër Serbi.

Për ne që kemi qenë pjesë edhe të masakrës në Burgun e Dubravës dhe që e njohim atë dhe e kemi përjetuar ku janë vrarë 128 të burgosur dhe janë zhdukur, edhe të burgosurit e vrarë i kanë zhdukur, i kanë bartur, i kanë transportuar dhe nuk gjenden, ndër ta është edhe Ukshin Hoti.

Po për mua është me rëndësi që ne kemi debatuar shumë herë këtu në Kuvend edhe për Ukshinin, edhe për masakrat, edhe për Burgun e Dubravës, kemi nxjerrë edhe rekomandime e rekomandime, po asnjëherë nuk ka dalë një rezultat çfarë është kërkuar. Kërkohet ndikimi i Qeverisë në Bruksel, të detyrohet Serbia të japë të dhënat ku janë të zhdukurit, ku është Ukshin Hoti, ku janë ato masakrat që i ka bërë dhe nuk dihen ku janë.

Për neve me rëndësi është që ta ndajmë dhembjen me të pagjeturit, me familjet e tyre, por ky Kuvend gjërat duhet t'i trajtojë me seriozitet dhe me këmbëngulje të kërkojë zgjidhjen e kësaj çështjeje. Kjo çështje ndoshta nuk do të zgjidhet asnjëherë, po ato që i shohim ne, shpresojmë, besojmë që ka mundësi Qeveria të kërkojë, bashkë me këtë në fushën e dialogut në Bruksel, të detyrohen të na tregojnë ku janë.

1 560 të zhdukur nuk duhet të krahasohen me të zhdukurit apo ata që kanë qenë dhe që kanë bërë krime, nuk duhet të krahasohen me ata që kanë bërë krime, me policë dhe ushtarë serbë. Ata kanë ardhur, kanë vrarë dhe kanë kidnapuar dhe i kanë zhdukur, tani ata mund t'i kërkojnë eshtrat e tyre nëpër skuta, nëpër thera, ku kanë mbetur, po megjithatë, viktimat shqiptare, pleq, gra dhe, siç përmendet, edhe fëmijë, kjo është e tmerrshme çka ka ndodhur.

Për neve jo një rekomandim, jo 10, të gjitha ato çka duhet, duhet të detyrohet Serbia të japë gjendjen ku janë ata. Prandaj, për të kërkuar dhe për dëshmuar atë, kërkohet që edhe dialogu të jetë pjesë e një mundësie të tillë.

Nëse Qeveria me këto rekomandime që do të miratohen sot, do të ketë mundësi të hyjë në pjesën e dialogut në Bruksel, kjo do të jetë një gjë e mirë, e mirëseardhur, të paktën shpresëdhënëse për të pagjeturit e familjeve të tyre.

Prandaj, faleminderit edhe një herë, jemi t'i miratojmë këto rekomandime dhe ta mundësojmë një zgjidhje më të mirë të kësaj çështjeje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka sipas radhës deputetja Arbërie Nagavci.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar familjarë të personave të pagjetur,
Familjarë të viktimave e dëshmorëve të luftës,
Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Kjo seancë e ftuar me iniciativën e Saranda Bogujevcit dhe Andin Hotit e tregon më së miri dështimin e institucioneve tona që të adresojnë në mënyrën e duhur çështjen e të pagjeturve, dështimin që edhe nëntëmbëdhjetë vjet pas luftës i kanë karshi 1652 familje që çdo ditë përballen me ankthin dhe dhimbjen për më të dashurit e tyre.

Ashtu si e përmendi dhe Saranda, përderisa ne po diskutojmë këtu, Gjykata e Lartë e Beogradit dy ditë më parë e liroi nga burgu para kohe kriminelin Sasha Cvjetan, personin i cili vrau 14 civilë shqiptarë, nga ta 7 fëmijë dhe, në anën tjetër, shumë kriminelë që kryen masakra nuk u dënuan asnjëherë.

Ashtu si e pamë në dokumentarin që u shfaq këtu, me moton "Kur nuk ka kufoma, nuk ka viktima", Serbia pretendon të mbulojë gjenocidin që bëri në Kosovë dhe familje të tëra vazhdojnë të përballen jo vetëm me dhimbjen për humbjen e më të dashurve, por edhe me ato të mosinformimit për fatin e tyre.

Pranvera, edhe sivjet, sikurse çdo gjithë këto vite, vazhdon të vijë me kujtime të trishta në Kosovë, me dhimbje e mall, me krenari e mllef.

Secili nga ne ndjen një peshë të rëndë në zemër, secili nga ne kemi së paku një familjar, një mik, një shoqe, një nxënës për të cilin ndjejmë mall e dhimbje, kujtojmë humbjen e tyre dhe presim një lajm për të mësuar për ata që akoma janë të zhdukur.

Secili nga ne njohim familje të tëra që nuk dinë për fatin e më të dashurve të tyre.

Dhe, sot ne kërkojmë drejtësi për të gjitha viktimat civile të luftës, për secilin qytetar të Republikës së Kosovës, por të vetëdijshëm se asnjëherë aparati shtetëror, gjenocidi i planifikuar që ka bërë shteti serb në asnjë moment dhe në asnjë rast nuk mund të barazohet e as të krahasohet me ndonjë raste individual që mund të ketë ndodhur për motive të ndryshme.

Fragmentet e dokumentarit që i pamë sot nga gjykimi në Tribunalin e Hagës e vërtetojnë se zhdukja e kufomave të civilëve shqiptarë ka qenë e planifikuar dhe e organizuar nga institucionet më të larta shtetërore.

Unë nuk kam si të mos kujtoj qytetin tim të lindjes, në Gjakovë kjo dhimbje shumëfishohet e të ngufatë, si qyteti më i dëmtuar gjatë luftës, sipas të dhënave të Fondit për të Drejtën Humanitare, me më së shumti humbje në njerëz. 1022 civilë shqiptarë dhe 361 ushtarë të UÇK-së janë vrarë gjatë luftës së fundit në komunën e Gjakovës.

E pamë në dokumentar nënën Ferdonie, i pamë nënat, gratë e motrat gjakovare që i kanë kujtimet për më të dashurit e tyre dhe një kërkesë të vetme: të dinë se ku janë ata.

Shoqja ime, Tringa Vejsa, ishte vetëm tridhjetëvjeçare kur u ekzekutua dhe u dogj bashkë me pesë fëmijët e saj, civilë shqiptarë, fëmijë nga 2 deri në 70 vjeç, njëzet martirë u ekzekutuan vetëm në familjen Vejsa në natën e dy prillit 1999.

Sigurisht se keni dëgjuar rrëfimin e Dren Cakës, i mbijetuari i vetëm në këtë masakër. Në atë kohë Dreni ishte 10-vjeçar dhe kujton se kur u largua nga shtëpia që paramilitarët i kishin vënë flakën, pasi i ekzekutuan të gjithë të pranishmit, motra e tij më e vogël ishte akoma gjallë, por Dreni, i cili shpëtoi, nuk mund ta ndihmonte dot, nuk mund ta merrte me vete se ishte dhe vetë i plagosur.

Familjet Qerkezi e Vejsa janë vetëm dy familje nga shumë familjet në Kosovë që përjetuan tmerret më të rënda gjatë viteve 1998-99. Nuk mund t'i përmend me emra, sepse janë shumë, familje që panë tmerrin me sy, familje ku paramilitarët serbë u hynë në shtëpitë e tyre, i kidnapuan ose i ekzekutuan para syve të më të dashurve të tyre.

Sot në Mejë të Gjakovës janë shënuar aktivitete për të përkujtuar masakrën që ndodhi aty, u ekzekutuan të gjithë meshkujt nga mosha 15 deri 60 vjeç, 377 meshkuj shqiptarë.

Pothuajse secilën ditë të muajve të pranverës, në Gjakovë ka aktivitete përkujtuuese.

Familjet e qytetarët shkojnë tek njëri-tjetri, ata nuk flasin shumë, sepse e kuptojnë pa fjalë njëri-tjetrin, i kanë dhimbjet e njëjta, i kanë plagët e hapura dhe ëndrrat e këputura në gjysmë.

S'ka familje në Gjakovë që nuk përballen me këto dhimbje, që nuk kanë historinë e tyre të trishtë e të dhembshme për ta treguar. Dhe sikur në Gjakovë, masakrat e vrasjet e civilëve kanë ndodhur gjithandej në Kosovë. Qytetarë civilë, vajza, djem, gra e burra akoma të pagjetur. Familjet, pos dhimbjes që e kanë, përballen nga ankthi i përditshëm për mosinformimin e tyre.

Janë familje të tëra, lagje, fshatra e qytete që kanë të drejtë të dinë për fatin e më të dashurve të tyre.

Çështja e të pagjeturve përfundimisht duhet të trajtohet me gjithë seriozitetin, profesionalizmin, vëmendjen dhe këmbënguljen që meriton. Ajo duhet të jetë temë bisedimi në secilën tavolinë bisedimesh dhe jo vetëm kaq, ajo duhet të jetë parakusht për çdo marrëveshje të ardhshme me Serbinë.

Serbisë duhet t'i përsëritet çdo ditë e çdo herë e vërteta se ata kanë kryer krime, kanë vrarë civilë, gra e fëmijë, kanë vrarë foshnjë e pleq, kanë bërë gjenocid. Ata duhet të mbajnë përgjegjësi për veprimet e tyre. Duhet të kërkojnë falje dhe duhet të dënojnë kriminelët.

Pa ndodhur kjo, s'mund të arrihet paqja në mes të dy vendeve.

Unë besoj se qytetarët e Kosovës janë paqësorë e të gatshëm për të ecur përpara, por për këtë duhet bërë hapi i parë nga Serbia. Krimi duhet të ndëshkohet. E qeveritarët tanë dhe secili nga ne duhet jo vetëm ta kërkojnë këtë, por të insistojmë para çdo bisede apo marrëveshje me Serbinë.

Familjarët dhe secili nga ne kemi të drejtë të dimë për fatin e secilit person të zhdukur në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Fadil Beka.

FADIL BEKA: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar familjarë të pagjeturve,

Të nderuar kolegë deputetë,

Fillimisht i përgëzoj iniciuesit e këtij debati, në këtë datë të shënuar dhe të dhembshme të historisë së re të Kosovës.

Në luftën e fundit në Kosovë '98-'99 Serbia okupuese përdori të gjitha mekanizmat e shtetit për ta realizuar konceptin e tokës së djegur kundër Kosovës.

Ne jemi dëshmitarë që nuk ka fshat, nuk ka lagje në Kosovë që nuk ka të vrarë civilë e të masakruar, përfshirë këtu të gjitha moshat, fëmijë, gra, pleq, burra, gra shtatzëna si dhe nga të gjitha profesionet, duke shkelur të gjitha konventat ndërkombëtare dhe ligjet e luftës.

Shteti serb nuk kurseu as personelin shëndetësor që ishte në ndihmë të të plagosurve e të sëmurëve gjatë luftës, kidnapoi mjekë, i vrau dhe i masakroi.

Këtyre ditëve është botuar një libër nga kolegu ynë i nderuar, zoti Sali Krasniqi, që argumenton keqtrajtimet e pacientëve dhe gjenocidin që ka bërë personeli shëndetësor që ka punuar nëpër spitalet e Kosovës, duke shkelur edhe betimin e Hipokritit që është parim i punës së çdo mjeku.

Po citoj: “Në kryerjen e obligimeve ndaj të sëmurit nuk do të ndikoj në mua përkatësia e tij fetare, kombëtare, raciale, politike apo e klasës. Nën kurrfarë detyrimi nuk do të lejoj që dituria ime medicinale të shfrytëzohet në kundërshtim me ligjet e humanizmit”, mbyllet citati.

Kjo dëshmon se personeli shëndetësor serb që punoi në spitalet e Kosovës nuk iu përmbajt këtij betimi dhe ishte në funksion të mekanizmit shtetëror të Serbisë kundër shqiptarëve.

Ne jemi të gjithë të vetëdijshëm se familjarët kërkojnë zgjidhje të kësaj çështjeje. Zgjidhja e dimë që nuk është e lehtë, ky debat dhe kjo rezolutë do t'i kontribuojnë zgjidhjes së kësaj çështjeje. Por, edhe ne, edhe familjarët e dimë që ne nuk mund ta kushtëzojmë Serbinë, besa as faktori ndërkombëtar nuk ka gatishmëri në këtë kohë ta detyrojë Serbinë për zgjidhjen e kësaj çështjeje kaq të ndjeshme për ne.

Secili e kemi obligim të kontribuojmë në zgjidhjen e kësaj çështjeje, por konsideroj që varianti i mundshëm mbetet prapë dialogu. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radhën e ka deputeti Shemsi Syla.

SHEMSI SYLA: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të dashur familjarë të të pagjeturve,

Po bëhen 20 vjet që ju po përballeni me dhembjen dhe ankthin e vazhdueshëm për të afërmit tuaj që u rrëmbyen nga forcat serbe për të mos u kthyer më.

Shumë nga të zhdukurit u gjetën dhe u kthyen në arkivole nga pjesët e ndryshme të Serbisë, por kjo plagë edhe sot e kësaj dite po rëndon mbi ju që rrëshqet së kërkuari dhe që nuk pranë kurrë për të vërtetën për të dashurit tuaj, por fatkeqësisht thirrjet tuaja kanë hasur në vesh të shurdhur.

Edhe pse në kuadër të dialogut me Serbinë kjo çështje u ngrit, si duket vetëm për të mos thënë se nuk u interesuan, mjerisht asnjëherë nuk u kushtëzua Serbia për të dhënë informacione se ku u tretën gjithë ata qytetarë të Kosovës që u morën në vatrën e tyre?

Si mund të ndihet Qeveria, e sidomos presidenti, meqë po tenton me çdo kusht të udhëheqë dialogun me Serbinë, kur nuk kujtohet që të paktën të bëjë një pyetje se ku mbeti doktori dhe

humanisti i njohur, Hafir Shala? Ku mbeti veprimtari i dalluar i historisë më të re, Xhavit Haziri e shumë e shumë të tjerë?

Si nuk i kujtohet të shtrojë një pyetje se ku mbeti i madhi Ukshin Hoti, i cili u zhduk sikur ta kishte lëshuar toka?

Qeveria dhe institucionet e vendit duhet të sillen më me përgjegjësi dhe të kushtëzojnë Serbinë, sepse nuk po bëhet fjalë për qytetarë nga ndonjë planet tjetër.

Historinë e dhimbshme mund ta rikujtojmë, ajo nuk është shumë e largët, vrasjet, terrori, ndjekjet, me një fjalë gjenocidi serb ndaj shqiptarëve në periudha të ndryshme që nga viti 1878, e sidomos 1912-13 dhe fshehja e kësaj të vërtete u bë me metodat më perfide, faktet flasin se 500 mijë shqiptarë ishin vrarë e masakruar në ekspeditat serbe gjatë viteve 1912-1913, që kurrë nuk dihet për varret e tyre, e që shtetet evropiane dhe opinioni i gjerë evropian ishin në dijeni të plotë, e që mendoj se historikisht nuk mund të largohen nga përgjegjësia e heshtjes. Mjerisht, u hesht për vite e shekuj, e Serbia arriti të fshehtë të vërtetën.

Nuk ka therë të asaj toke, nga Nishi, Toplica, Kumanova e qytete të tjera, e deri këndeje, që nuk flet për varre e eshtra të shqiptarëve. Kështu u veprua dhe po veprohet edhe këto 20 vjet të këtij shekulli. I gjithë gjenocidi ndaj shqiptarëve u bë i hapur dhe mjerisht para gjithë botës së qytetëruar demokratike e paqedashëse dhe Serbia arriti të fshehtë të vërtetë, vërtetë interesant.

E kuptojmë se me Serbinë nuk është asgjë e çuditshme, sepse e tërë e kaluara e këtij shteti monstrum është e mbështetur në konstruktin e gënjeshtërisë, e dimë edhe moton me të cilën funksiononte e kaluara dhe e tashmja e këtij shteti. Babai i shtetit serb, Çosiq, konstatonte se “patriot serb është vetëm ai serb, i cili gënjeshtërisë e bën të vërtetë”. Ja mbi çfarë baze u krijua ky shtet. E çuditshme është pse u hesht e pse po heshtet edhe sot?

Si është e mundur që edhe sot demokracitë perëndimore, e një gjenocid i tillë në Evropë e dimë se është bërë vetëm ndaj izraelitëve dhe me gjithë tragjedinë e madhe të këtij populli, megjithatë është bërë një gjyq ndaj Gjermanisë fashiste. Por, çfarë ndodhi dhe çfarë po ndodh me popullin tonë? Kur dhe nga kush do të del në dritë dhe do të hapet një e vërtetë? Mendoj se edhe përpjekja për t’i humbur gjurmët e gjenocidit të fundit të luftës ‘98-‘99 është vazhdimësi e pashkëputshme e planeve fashiste serbe. Përkundër faktit se çfarë po ndodh, një absurd i sotëm, bashkësia ndërkombëtare dhe ajo evropiane ngrenë dhe krijon gjykata speciale për shqiptarë, por jo për serbë.

Dhe, krejt në fund, të nderuar qytetarë, dhe ju deputetë të nderuar, ne duhet të bashkëndiejmë në dhembjen dhe lotët e nënave që po kërkojnë bijtë dhe bijat e tyre këtu e 20 vjet më parë. Liria e Kosovës nuk është e plotë derisa nuk zbardhet e vërteta për njerëzit tanë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e deputetit Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar familjarë të personave të pagjetur,

Do të përpiqem të flas shkurt dhe të mos përsëris atë që thanë shumë kolegë deputetë dhe duke mos dashur të paraqes pjesë historike nga e kaluara jonë, por vërtet të merremi me atë që na takon si deputetë, si institucione për ta bërë të pamundurën për zbardhjen e fatit të të gjithë të pagjeturve në Kosovë.

Asnjëherë nuk kam menduar se çështja e të pagjeturve në Kuvendin e Kosovës do të vijë në atë pikë që mu ata që kanë familjarë dhe kanë pasur familjarë të zhdukur ta iniciojnë çështjen në Kuvend. Pra, mendoj që çështja e të zhdukurve është çështje që u përket të gjithëve. me gjithë respektin që kam për dy deputetët iniciues të këtij debati, për Sarandën dhe për djalin e Ukshin Hotit, Andinin, mendoj që çështja e personave të zhdukur është çështje që u përket institucioneve shtetërore, që i përket Kuvendit, Qeverisë dhe Presidencës së shtetit, e në veçanti institucioneve përgjegjëse dhe përkatëse edhe të drejtësisë.

Kur them të institucioneve përkatëse të drejtësisë, duhet të ju rikujtoj të nderuar kolegë se në Mjekësinë Ligjore të Prishtinës ka mbetje mortore edhe të luftërave të tjera, jo vetëm të luftës së fundit, të cilat gjatë ndërtimeve, gërmimeve janë hasur dhe të cilat nuk kanë arritur të identifikohen. Po e përmend një rast të masakrës së Drenicës së vitit 1944-1945, e që janë gjetur pastaj disa nga të ekzekutuarit në atë masakër në objektet e ish-Armatës jugosllave në Bair të Mitrovicës, dhe për fatin e keq që nuk kanë arritur të zbardhen ato, sepse nuk kishte mbështetje financiare për Mjekësinë Ligjore që të bëhen ADN-ja dhe ekzaminimet e nevojshme.

Nëse vazhdohet me një punë të ngathët çfarë është aktualisht, atëherë do të vijë momenti që edhe mbetjet mortore, të cilat mund të gjenden pas disa vitesh për të zhdukurit nga lufta e fundit të mos ketë mbështetjen e duhur institucionale dhe financiare për caktimin dhe diagnostifikimin nëpërmjet ADN-së. Pra, kur jemi te kjo, kërkoj nga hartuesit e rezolutës që ta kemi një pikë të veçantë mbështetjen e duhur për Mjekësinë Ligjore, për ruajtjen e mbetjeve mortore dhe për identifikimin e të gjitha mbetjeve mortore, qoftë edhe ato të Luftës së Parë dhe të Luftës së Dytë Botërore, sepse ka ende familjarë që nuk i ka familjarët e tyre të gjetur që nga Lufta e Dytë Botërore e deri më sot nuk dinë për varrin e tyre dhe ka edhe këtu deputetë që burojnë nga ato familje dhe unë nuk mendoj që duhet vetë deputetët ata që kanë familjarë të zhdukur nga Lufta e Dytë Botërore dhe nga lufta e fundit që ata të jenë iniciues që ato çështje të bëhet pjesë e rezolutës, ose pjesë e diskutimit institucional.

Të gjithë ata që kanë rënë për këtë vend, dëshmorët, martirët, të zhdukurit, invalidët e luftës, invalidët civilë, të gjithë ata kanë rënë për shtetin e Kosovës, për lirinë e saj dhe institucionet e

kanë për obligim ligjor e kushtetues që të punojmë pa dallim për ta, pa e minimizuar atë çështje në nivelin e diskutimeve familjare, ose personalizime të tilla, e më së paku që ai të jetë një lloj diskutimi ndërmjet nesh për të përfituar personalisht në emrin e ndonjërit të zhdukur, që ndonjë subjekt politik ta përdorë atë për vete, por që kjo të jetë një çështje e interesit nacional derisa vërtet të zbardhet fati i të gjithë të zhdukurve në luftën e fundit, por gjithsesi edhe atyre patriotëve të zhdukur para luftës, edhe në Luftën e Dytë, por edhe në Luftën e Parë Botërore, sepse kemi përgjegjësi, sepse vendi ynë ka arritur në këtë etapë të lirisë dhe të shtet ndërtimit falë një përkushtimi të vazhdueshëm ndër vite dhe të mos them edhe ndër shekuj. Prandaj, këto janë çështje që i takojnë historisë, por që neve na takon si institucione ta ndajmë buxhetin, ta forcojmë Institutin e Mjekësisë Ligjore të Kosovës, që ai pastaj ta ketë buxhetin e mjaftueshëm për t'i bërë të gjitha hulumtimet edhe ekzaminimet e nevojshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja, Fatmire Kollçaku.

FATMIRE KOLLÇAKU: Faleminderit!

Vendosa të dal këtu, edhe pse nuk e kam princip, vetëm për ta pasqyruar edhe një herë prapa shpinës sime mungesën e Kabinetit qeveritar, që me të vërtetë është për keqardhje kur e trajtojmë një temë kaq të rëndësishme.

Të nderuar familjarë të të pagjeturve, të cilëve u dedikohet sot kjo seancë, Ky Kuvend nuk do ta nxjerrë për herë të parë sot një rezolutë dhe më shumë se 10 vjet më herët isha deputete në këtë Kuvend dhe mu në komisionin tim që e udhëhiqja në atë kohë, atë të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, trajtohej çështja e të pagjeturve, dhe në atë kohë si e dorës së tretë dhe që në atë kohë insistoja që çështja e të pagjeturve të trajtohet në një komision të veçantë për shkak të rëndësisë që ka. Rezoluta e nxjerr atëherë e obligonte Qeverinë që kurdo dhe kudo që bisedon me Serbinë me prioritet të lartë ta trajtojë çështjen e të pagjeturve, por kjo nuk ndodhi. Po e përmendi Rezolutën 2012, që e obligon Qeverinë që t'i kushtëzojë bisedimet me Beogradit me zbardhjen e fatit të të pagjeturve, por ajo prapë nuk ndodhi. Cili do të jetë fati i kësaj rezolute që ne sot po pretendojmë ta nxjerrim? A do të mbetet edhe ajo një copë letre, të cilën nuk do ta respektojë askush?

Nuk e kam ndërmend të merrem me Qeverinë, por me ne si deputetë, se ne jemi ata që kemi përgjegjësi ta përcjellim zbatimin e rezolutave që vetë i nxjerrim. Dëgjova sot këtu se duhet të jemi të kujdesshëm. Jo, ne nuk duhet të jemi të kujdesshëm, por ne duhet të jemi të përgjegjshëm. Të përgjegjshëm para qytetarëve dhe para vendimeve që ne i nxjerrim. Nuk do mend që Serbia ende nuk ka gatishmëri t'i denoncojë krimet e luftës, t'i nxjerrë para drejtësisë kriminelët e luftës, ta pranojë fajin dhe të kërkojë falje. Serbia nuk është ende e gatshme. Nuk është e gatshme, sepse në krye të institucioneve në Serbi ende janë njerëz, të cilët e kanë mbi supet e veta përgjegjësinë nga koha e luftës. Janë po ata njerëz që edhe në atë kohë ishin aktiv dhe ishin pjesëmarrës, vendimmarrës në krejt ato çfarë ndodhi në Kosovë. Prandaj, të presim nga

Serbia mëshirën e tyre dhe që ata të vendosin, besoj që është shumë më joreale sesa ta marrim ne vetë fatin në duart tona.

Çfarë na pengon që në Bruksel t'i kushtëzojmë vërtet bisedimet me zbardhjen e fatit të personit të fundit, sepse shteti nuk guxon të çojë dorë deri në zbardhjen e fatit dhe të personit të fundit të pagjetur. Është obligim i secilit shtet, në rend të parë ne si Republikë e Kosovës e kemi për obligim. Çfarë na pengon neve që krahas Gjykatës Speciale, që është njëra ndër gjykatat më të padrejta që na ka ndodhur, e që vetë e kemi votuar, dhe me çfarë presioni, po mendoj këtu shumë deputetë, bëjmë presion te gjykatat tona që t'i vërshojnë me lëndë, të gjitha lëndët për secilin ndaras, jo vetëm për urdhërdhënësit, por edhe secilin kriminel, shumë prej të cilëve kanë qenë shtetas të Kosovës, t'i vërshojmë gjykatat dhe t'i denoncojmë edhe pa praninë e tyre që këmba e tyre kurrë të mos guxojë të shkelë në Kosovë, sepse do t'i presë burgu. Çfarë po ne pengon neve? A na pengon në këtë rast Serbia?

Dihen kriminelët, u dihen emrat dhe mbiemrat, vetëm duhet që të marrim masa.

Serbia si shtet nuk është ende e gatshme, por në Serbi ka megjithatë individë dhe me këtë rast e kisha shprehur një mirënjohje për zonjën Natasha Kandiç, e cila në disa raste ka bërë shumë më tepër edhe se disa prej deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Edhe pse është individ, ajo ka presione të mëdha deri edhe te frika për jetën e saj, sepse me truproje duhet të sillet me Serbi. Kjo tregon çfarë është Serbia sot, por tregon që ka megjithatë disa individë që po bëjnë disa përpjekje. Çfarë është aparati shtetëror serb? Do ta cek edhe një herë një rast, ta rikthej këtu, sepse nuk e kemi materializuar si Kosovë. Unë vij nga Komuna e Pejës, dhe ju e dini rastin famëkeq "Panda". Çfarë ishte në gjendje të bëjë Serbia? Jo vetëm t'i vrasë fëmijët shqiptarë, por t'i vrasë edhe fëmijët e vet, vetëm që t'i ketë si pretekst pastaj për të gjitha ato çfarë i bëri, çfarë pasuan, jo vetëm në Komunën e Pejës, por edhe në tërë Republikën e Kosovës.

Dhe, çfarë bëjnë ne që ta materializojmë rastin "Panda" dhe t'i tregojmë botës që Serbia dhe aparati shtetëror serb nuk kanë ngurruar të bëjë edhe gjëra të tilla dhe t'ua veshë shqiptarëve një krim aq të rëndë në atë kohë. Sot, botërisht e ka pranuar edhe vetë Vuçiqi se ajo ka qenë e organizuar dhe fëmijët serbë janë vrarë nga aparati shtetëror serb.

Prandaj, deputetë të nderuar, ju ftoj që rezolutën që do ta nxjerrim sot të harmonizuar ndërmjet të gjitha grupeve parlamentare - ta përcjellim zbatimin e saj dhe ta kushtëzojmë Qeverinë. Ne nuk duhet të merremi me Qeverinë në aspektin nëse sot nuk janë këtu, ajo çfarë mund të bëjmë është që ta përcjellim zbatimin e rekomandimeve që dalin nga rezoluta, përndryshe edhe një debat i tillë tash një vit nuk do të na justifikojë as para familjarëve, as para askujt, se do të mbeten vetëm fjalë boshe dhe një copë letër, e cila nuk do të respektohet nga askush. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka deputetë tjerë të paraqitur për të marrë fjalën, kështu që unë në fund të këtij debati ia kaloj fjalën edhe një herë parashtruesit të debatit që ta paraqesë tekstin e rezolutës të harmonizuar me grupet parlamentare. Urdhëro, Sarandë!

SARANDA BOGUJEVCI: Faleminderit!

Në bashkëpunim me përfaqësuesit e grupeve parlamentare, ne iniciuesit e kësaj seance i harmonizuar pikat e rezolutës. Këto janë:

1. Të bëhet zbardhja e fatit të personave të zhdukur me forcë, bazuar në të drejta ndërkombëtare, përfshirë konventat e Gjenevës të vitit 1949 dhe në protokollin shtesë, nr. 1, 1977.
2. Zbardhja e fatit të personave të zhdukur me forcë të vendoset si parakusht në dialogun Kosovë - Serbi dhe të bëhet pjesë e platformës shtetërore për dialogun. Institucionet e autorizuara për dialog duhet t'i raportojnë Kuvendit dhe komisioneve përkatëse pas çdo takimi me palën serbe për këtë çështje.
3. Subjektet vartëse të politikës parlamentare dhe politikës së jashtme të Kosovës në agjendat e takimeve me përfaqësues të OKB-së, BE-së, shteteve me ndikim në marrëdhënie ndërkombëtare, ta fokusojnë me prioritet zbardhjen e fatit të personave të zhdukur me forcë dhe për zbatimin e pikave të rezolutës ta njoftojnë Kuvendin e Kosovës.
4. Të gjithë bartësit e detyrave në bazë të pikave të kësaj rezolute t'i qasen në mënyrë të veçantë në dialog Kosovë - Serbi zbardhjes së fatit të Ukshin Hotit për shkak të rrethanës së zhdukjes së tij, të planifikuar nga strukturat komanduese ushtarake të shtetit serb, përfshirë drejtorin e Burgut të Dubravës në Istog dhe Ministrinë e Drejtësisë së Serbisë.
5. Qeveria e Republikës së Kosovës ta finalizojë deri në fillim të muajit qershor 2018 koncept-dokumentin për çështjen e personave të zhdukur dhe të procedojë me plotësim-ndryshimin e Ligjit për persona të zhdukur, përkatësisht bazës ligjore dhe të njëjtën ta procedojë në Kuvend.
6. Qeveria ta trajtojë me prioritet funksionalizimin e plotë të regjistrimit qendror për persona të zhdukur, përfshirë edhe versionin elektronik me mundësinë e digjitalizimit dhe krijimit të qasjes për publikun, me qëllim të rritjes së transparencës.
7. Qeveria të angazhohet që të lidhë marrëveshje mirëkuptimi ndërmjet Kosovës dhe Serbisë për të ashtuquajturën “ndihmë juridike” ngjashëm me marrëveshjen që ka bërë Serbia me Bosnjë-Hercegovinën, si dhe Kroacinë.

8. Institucionet kompetente të Republikës së Kosovës të angazhohen dhe ta paditin Serbinë si përgjegjëse kryesore për personat e zhdukur, duke përfaqësuar familjarët individualisht, ose si grup, në instancat ndërkombëtare.

9. Qeveria obligohet ta realizojë projektin për shfaqjen e të dhënave rreth personave të zhdukur të përmendorja jashtë objektit të Kuvendit dhe të përfundojë puna e memorialit në Mejë të Gjakovës deri në fund të vitit 2018.

10. Të ngrihen kapacitete institucionale të vendit për t'u marrë plotësisht me çështjen e personave të zhdukur me forcë.

11. Të hartohet dhe procedohet projektligji, i cili mundëson gjykimin e të akuzuarve për krime të luftës në mungesë.

E kemi dhe një propozim të deputetes Sala-Berisha, që Java e të Zhdukurve të përfshijë shënimin e ditëve të përkujtimit të të gjitha masakrave dhe të përfundojë me shënimin e 16 majit - Ditës së Rrëmbimit të Ukshin Hotit.

Për këtë të fundit, mund të deklarohen edhe grupet parlamentare nëse janë të pajtimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Dëshirojnë përfaqësuesit e grupeve parlamentare të deklarohen? Lidhja Demokratike e Kosovës? Avdullah Hoti!

AVDULLAH HOTI: Faleminderit! Ne kemi pasur përfaqësuesen tonë në atë grup punues, kështu që pajtohemi.

KRYESUESI: Vetëm për pikën shtesë, Avdullah!

AVDULLAH HOTI: Në rregull jemi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! PDK-ja? Flora Brovina e ka fjalën.

FLORA BROVINA: Grupi Parlamentar dakordohet edhe me pikën e fundit dhe me të gjitha pikat tjera.

KRYESUESI: Lëvizja Vetëvendosje?

SARANDA BOGUJEVCI: Edhe ne si grup parlamentar pajtohemi me pikën e fundit.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi i Deputetëve të Pavarur! Driton Çausi e ka fjalën.

DRITON ÇAUSHI: Mendoj se pika e fundit kërkon një shqyrtim pak më serioz, nëse sot do ta marrim një vendim për ta ndërruar Ditën Kombëtare të të Pagjeturve. Nuk e di nëse është e drejtë që të jetë së pari pjesë e kësaj rezolute, nuk më duket që përputhet me kërkesat që janë shumë më të rëndësishme dhe nuk e kisha parë si pjesë që do të duhet sot të votohej. Mendoj që kërkon një diskutim më të gjerë nëse vendosim të zhvendoset një datë që tashmë njihet si datë kombëtare të pagjeturve, që lidhet me Masakrën e Mejës.

KRYESUESI: Faleminderit! Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës?

MUHARREM NITAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Jemi dakord me pikat që përmban, që janë rekomandim dhe që i propozoi zonja Bogujevci. Kjo pika e fundit kam përshtypjen që nuk është krejtësisht funksionale që të jetë pjesë e këtyre rekomandimeve. Jam dakord me zotën Çausi, ndoshta është mirë që të diskutohet dhe unë do të thosha për shembull që të mos ngutemi ta futim si pikë të veçantë në rekomandimet e përfshira nga 11, sa ishin. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit të Kosovës, z. Kadri Veseli.)

KRYETARI: Zonja Albulena BalajHalimaj e ka fjalën.

ALBULENA BALAJ HALIMAJ: Faleminderit, kryetar!

Jam dakord që ndoshta mund ta ndryshojmë datën, por që ne në grup punues nuk e vendosëm një gjë të tillë, prandaj mendoj që nuk mund të futet në rezolutë, por që për datën mund të flasim në tjera takime. Faleminderit!

KRYETARI: Grupi Parlamentar “6+”, zonja Duda Balje.

DUDA BALJE: Parlamentarna Grupa “6+” slaže se sa zadnjom tačkom koja je danošena na sastanku. Hvala!

KRYETARI: Grupet parlamentare, me aq sa po e shoh të gjitha kanë dhënë mendimin e vet, por shoh zonjën Flora Brovina që ka dëshirë të shtojë diçka. Urdhëro, zonja Brovina rreth çështjes së rezolutës.

FLORA BROVINA: Domethënë, ne u konsultuam ç’është e vërteta dhe ndoshta nuk e vendosëm krejt bashkë, por tani po e diskutojmë. Askush nuk tha që ta ndërrojmë datën e Mejës, sepse kjo është një datë e shënuar - 27 Prilli, por që të shënohet një javë deri kur të përfundojë ky aktivitet

për personat e zhdukur dhe nderimin e tyre deri në datën kur është zhdukur Ukshin Hoti. Kjo ishte ideja.

KRYETARI: Faleminderit! Ne e kemi një dakordim, plus një propozim shtesë. Po, sot me aq sa po e shoh, jemi vetëm 53 deputetë, të mos futemi në pjesën formale të votimit pasi nuk kemi kuorum. Ta lëmë këtë pjesë pikë të parë të rendit të ditës në momentin kur vijmë më 3 maj dhe e votojmë bashkërisht. Ndërkohë, propozuesit e seancës së jashtëzakonshme, Saranda dhe Andini, merren pastaj me atë nëse e futin në projekt-rezolutë edhe këtë propozim, apo jo, dhe edhe një herë ju ftoj që ta lexoni atë që është dakordim i plotë i juaji për votim, atë që na e sillni ju si propozim në fund. Pra, më 3 maj, pikë e parë të rendit të ditës. Pa filluar seanca, fillojmë menjëherë me këtë, për arsye se sot nuk ka kuorum, jemi 53 deputetë, po e shoh reagimin. Adem Mikullvoci, pastaj Armend. Urdhëro!

ADEM MIKULLOVCI: Kryetar!

Pasi po shtyhet, unë propozoj që, pa kurrfarë ofendimi, të shikohet edhe një herë kjo rezolutë. Mua po më duket pak shumë e gjatë dhe s'është aq precize ashtu siç kam pritur. Vetëm kaq!

KRYETARI: Faleminderit! Megjithatë ka kohë dhe e bëjnë një rezolutë që është më e mirëpritur për të gjithë ne. Zoti Zemaj, fjala për ju!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Po flas kështu edhe në emër të kolegëve, sepse insistuam që një kohë të gjatë që të jemi të pranishëm dhe disa këtu pritëm tërë ditën pa lëvizur nga këto ulëse, edhe të dëgjojmë, edhe t'i bashkërendojmë dhe harmonizojmë qëndrimet dhe propozimet, dhe në fund ta votojmë.

Unë mendoj që është krijuar një praktikë e mirë e harmonizimit të qëndrimeve dhe të bisedave, por edhe propozimet që dalin nga deputetët dhe ajo frymë duhet të ruhet deri në fund. Mbi të gjitha nuk është rezoluta e parë që po e bën Kuvendi i Kosovës. Unë në mënyrë parimore insistova dhe në bashkëbisedim edhe me propozuesit, atë që e tha edhe zoti Adem Mikullvoci, që të jenë disa rekomandime të shkurtra e të sakta, që i obligojnë ata që kanë përgjegjësi institucionale, sidomos në këtë fazën e përfundimit, apo edhe të normalizimit të marrëdhënieve, sepse po dihet adresa ku duhet të kërkohet kjo përgjegjësi dhe ku duhet të kërkohet zbardhja e fatit të të pagjeturve. Kështu që ju kisha lutur që të mos kemi lëvizje apo propozime të datave, sepse çdo ditë në Republikën e Kosovës përkon me një datë të caktuar, qoftë për masakrat që kanë ndodhur, qoftë për betejat, qoftë për luftërat, qoftë për humbjen e jetës së individëve. Ta ruajmë frymën e thirrjes së këtij debati mbi një datë të shënuar dhe e cila na bashkoi kështu siç jemi deri në fund.

KRYETARI: Nait Hasani dhe Bekim Haxhiu, po ju lus që të jeni më të drejtpërdrejtë për arsye se...

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Në frymën e kësaj rezolute, kërkoj që duhet edhe një ndarje e një buxheti të Qeverisë pikërisht për botimin e librave dhe dëshminë e krimeve dhe të të zhdukurve. Prandaj, kjo është një kërkesë, që mendoj se me këtë mund ta dëshmojmë me anë të librit edhe dokumentimin e krimit.

KRYETARI: Ne kemi biseduar dhe propozuesit e kanë sjellë propozimin. Në momentin që e aprovon, ne do ta bëjmë dëshminë para Kuvendit, do ta vendosim monitorin brenda kohës më të shkurtër të mundshme, në moment që e votoni ju. Ajo çfarë bëjnë të gjithë popujt që kanë pësuar si ne. Bekim Haxhiu, urdhëro!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Edhe pas diskutimeve të kolegëve, në një periudhë të shkurtër, Komisioni i përbërë nga të gjitha grupet parlamentare të mbledhet sot dhe kryetarët e grupeve parlamentare të mbledhin deputetët brenda ditës së sotme, brenda gjysmë ore apo një ore, që rezoluta të votohet sot, në këtë ditë të shënuar të 27 Prillit, e jo një ditë tjetër. Nuk besoj që ne si deputetë duhet ta lejojmë një komoditet të tillë, një ofendim të tillë vetvetes, që të mos kemi kuorum për ta votuar sot një rezolutë për të zhdukur, për çfarë është thirrur seanca sot, e për çfarë është debatuar tërë ditën. Mendoj që kjo rezolutë duhet të votohet sot. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Pritni vetëm pak! Të mos shkojmë... Ju lutem, a ka mundësi që grupet parlamentare... do të ishte në dinjitetin e Kuvendit, t'i sigurojmë tetë deputetë, t'i kemi 61 deputetë në sallë? A mund t'i kemi 8 deputetë? Kjo është pyetja e drejtpërdrejtë. Zoti Hoti, 53 janë aktualisht. Kjo është çfarë më dha Administrata, 54 deputetë. E dinjitetshme do të ishte po të përfundonte sot.

Unë mund ta jap një pauzë. Zonja Bogujevci dhe zoti Hoti takohen, e menaxhojnë me grupet parlamentare për tekstin e projektrezolutës edhe një herë, por ta votojmë sot. Të mos dalim pa e votuar sot. A e bëjmë një pauzë prej 20 minutash? Zonja Bogujevci, zoti Hoti, menaxhojeni draftin e rezolutës, në mënyrë që pastaj ta votojmë. Thërras publikisht, po qe se jemi ende në transmetim, kolegët deputetë le të drejtohen drejt Kuvendit për ta votuar rezolutën.

20 minuta pauzë!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,
Përgatitemi për verifikim të pranisë. Urdhëroni zonja Bogujevci, fjala për ju!

SARANDA BOGUJEVCI: Vetëm desha të bëj një sqarim rreth propozimit më herët të deputetes Sala. Ka qenë një keqkuptim, çështja do të trajtohet brenda komisionit, domethënë kur të vijë Projektligji për personat e zhdukur. Kështu që vetëm ky sqarim, ajo pikë nuk do të hyjë në propozimet që janë dhënë për rezolutë. Domethënë mbeten vetëm 11 pika, që kemi qenë dakorduar të gjitha grupet parlamentare. Vetëm këtë sqarim.

KRYETARI: Faleminderit! Rezoluta është e përgatitur. Sa deputetë i kemi në sallë? 54! Kështu, do ta marrim një vendim sot, i falënderoj të gjithë deputetët që janë në sallë, deputetëve që nuk janë të pranishëm u hiqet mëditja. Pritni pak, qetësohuni! Urdhëro, zoti Sherifi!

BILALL SHERIFI: Faleminderit, zoti kryetar!

Nuk është problemi te mëditjet, hiqja mëditjet për tash e tre muaj, s'është problemi aty. A ka mundësi t'i lusim të gjitha grupet parlamentare që të bëjnë përpjekje të gjenden nja 7 deputetë në funksion të temës, të cilën e kemi trajtuar. Lehtë është tash të themi jo nuk janë, por hajde të provojmë t'i gjejmë disa deputetë e ta kalojmë rezolutën, sepse ka rëndësi që rezoluta të kalojë, e jo të bëjmë me gisht nga deputetët që s'janë këtu. Unë po kërkoj mirëkuptim, e nëse nuk ka mirëkuptim, atëherë e lëmë krejt, e votojmë një ditë tjetër. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Bilall, ty të kemi tamam, në këtë gjuhën kosovare shumë mirë, ti e the edhe me aksent të Tetovës, por unë i ftova edhe më herët. U vonuam 20 minuta dhe prapë s'kanë ardhur. Po, po, t'jua jap fjalën. Zoti Nitaj, fjala për ju!

MUHARREM NITAJ: Mendoj që është i qëlluar propozimi për mëditjet, zoti kryetar, por disa deputetë janë në aktivitete tjera. Unë po e vërej, për shembull, që në disa seanca disa deputetë kanë aktivitete tjera. E di që një grup i deputetëve ka shkuar në Prizren në njëfarë debati me qytetarët e Prizrenit.

Tani është mirë që ju si udhëheqje e Kuvendit të mos i dublifikoni aktivitetet e deputetëve, në mënyrë që ata të vendosen në pozicion të palakmueshëm. Është kolegu Blerim Kuçi dhe disa kolegë të tjerë, për shembull, që kanë shkuar në një agjendë të paracaktuar. Është mirë që Kuvendi i Kosovës të mos i dublifikojë aktivitetet. Faleminderit!

KRYETARI: A ka mundësi të votojmë një herë vetëm për praninë. Shkojmë me "po" vetëm për praninë për këta që janë në sallë. Ju lutem, regjia dhe deputetët, votojmë tash vetëm për praninë.

Regjia, ju lutem, e printoni këtë listë. Zoti Nitaj e dha edhe një opsion. Në mbledhjen e Kryesisë për deputetët të cilët aktualisht janë në Prizren marrim vendim, të gjithë deputetëve tjerë u hiqet mëditja.

Vetëm ta kini parasysh, 98 deputetë janë nënshkruar, më shumë për publikun sesa për sallën. 98 deputetë janë nënshkruar për ta marrë mëditjen. Aktualisht i kemi 56. E shohim në mbledhjen e Kryesisë për deputetë të cilët janë... Urdhëro, zoti Haradinaj!

DAUT HARADINAJ: Tash, të kuptohemi drejt. Domethënë sot është masakra e Mejës. Një pjesë e mirë e deputetëve kanë familjarë që janë të humbur në atë masakër. Dhe, nuk është e ndershme që ne sot t'ua heqim mëditjet, jo në kuptimin financiar, por është e pamoralshme nëse ne shkojmë në atë drejtim. Kjo s'ka të bëjë as me mëditje. Nuk janë këtu. Unë nuk po i justifikoj pse nuk janë fizikisht këtu sot, se kanë mundur edhe të kthehen, por ju kisha lutur, edhe ju, edhe kolegëve, edhe krejt, që ta lëmë e të votojmë një herë tjetër, të mos e hapim diskutimin.

Besoj që më 3 maj i kemi, ose thirrë edhe një seancë të jashtëzakonshme, se s'bëhet nami. Nesër vijmë të gjithë dhe e votojmë, se nuk dalim seriozë në këtë drejtim.

KRYETARI: Zonja Musliu dhe zotëri Zemaj, urdhëroni!

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Edhe unë pajtohem deri diku me zotin Haradinaj.

Besoj se nuk është sot kjo dita kur duhet të marrim vendim për penalizim. Pajtohem me atë që shumë deputetë kanë shkuar në përkujtimin e masakrës së Mejës. Nuk dua absolutisht të pajtohem me deputetët që kanë shkuar në Prizren, sepse thjesht debati në Prizren ka mundur të shtyhet për një ditë tjetër. Në atë debat ka qenë i ftuar edhe Nait Hasani, me sa e kam parë, mirëpo është mirë që deputetët të dinë t'i vendosin prioritetet se çfarë është prioritet për ta.

Neve nuk po na ndodh veç sot, po na ndodh gjithherë me deputetët që i kemi "deputetë supermenë", që i marrin nga 5-6 paga, ose thjesht i mbajnë nga 5-6 poste nëpër institucione të ndryshme. Unë mendoj që ata deputetë duhet të penalizohen dhe jo deputetët që sot kanë shkuar në përkujtim të masakrës, ose diçka tjetër. Besoj që nuk është dita më e qëlluar që sot ta marrim një vendim për penalizimin e mungesës së deputetëve në sallë.

KRYETARI: Zoti Zemaj, urdhëro!

ARMEND ZEMAJ: Kryetar!

Jo rrallëherë është vënë në pikëpyetje heqja e mëditjes për deputetët, por kjo e sotmja dallon besoj dhe duhet të dallojë skajshmërisht. Këtë e them për një arsye, sepse nëse është ashtu do të lutesha të ma heqësh edhe mua mëditjen, se sot s'kam ndenjtur për mëditje këtu. Por, është fakt

që pothuajse të njëjtit deputetë vijnë, nënshkruhen, qëndrojnë një orë dhe shkojnë. Pavarësisht që sot ka edhe disa aktivitetet tjera, por është ora 18:00, e ne kemi filluar në orën 10:00 këtu. Kështu që më mirë është apostrofimi publik, pavarësisht që jemi kolegë, por duhet të krijohet një standard. Nëse vetë kërkojmë, i bëjmë diku 90 nënshkrime për një seancë, dhe sot u tregua gjatë tërë ditës se cila ishte përgjegjësia e çdonjërit këtu, atëherë të mos e krahasojmë dhe mos ta vëmë në pyetje mëditjen.

KRYETARI: Shkojmë drejt përfundimit, zoti Reçica, për arsye se s'do të hapim debat. Vendimi...

ELMI REÇICA: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje kolegë deputetë!

Përshëndetje qytetarë të nderuar!

Një nga çështjet më të ndjeshme që është diskutuar besoj dhe që diskutohet dhe do të diskutohet edhe në të ardhmen është çështja e të pagjeturve dhe nuk po flas për sot, dhe nuk po flas vetëm për këtë temë, por po flas për në të ardhmen.

Unë kisha bërë ftesë, e kam thënë edhe një herë, dhe kjo është bërë rregull. Do të thotë, pas orës 16:00 ose 17:00 është shumë problem që të ketë kuorum. Kur të jenë çështjet e tilla të ndjeshme, kisha kërkuar që mjafton nëse duam vërtet të japim ndonjë ide dhe ndonjë propozim dhe të marrim ndonjë vendim, që shefat e grupeve parlamentare, ose përfaqësuesit e tyre, në seanca të tilla të flasin, dhe jo vetëm 10 minuta, por nëse ka nevojë edhe 20 minuta, dhe pastaj të shkohet drejtpërdrejt në harmonizim të përfundimeve, konkluzioneve, vendimeve e rezolutave dhe të votojmë. Unë mendoj se kjo është e vetmja mundësi në këto situata, çfarë jemi ne tash. Edhe po diskutojmë gjithë ditën, edhe jemi ricikluar, secili e ka një rast dhe e ka një masakër që i ka ndodhur në territorin e vet, në fshatin e vet, ose në regjionin e vet.

Për këtë arsye, për në të ardhmen kisha propozuar që kur të jenë tema të tilla të ndjeshme dhe që kërkojnë të marrim vendim brenda ditës, atëherë t'i reduktojmë fjalët dhe të shkojmë sa më shpejt në votimin e asaj çka është përfundim, ose konkluzion, ose rezolutë, apo çfarëdo qoftë, që ne marrim vendim si Kuvend. Faleminderit!

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

Ditën e djeshme po ashtu e kemi pasur të njëjtën situatë, kërkohet vendimmarrje në interpelancë, deputetët largohen. Seancë të jashtëzakonshme, ja ku i keni vetë nënshkrimet. Nuk është çështja e dëshirës, por është çështja pak edhe e moralit politik, në të cilin jemi për hir të publikut, për arsye se një pjesë e madhe, disa, po më vjen keq ta them, vetëm vijnë e nënshkruhen dhe ikin.

Pastaj nuk shqetësohen fare për deputetët që qëndrojnë ndoshta me orë të tëra dhe shumica prej tyre, më vjen keq që është kjo prani dhe disa të tjerë më vjen keq që nuk janë. Mund t'i dallosh kur qëndrojnë deputetët. Kjo po ndodh çdoherë, s'është veç tash.

Për këtë praninë aktuale e vendosim për mëditje në Kryesinë e Kuvendit. Deri atëherë i kanë tërhequra të gjithë, pastaj të mos jem arbitrar - Kryesia vendos nëse merr vendimin për t'ua lejuar.

Faleminderit shumë që keni qëndruar deri më tani.

Në seancën e radhës - pika e parë e rendit të ditës - votohet ajo të cilën e lexojnë propozuesit, projektrezoluta. Faleminderit!

* * *

E enjte, më 3 maj 2018

Vazhdimi i mbledhjes së veçantë, e filluar më 27 prill 2018

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

1. Votimi i propozim-rezolutës për personat e pagjetur

Të nderuar deputetë,

Debati për persona të pagjetur ka përfunduar në seancën plenare më 27 prill 2018, por në mungesë të kuorumit votimi i propozim-rezolutës është shtyrë për seancën e sotme. E ftoj atë që do ta prezantojë në emër të propozuesit të debatit, që të paraqesë tekstin e propozim-rezolutës për ta harmonizuar me grupet parlamentare. Andin Hoti, ose Saranda Bogujevci, cili doni ta paraqisni? Zonja Bogujevci, urdhëro!

SARANDA BOGUJEVCI: Faleminderit, kryesues!

Në bazë të debatit që është zhvilluar në seancën e 27 prillit, të premtën e kaluar, në bashkëpunim me përfaqësues të grupeve parlamentare, ne si iniciues të seancës kemi bërë harmonizimin e pikave të rezolutës. Pa humbur kohë do t'i lexoj këto pika, që janë 11 prej tyre.

R e z o l u t ë

1. Të bëhet zbardhja e fatit të personave të zhdukur me forcë, bazuar në të drejta ndërkombëtare, përfshirë konventat e Gjenevës të vitit 1949 dhe në protokollin shtesë, nr. 1, 1977.
2. Zbardhja e fatit të personave të zhdukur me forcë të vendoset si parakusht në dialogun Kosovë - Serbi dhe të bëhet pjesë e platformës shtetërore për dialogun. Institucionet e autorizuara për dialog duhet t'i raportojnë Kuvendit dhe komisioneve përkatëse pas çdo takimi me palën serbe për këtë çështje.
3. Subjektet vartëse të politikës parlamentare dhe politikës së jashtme të Kosovës në agjendat e takimeve me përfaqësues të OKB-së, BE-së, shteteve me ndikim në marrëdhënie ndërkombëtare, ta fokusojnë me prioritet zbardhjen e fatit të personave të zhdukur me forcë dhe për zbatimin e pikave të rezolutës ta njoftojnë Kuvendin e Kosovës.
4. Të gjithë bartësit e detyrave në bazë të pikave të kësaj rezolute t'i qasen në mënyrë të veçantë në dialog Kosovë - Serbi zbardhjes së fatit të Ukshin Hotit për shkak të rrethanës së zhdukjes së tij, të planifikuar nga strukturat komanduese ushtarake të shtetit serb, përfshirë drejtorin e Burgut të Dubravës në Istog dhe Ministrinë e Drejtësisë së Serbisë.

5. Qeveria e Republikës së Kosovës ta finalizojë deri në fillim të muajit qershor 2018 koncept-dokumentin për çështjen e personave të zhdukur dhe të procedojë me plotësim-ndryshimin e Ligjit për persona të zhdukur, përkatësisht bazës ligjore dhe të njëjtën ta procedojë në Kuvend.

6. Qeveria ta trajtojë me prioritet funksionalizimin e plotë të regjistrimit qendror për persona të zhdukur, përfshirë edhe versionin elektronik me mundësinë e digjitalizimit dhe krijimit të qasjes për publikun, me qëllim të rritjes së transparencës.

7. Qeveria të angazhohet që të lidhë marrëveshje mirëkuptimi ndërmjet Kosovës dhe Serbisë për të ashtuquajturën “ndihmë juridike” ngjashëm me marrëveshjen që ka bërë Serbia me Bosnjë-Hercegovinën, si dhe Kroacinë.

8. Institucionet kompetente të Republikës së Kosovës të angazhohen dhe ta paditin Serbinë si përgjegjëse kryesore për personat e zhdukur, duke përfaqësuar familjarët individualisht, ose si grup, në instancat ndërkombëtare.

9. Qeveria obligohet ta realizojë projektin për shfaqjen e të dhënave rreth personave të zhdukur te përmendorja jashtë objektit të Kuvendit dhe të përfundojë puna e memorialit në Mejë të Gjakovës deri në fund të vitit 2018.

10. Të ngrihen kapacitete institucionale të vendit për t’u marrë plotësisht me çështjen e personave të zhdukur me forcë.

11. Të hartohet dhe procedohet projektligji, i cili mundëson gjykimin e të akuzuarve për krime të luftës në mungesë.

Këto janë propozimet rreth rezolutës. Unë të njëjtën kohë vetëm kisha dashur t’i falënderoj të gjithë deputetët që kanë qenë të angazhuar dhe për përkrahjen rreth punës që është bërë për këtë seancë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani kërkohet deklarimi me votim për rezolutën e propozuar. Në sallë janë 78 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votomë tani! Faleminderit!

Kanë votuar 75 deputetë. Për kanë votuar 71, kundër 4, asnjë abstenim.

Konstatoj që Kuvendi e miratoi Rezolutën për persona të pagjetur.

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*